



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Biologji Molekulare”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Admir JANÇE

Dr. Eldores SULA

Janar / 2026

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” ofruar nga “Universiteti i Tiranës”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës.
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Biologjisë.
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1225, datë 03.09.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	–
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 264, datë 29.12.2023.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	–
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 13 PAE / 2 PAK 2023-2024 14 PAE / 1 PAK 2024-2025 13 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 20 studentë 2023-2024 17 studentë 2024-2025 16 studentë
19	Komente / të tjera:	–

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është institucioni i parë publik i arsimit të lartë në vend, i themeluar në vitin 1957 me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 207, datë 30.05.1957. Akreditimi periodik institucional i UT u finalizua me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 04, datë 27.01.2023. Në vitin akademik 2008-2009 u hap Programi i Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, i ofruar nga Departamenti i Biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës. Programi u licencua me VKM Nr. 1225, datë 03.09.2008. Programi ka nisur aktivitetin akademik në vitin 2008-2009 dhe aktualisht diplomon brezin e katërmbëdhjetë të studentëve. Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), përgjegjës për ofrimin e këtij programi, përbëhet nga nëntë njësi bazë akademike:

1. “Departamenti i Biologjisë”;
2. “Departamenti i Bioteknologjisë”;
3. “Departamenti i Kimisë”;
4. “Departamenti i Kimisë Industriale”;
5. “Departamenti i Matematikës”;
6. “Departamenti i Matematikës së Aplikuar”;
7. “Departamenti i Fizikës”;
8. “Departamenti i Informatikës”;
9. “Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës”;

Aktualisht, në program janë të regjistruar 33 studentë dhe janë angazhuar rreth 14 pedagogë si personel akademik. Gjithashtu janë në zbatim një numër i konsiderueshëm marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Programi Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” është ndërtuar në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe VKM Nr. 41 (i ndryshuar), si edhe me aktet nënligjore të Universitetit të Tiranës. Programi zbatohet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe kërkon përfundimin me sukses të 120 krediteve gjatë një periudhe dyvjeçare me kohë të plotë. Studentët që përfundojnë me sukses detyrimet akademike pajisen me diplomën e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”. Ky program është në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” dhe aktet nënligjore shoqëruese. Sipas informacionit institucional, programi mbështetet në modele bashkëkohore ndërkombëtare dhe orienton mësimdhënien drejt kërkimit shkencor inovativ. Qëllimi kryesor është përgatitja e specialistëve të aftë për të interpretuar, analizuar dhe kuptuar proceset biologjike në kompleksitetin e tyre, si edhe për t’u përballur me sfidat e fushës së biologjisë molekulare. Programi synon ofrimin e njohurive të thelluara teorike e praktike, përvojës laboratorike dhe kompetencave profesionale që u lejojnë të diplomuarve të punësohen në institucione publike shkencore, universitete, si dhe në pozicione ku kërkohen ekspertë të fushës molekulare.

Studentët që përfundojnë me sukses këtë cikël studimi kanë të drejtën të vazhdojnë formimin e tyre akademik në Ciklin e Tretë të Studimeve - Doktoratë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm përfaqëson dokumentin e përgatitur në kuadër të akreditimit të parë të programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës.

Vlerësimi nisi me marrjen dhe shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni, si dhe me ndarjen e detyrave për përgatitjen e pyetjeve dhe identifikimin e dokumenteve shtesë të nevojshme. Në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, 2017”, ASCAL përzgjodhi dy vlerësues të jashtëm për shqyrtimin e dokumentacionit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, realizimin e vizitës institucionale dhe hartimin e raportit përfundimtar të vlerësimit, të cilët janë: **Prof. Asoc. Dr. Admir Jançe** dhe **Dr. Eldores Sula** të shoqëruar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Arbri Ndreka.

ASCAL përgatiti agjendën përkatëse dhe vizita në institucion u zhvillua më 07-08 maj 2025. Sipas planifikimit, në ditën e parë u realizuan takime me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë, me grupin e vlerësimit të brendshëm, me anëtarë të stafit akademik dhe me studentët. Paralelisht, GVJ vizitoi sekretarinë mësimore dhe ambientet e Fakultetit, duke vëzhguar auditorët, laboratorët dhe bibliotekën. Të gjitha takimet u zhvilluan sipas kohëzgjatjes së përcaktuar në agjendë.

Në ditën e dytë, GVJ zhvilloi një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ku u diskutuan çështje të ndryshme lidhur me administrimin dhe menaxhimin e personelit akademik. Më pas u mbajt një takim i zgjeruar me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshillimit të Karrierës, Alumni-t, Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe me përfaqësues të NJSBC.

Në përfundim të vizitës, GVJ zhvilloi një takim final me Drejtuesin e Departamentit të Biologjisë dhe Koordinatorin institucional. Gjatë këtij momenti, Koordinatorin i ASCAL informoi institucionin mbi dokumentacionin shtesë të nevojshëm.

Pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuar, takimeve të zhvilluara dhe vëzhgimit të ambienteve, ekspertët përgatitën Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, duke përmbledhur gjetjet dhe vlerësimet përkatëse.

Më datë 09.01.2026, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.17 Prot., datë 09.01.2026 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 20.01.2026 dhe me shkresë zyrtare, datë 15.01.2026, ka dërguar komente mbi draft raportin:

GVJ, pasi u njoh me komentet e Departamentit të Biologjisë - Universiteti i Tiranës, për secilin prej standardeve të Raportit mbi Akreditimin e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, sqaron si më poshtë:

Komenti i “UT”:


- *Sugjerimi 1 nga GVJ: GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes të lëndëve-moduleve sipas kategorive përkatëse në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar në “VKM Nr. 41. Datë 24.01.2018, e ndryshuar”, si edhe në planin mësimor të programit të studimit duhet që “Lëndët me zgjedhje” që ofrohen, të pozicionohen në Kategorinë C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese; (Standarti II.1, Kriteri 1).*
- *Përgjigje e DB - UT: Duke vlerësuar se rekomandimi i GVJ-së është i drejtë nga pikëpamja formale dhe rregullatore dhe kërkon një ripozicionim të qartë të këtyre lëndëve në Kategorinë C – Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese, sqarojmë se Programi i Studimit Biologji Molekulare është konceptuar për të siguruar një formim të thelluar disiplinor, të integruar me elementë bashkëkohorë ndërdisiplinorë, duke respektuar një strukturë kurrikulare logjike dhe të ekuilibruar, lëndë të përditësuara shkencërisht, si dhe një raport të drejtë ndërmjet teorisë dhe praktikës. Në këtë kontekst, Departamenti ka vendosur të ruajë stabilitetin e programit gjatë fazës së parë të akreditimit, duke e konsideruar rekomandimin e GVJ-së si bazë për rishikime të plota dhe të strukturuar në ciklin pasues të përditësimit kurrikular, në përputhje me standardet e ASCAL, pa cenuar objektivat dhe rezultatet e të nxënit të programit.*
- *GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së DB - UT për sugjerimin e sipër cituar, vërehet angazhimi i institucionit për pranimin e sugjerimeve për përmirësime në vijim që Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi të grupohen në përputhje me “VKM Nr. 41. Datë 24.01.2018”, lidhur me ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” dhe konkretisht lëndët me zgjedhje që ofrohen, të vendosen në Kategorinë C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese. Megjithatë, sugjerimi i përmendur nga GVJ në Standardin II.1, kriteri 1 për ofrimin e Lëndëve me Zgjedhje në “Kategorinë C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese” ku duhet të jenë, dhe jo në “Kategorinë D - Lëndë Plotësuese”, qëndron si nevojë në të ardhmen për përmirësim.*

Për sa më sipër, vlerësimi i Standardit II.1 nuk ndryshon duke mbetur i vlerësuar në tërësinë e tij si “përmbushet kryesisht”.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UT”:

- *Sugjerimi 2 nga GVJ: GVJ rekomandon që në planin mësimor të Programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, të përcaktohet ngarkesa në kredite për*



realizimin e "Praktikës Profesionale", në kategorinë përkatëse D (Lëndë plotësuese), në përputhshmëri me aktet ligjore; (Standarti II.1, Kriteri 3)

- Përgjigje e DB - UT: Në fazën e ndërtimit fillestar të kurrikulës, Praktika Profesionale është konceptuar si një komponent mbështetës i formimit akademik dhe kërkimor të studentëve, i integruar me lëndët bazë dhe profesionale të programit, duke reflektuar profilin kërkimor të këtij masteri. Megjithatë, Grupi i Vetëvlerësimit vlerëson se rekomandimi i GVJ-së është i drejtë në aspektin e qartësisë formale të ngarkesës me kredite dhe të pozicionimit të Praktikës Profesionale sipas klasifikimit ligjor, dhe do të shërbejë si referencë për rishikimet përkatëse në ciklin pasues të përditësimit kurrikular.
- GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së DB - UT për sugjerimin e sipër cituar, konfirmon që Programi i studimit Master i Shkencave në "Biologji Mjedisore", në planin mësimor të tij duhet të përcaktojë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale (në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar në VKM Nr. 41. Datë 24.01.2018), ku duhet të ishte parashikuar një ngarkesë prej minimumi 10-12 ETCS për praktikën profesionale në kategorinë përkatëse D (Lëndë plotësuese), dhe jo të jetë i shpërndarë zhvillimi i orëve praktike, në lëndë specifike karakterizuese të programit (Kategoria B). Ndërkohë vërehet angazhimi i institucionit për pranimin e sugjerimit mbi përcaktimin e ngarkesës në kredite për realizimin e "Praktikës Profesionale", në kategorinë përkatëse D (Lëndë plotësuese). Ky sugjerim i përmendur nga GVJ në Standardin II.1, kriteri 3, qëndron si nevojë për përmirësim.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standardit II.1 nuk ndryshon duke mbetur i vlerësuar në tërësinë e tij si "përmbyshet kryesisht".

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i "UT":

- Sugjerimi 3 nga GVJ: GVJ rekomandon emërimin e koordinatorit për programin e studimit, i cili do të përfaqësojë personin përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit e praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e përcaktuara; (Standardi II.2, Kriteri 3).
- Përgjigje e DB - UT: Përgjegjësi/ja e Departamentit, në bashkëpunim me përgjegjësin e grup-lëndëve Biologji Molekulare mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për menaxhimin akademik të programit, monitorimin e zbatimit të kurrikulës, koordinimin e stafit akademik, si dhe ndjekjen e praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e programit.
- GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së DB - UT për sugjerimin e sipër cituar, konfirmon që Dekani i FSHN me propozim të Drejtuesit të Departamentit të Biologjisë, duhet të caktojë një personel efektiv në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili do të jetë

përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit duhet të informojë vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse (*Drejtuesin e Departamentit të Biologjisë*) dhe të shqyrtojë cilësinë e syllabuseve përpara miratimit periodik të tyre, gjithashtu duhet të miratojë temat e eseve dhe tezat e provimeve, si edhe duhet të vlerësojë ecurinë e praktikave profesionale.

Ky sugjerim i përmendur nga GVJ në Standardin II.2, kriteri 3, qëndron si nevojë për përmirësim në të ardhmen edhe pse funksioni i Koordinatorit të Programit ekziston dhe ushtrohet nga Përgjegjësi/ja e Departamentit, bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standardit II.2 nuk ndryshon duke mbetur i vlerësuar në tërësinë e tij si “përmbushet kryesisht”.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UT”:

- *Sugjerimi 4 nga GVJ: GVJ rekomandon, që programi të përfshijë të paktën dy tekste të përditësuara si literaturë bazë dhe të detyrueshme për lëndët e tij, me qëllim sigurimin e kompetencave të nevojshme shkencore për ciklin e dytë të studimeve; (Standarti II.4, Kriteri 5); Literatura duhet të citohet korrektësisht dhe të paraqitet si referencë bibliografike. Gjithashtu, institucioni të pasurojë fondin fizik dhe online të bibliotekës, për të garantuar përputhshmërinë e programit me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e ciklit të dytë të studimeve; (Standarti IV.3, Kriteri 2).*
- *Përgjigje e DB - UT: Në studimet Master, ku synohet përvetësimi i njohurive më të avancuara shkencore, tekstet bazë nuk janë gjithmonë burimi më i përshtatshëm, pasi nuk ribotohen shpesh. Syllabuset janë ndryshuar me 20% në pragramin 2025-2026, dhe ndryshimet janë fokusuar në përditësimin e literaturës të 5 viteve të fundit dhe përfshirjen e me shumë se dy teksteve si literaturë bazë. Leksionet e përgatitura nga stafi akademik fokusohen në tematika të reja dhe në arritje shkencore, duke u përditësuar me të dhënat më të fundit dhe shpesh janë më të abdejuara se çdo tekst bazë i botuar gjatë pesë viteve të fundit.*
- *GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së DB - UT për sugjerimin e sipër cituar, konfirmon rekomandimin për përfshirjen e dy teksteve si literaturë bazë të detyrueshme, me qëllim marrjen e kompetencave të duhura shkencore, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe ciklin e dytë të studimeve që i përket programit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”.*

Gjithashtu konfirmon sugjerimin që literatura bazë e detyrueshme dhe ajo ndihmëse (*sipas udhëzimeve të MAS*) duhet të përmbajë botime të pesë viteve të fundit në gjuhën angleze dhe nga shtëpi botuese të njohura dhe nuk duhet të jenë vetëm leksione të përgatitura nga lektori i lëndës. Ky sugjerim do të mundësojë që të sigurohet marrja e kompetencave të duhura shkencore. GVJ konfirmon gjithashtu edhe sugjerimin mbi modelin e një reference bibliografike me detajet e

duhura në përshkrimin e literaturës bazë në syllabuse. Gjithashtu vërehet angazhimi i institucionit për pranimin e sugjerimeve për përmirësime duke filluar që nga viti akademik 2025-2026 dhe në vijim në lidhje me formalitetin e pasurimit dhe përditësimit të literaturës në syllabuset e programit. Megjithatë, ky sugjerim i përmendur nga GVJ në Standardin II.4, kriteri 5 si edhe në Standardin IV.3, kriteri 2, qëndrojnë si nevojë për përmirësim.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standardit II.4. dhe Standardit IV.3 nuk ndryshojnë duke mbetur të vlerësuar në tërësinë e tyre si “përmbushet kryesisht”.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UT”:

- *Sugjerimi 5 nga GVJ: Të krijohet “Bordi i Tregut të Punës”, ose një strukturë e ngjashme, e cila do të kontribuojë në këshillimin e karrierës së studentëve dhe në hartimin e propozimeve për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës; (Standarti II.5, Kriteri 1).*
- *Përgjigje e DB - UT: Në Universitetin e Tiranës, Bordi i Administrimit analizon tregun e punës, përcakton prioritetet strategjike dhe miraton buxhetin vjetor, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e programeve të studimit.*
- *GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së DB - UT për sugjerimin e sipër cituar, konfirmon faktin që Bordi i Tregut të Punës ose një tjetër Strukturë e ngjashme me të, do të ishin instrumente mjaft të rëndësishëm për këshillimin e karrierës së studentëve si edhe për propozimet e mundshme që do të ndihmonin për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulave. Megjithatë, ky sugjerim i përmendur nga GVJ në Standardin II.5, kriteri 1, qëndron si nevojë për përmirësim, edhe pse standardet dhe kriteret e cituara më sipër, janë vlerësuar maksimalisht nga GVJ.*

Për sa më sipër, vlerësimi i Standardit II.5 nuk ndryshon pasi është vlerësuar në tërësinë e tij si “përmbushet plotësisht”.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UT”:

- *Sugjerimi 6 nga GVJ: Institucioni të hartojë një udhëzues të unifikuar për veprimtaritë akademike formuese dhe për procesin e vlerësimit, duke përfshirë të gjitha komponentët e nevojshëm. Aktualisht mungon një format i unifikuar vlerësimi mes lëndëve të ndryshme dhe “Provimi i Ndërmjetëm” nuk zhvillohet në mënyrë të rregullt (aplikohet vetëm në katër lëndë). Udhëzuesi duhet të sigurojë kontroll të vazhdueshëm të njohurive dhe t’u mundësojë studentëve identifikimin dhe përmirësimin e mangësive përpara përfundimit të semestrit; (Standarti III.1, Kriteri 1); (Standarti III.2, Kriteri 3); (Standarti III.3, Kriteri 1).*

- Përgjigje e DB - UT: Ne vlerësojmë se ky rekomandim është i pabazuar dhe sugjerojmë që vlerësimi për këtë aspekt të rishikohet në “Përmbushet plotësisht”, pasi rekomandimi aktual është i përgjithshëm dhe nuk mbështetet në fakte konkrete ose vëzhgime të qarta lidhur me mosrealizime apo boshllëqe në vlerësimin e studenteve.
- GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së DB - UT për sugjerimin e sipër cituar, konfirmon rekomandimin mbi unifikimin e shpërndarjes së veprimtarive akademike në nivel institucional, duke përfshirë mësimdhënien, mësim nxënien dhe vlerësimin e njohurive. Ky sugjerim do të mundësojë që kontrolli i dijeve të jetë i vazhdueshëm dhe do të lejojë studentët të identifikojnë e plotësojnë mangësitë e tyre para përfundimit të semestrit. Megjithatë, ky sugjerim për përmirësime në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së ngarkesës mësimore sipas veprimtarive formuese i përmendur nga GVJ në Standardin III.1, kriteri 1, Standardin III.2, kriteri 3, si edhe në Standardin III.3, kriteri 1, qëndron si nevojë për përmirësim.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standarteve III.1. dhe III.3. nuk ndryshon pasi janë vlerësuar në tërësinë e tyre si “përmbushen plotësisht” dhe Standardit III.2 nuk ndryshon duke mbetur i vlerësuar në tërësinë e tij si “përmbushet kryesisht”.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UT”:

- Sugjerimi 7 nga GVJ: Të implementohet një sistem elektronik për kontrollin e dijeve, me synim rritjen e transparencës dhe minimizimin e abuzimeve gjatë procesit të vlerësimit; (Standarti III.3, Kriteri 2). Gjithashtu, institucioni të vërë në dispozicion një platformë të licencuar për kontrollin e plagjiaturës, të aksesueshme nga stafi akademik dhe studentët; (Standarti III.3, Kriteri 5).
- Përgjigje e DB - UT: Për shkak të natyrës së programit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, i cili fokusohet në kuptimin e mekanizmave molekularë dhe në zhvillimin e aftësive analitike dhe interpretuese, kontrolli i njohurive përmes pyetjeve të standardizuara të vlerësueshme elektronikisht nuk ka rezultuar mënyra më e përshtatshme për formimin dhe vlerësimin e koncepteve dhe njohurive thelbësore të këtij cikli studimi.
Sa i përket kontrollit të plagjiaturës, Universiteti i Tiranës është në proces të sigurimit të një sistemi të unifikuar dhe të licencuar, i cili do të jetë i aksesueshëm për stafin akademik dhe studentët, në përputhje me standardet e integritetit akademik.
- GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së DB - UT për sugjerimin e sipër cituar, konfirmon rekomandimin mbi implementimin e një sistemi elektronik korrigjimi, me qëllim rritjen e transparencës dhe shmangjen e formave të ndryshme abuzuese gjatë procesit të vlerësimit.

Ndërsa lidhur me kontrollin e plagjiaturës vërehet angazhimi i institucionit për pranimin e sugjerimit për përmirësime në vijim lidhur me sigurimin e një sistemi elektronik të licensuar për

kontrollin e plagjiaturës. Megjithatë, ky sugjerim i përmendur nga GVJ në Standardin III.3 kriteri 2 dhe 5, qëndron si nevojë për përmirësim, edhe pse standardi dhe kriteret e cituara më sipër, janë vlerësuar maksimalisht nga GVJ.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standardit III.3 nuk ndryshon pasi është vlerësuar në tërësinë e tij si “përmbushet plotësisht”.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UT”:

- *Sugjerimi 8 nga GVJ: Institucioni të përgatisë udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, në përputhje me programin e studimit; (Standarti VI.1, Kriteri 1).*
- *Përgjigje e DB - UT: Pjesëmarrja e pedagogëve dhe kërkuesve të huaj në praktika në terren dhe seminare kualifikuese ofron një udhëzues praktik dhe efektiv për metodat inovative në mësimdhënie dhe kërkimit, duke garantuar përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe zgjerimin të eksperiencës pedagogjike për studentët.*
- *GVJ: Nga shqyrtimi i përgjigjes së DB - UT për sugjerimin e sipër cituar, konfirmon rekomandimin që Institucioni duhet të hartojë dhe të vendosë në dispozicion në të ardhmen në nivel institucional, një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. Megjithatë, ky sugjerim i përmendur nga GVJ në Standardin VI.1, kriteri 1, qëndron si nevojë për përmirësim.*

Për sa më sipër, vlerësimi i Standardit VI.1. nuk ndryshon duke mbetur i vlerësuar në tërësinë e tij si “përmbushet kryesisht”.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Komenti i “UT”:

- *Sugjerimi 9 nga GVJ: GVJ rekomandon caktimin e Përgjegjësit të grup-lëndëve, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, si një mekanizëm i domosdoshëm për garantimin e organizimit akademik, cilësisë së programeve dhe zbatimit të standardeve të MAS, gjithashtu ky pozicion do të luajë një rol pozitiv duke ndihmuar në koordinimin efektiv ndërmjet personelit efektiv dhe atij me kontratë; (Standarti I.3, Kriteri 1).*
- *Përgjigje e DB - UT: Departamenti i Biologjisë është i organizuar në 5 grupe mësimore-kërkimore, secila me përgjegjës grupi. Kjo vërejtje nuk qëndron, pasi struktura ekziston dhe funksionon në mënyrë të plotë.*

- **GVJ:** Nga shqyrtimi i përgjigjes së DB - UT për sugjerimin e sipër cituar, konfirmon rekomandimin mbi caktimin e Përgjegjësit të grup-lëndëve, në përputhje me “Ligjin nr. 80/2015” dhe “VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar”, si një mekanizëm i domosdoshëm për garantimin e organizimit akademik, cilësisë së programeve e mësimdhënies, zbatimin e planit mësimor dhe zbatimit të standardeve të MAS. Përgjegjësi i grupeve kërkimore që ka caktuar institucioni lidhet me punën kërkimore shkencore dhe nuk mund të garantojë organizimin akademik, cilësinë e programeve dhe syllabuseve, duke mos ndihmuar pozitivisht për koordinimin efikas midis personelit efektiv dhe atij me kontratë.

Megjithatë, ky sugjerim i përmendur nga GVJ në Standardin I.3 kriteri 1, qëndron si nevojë për përmirësim, edhe pse standardi dhe kriteret e cituara më sipër, janë vlerësuar maksimalisht nga GVJ.


Për sa më sipër, vlerësimi i Standardit I.3 nuk ndryshon pasi është vlerësuar në tërësinë e tij si “përbushet plotësisht”.

Komenti merret parasysh por RVJ nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteret Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>FSHN si pjesë e UT, me anë të Departamentit të Biologjisë ofron programin Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” me synim sigurimin e njohurive të thelluara në këtë fushë, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në Biologji, Bioteknologji, Veterinari ose në drejtime të tjera të ngjashme (<i>përfunduar edhe jashtë vendit</i>) si edhe që kanë kryer ciklin e dytë Master Profesional në Biologji / Biologji Molekulare ose DIND në Mjekësi të Përgjithshme.</p> <p>Njohuritë e fituara në këtë program i shërbejnë interesit kombëtar dhe kontribuojnë në fusha të thelluara teorike e praktike si: Gjenetikë Molekulare, Fiziologji Molekulare, Mikrobiologji e avancuar, Imunologji, si edhe të Bioteknologjisë dhe Biokimisë. Programi bazohet në studime të avancuara për interpretimin, analizën dhe të kuptuarin e proceseve biologjike, në të gjithë kompleksitetin e tyre, si dhe të problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare deri edhe ndikimin e qelizave burimore në Mjekësinë rigjeneruese, duke përmbushur objektivat strategjike të Universitetit të Tiranës, me fokus të veçantë në FSHN.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p>



	<p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” është në përputhje me strategjinë e Universitetit të Tiranës si edhe me strategjinë e Njesisë Kryesore duke zbatuar objektivat specifike në lidhje me fushën e studimit në Biologji Molekulare. Programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” realizon plotësisht objektivat strategjike të institucionit, të Fakultetit të Shkencave të Natyrës si dhe të Departamentit të Biologjisë që e ofron këtë program studimi. Institucioni evidenton, përmes studimeve të tregut të punës, rëndësinë dhe vlerën që ky program ka në përgatitjen e specialistëve të nevojshëm për këtë fushë.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Plani Strategjik i Zhvillimit të UT përcakton se programet e studimeve janë krijuar për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit. Në përputhje me këtë vizion dhe për të përmbushur objektivat strategjike të këtij programi studimi, FSHN ka prioritet progresiv zhvillimin dhe fuqizimin e studentit.</p> <p>Pas përfundimit me sukses të ciklit të dytë të studimeve, studenti pajiset me diplomën Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” dhe aftësohet për të kryer shërbime profesionale të specializuara në kuadër të interpretimit, analizës dhe të kuptuarit të proceseve biologjike si edhe problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare. Gjithashtu, studenti është i përgatitur për punësim dhe karrierë të avancuar në pozicione të rëndësishme institucionale shkencore, mjekësore ose industri, në institucione të arsimit të lartë edhe si ekspertë të çështjeve komplekse të biologjisë dhe diagnostikimit molekular si në sektorin publik ashtu edhe atë privat, ku kërkohet menaxhimi dhe</p>

	<p>përdorimi i sistemeve bashkëkohore, duke iu përshtatur teknologji ve inovative aktuale.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.22: Kuotat e Pranimit për Ciklin e parë dhe të Dytë</i></p> <p><i>Evidencë 1.23: Kriteret e Pranimit MSc viti akademik 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë 1.18: Studim i tregut të punës UT</i></p> <p><i>Evidencë 2.18: Studim i tregut të punës DB - Biologji Molekulare</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare dhe vizionin për arritjen e objektivave strategjike të këtij programi studimi.</p> <p>FSHN ka si prioritet kryesor zhvillimin e mëtejshëm të studentëve, të cilët, pas përfundimit të ciklit të parë Bachelor në “Biologji Molekulare”, pajisen me diplomën përkatëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”. Studenti aftësohet për të ofruar shërbime profesionale të specializuara lidhur me zbatimin e metodave të përshtatshme shkencore për interpretimin, analizën dhe të kuptuarin e proceseve biologjike, si edhe të problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare, duke qënë i përgatitur për punësim në sektorin publik apo privat, aty ku kërkohet menaxhimi dhe përdorimi i sistemeve moderne të diagnostikimit molekular, duke u përshtatur optimalisht edhe me teknologjitë inovative të kohës.</p> <p>Programi Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” dhe strategjia e zhvillimit të tij është hartuar në përputhje me ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", duke realizuar vizionin, strategjinë dhe interesat kombëtare si dhe përfaqshjen globale të zhvillimit kombëtar.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p>

	<p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi studimit Master i Shkencave në "Biologji Molekulare" ofrohet në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe strategjinë e zhvillimit të UT.</i></p> <p><i>Programi bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe në aktet e hartuara dhe miratuara nga UT dhe FSHN.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti i Tiranës përfaqëson Institucionin më të hershëm të Arsimit të Lartë të kategorisë universitare duke qënë pjesë e Universitetit Shtetëror të Tiranës që nga viti 1957.</p> <p>UT dhe FSHN deklarojnë se zotërojnë burimet e nevojshme në fushën akademike, veçanërisht për këtë sektor të specializuar në Biologjinë Molekulare me fokus fushën kërkimore rreth zbatimit të metodave të përshtatshme shkencore mbi interpretimin, analizën dhe të kuptuarit e proceseve biologjike molekulare.</p> <p>Sipas dokumentacionit të paraqitur dhe pas vizitës së realizuar nga GVJ në institucion, si dhe informacionit të detajuar të mbledhur për këtë program studimi, rezulton se FSHN disponon kapacitetet laboratorike mbi biologjinë molekulare dhe burimet akademike e administrative të nevojshme për ofrimin e këtij programi studimi në fushën akademike të biologëve diagnostikues molekulare.</p> <p><i>Evidencë 1.20: Raporti vjetor FSHN UT 2023-2024</i></p>

	<p><i>Evidencë 5.9: Raporti vjetor FSHN UT 2022-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.26: Certifikata e Akreditimit Institucional UT</i></p> <p><i>Evidencë 2.11: Urdhër Hapjeje e Programit - VKM1225.</i></p> <p><i>Evidence 2.3: Model diplome Master Bio. Molekulare</i></p> <p><i>Evidence 2.4: Supplement Diplome MSc Bio. Molekulare 2024</i></p> <p><i>Evidencë: CV Staf Akademik - MSc - Bio. Molekulare 2025</i></p> <p><i>Evidencë 1.15: Dëshmi dhe Titujt e Kualifikimit MSc - Bio. Molek.</i></p> <p><i>Evidencë 2.8: Kualifikimi i stafit, dokumenti i titujve.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 6.1 - 6.3 e personelit akademik të angazhuar në MSc Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 4.15.1: Infrastruktura FSHN (Salla, laboratorë, biblioteka)</i></p> <p><i>Evidencë 4.15.2: Infrastruktura FSHN (Gjithsej)</i></p> <p><i>Evidencë 4.16: Foto laboratorit i Biologjisë Molekulare</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Në lidhje me programin e studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, FSHN thekson se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore përkatëse përgjegjëse për këtë program studimi, që është Departamenti i Biologjisë.</p> <p>Ky program ofrohet me 120 ECTS për dy vite akademike, dhe pas përfundimit të tij, studentët pajisen me Diplomën Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, e cila korrespondon me nivelin 7 të EQAF ose Kornizën e Kualifikimit të Diplomave (KSHK) dhe është në përputhje me direktivat evropiane, si dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në harmoni me fushën akademike dhe kërkimore të FSHN, duke synuar të formojë biologë diagnostikues molekularë profesionistë me kompetencë të lartë në njohjen e deontologjisë dhe etikës profesionale si edhe legjislacionit mjedisor vendas dhe konventave ndërkombëtare. Biologët molekularë të formuar do të jenë të aftë të njihen me kompetencat e nevojshme për tu punësuar në institucione të ndryshme që lidhen me fushat e</p>

	<p>zbatimit të Biologjisë Molekulare me fokus Gjenetikën dhe Fiziologjinë Molekulare, Mikrobiologjinë e avancuar, Imunologjinë, Bioteknologjinë dhe Biokiminë.</p> <p>Studentët e diplomuar nga ky program studimi perfeksionohen me njohuri të thelluara mbi: strukturën dhe sjelljen e molekulave biologjike dhe mekanizmave të bashkëveprimit të tyre; shprehjen e rregullimin e gjeneve; replikimin dhe riparimin e ADN-së; sinjalizimin dhe komunikimin qelizor; strukturën dhe funksionimin e proteinave; gjenomikën dhe proteomikën; neuroshkencat, mikrobiologjinë molekulare, bazat molekulare të sëmundjeve; analizat e biologjisë së zhvillimit; fiziologjinë qelizore dhe molekulare, imunologjinë molekulare; biologjinë e kancerit; biologjinë sintetike; qelizat burimore dhe mjekësinë rigjeneruese. Ata zotërojnë njohuri të mira në disa sektorë, si:</p> <p><i>shëndetësisë dhe analizave gjenomike</i> - duke ndihmuar në diagnostikimin më të hershëm dhe të saktë të sëmundjeve, duke përfshirë testet biomolekulare dhe gjenetike;</p> <p><i>farmaceutikës dhe bioteknologjisë</i> - për prodhimin e biomolekulave terapeutike apo kontributin në krijimin e start-up-ëve;</p> <p><i>mjedisit</i> - ku biologët molekularë ndihmojnë në identifikimin dhe ruajtjen e specieve në zhdukje dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore,</p> <p>si edhe sektorit të <i>bujqësisë dhe ushqimit</i>.</p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë,</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” është i hartuar për t’iu përgjigjur fushës specifike dhe të jetë në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.</p> <p>Fusha e studimit duke qënë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin e studimit, ka si</p>

<p>përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>qëllim të formojë teknikë profesionistë që kanë njohuri të thelluara mbi: strukturën e molekulave biologjike dhe mekanizmeve të bashkëveprimit të tyre; shprehjen e rregullimin e gjeneve; replikimin dhe riparimin e ADN-së; sinjalizimin dhe komunikimin qelizor; strukturën dhe funksionimin e proteinave; gjenomikë dhe proteomikë; neuroshkenca, bazat molekulare të sëmundjeve; mikrobiologji molekulare, analiza e biologjisë së zhvillimit; fiziologjinë qelizore dhe molekulare, imunologjinë molekulare; biologjinë e kancerit; biologjinë sintetike; qelizat burimore dhe implikimin në mjekësinë rigjeneruese.</p> <p>Studentët e diplomuar zotërojnë kompetencat e duhura profesionale në zbatimin e metodave të përshtatshme shkencore për interpretim, analizë dhe të kuptuarit të proceseve biologjike, në të gjithë kompleksitetin e tyre, si dhe të problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare, duke përdorur me lehtësi përveç teknikave laboratorike edhe metodat e duhura bioinformatike, biostatistikore dhe bioteknologjike.</p> <p>Gjithashtu studentët e diplomuar zotërojnë kompetencat e duhura profesionale edhe në kërkimin dhe hulumtimin shkencor, duke i bërë të aftë për tu punësuar në institucione publike e private shkencore, mjekësore ose industriale, në institucione të arsimit të lartë, si ekspertë të çështjeve komplekse të biologjisë molekulare dhe diagnostikimit molekular, etj.</p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master Profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>FSHN dhe Departamenti i Biologjisë nuk ofrojnë një rast të tillë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron</p>	<p>FSHN ofron informacione për mundësitë e punësimit për studentët e programit Master i Shkencave në “Biologji</p>

trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.

Molekulare”, si gjatë periudhës së studimeve ashtu edhe pas diplomimit.

Gjithashtu UT ka ngritur si strukturë “Qendrën Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit” me kompetencat për të organizuar rregullisht një sërë aktivitetesh si konferenca shkencore, trajnime, workshop-e, seminare, leksione të hapura, etj., me qëllim identifikimin e nevojave mbi edukimin në vazhdim dhe zhvillimin e kompetencave inovative profesionale, në shërbim të stafit, studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar, etj.

Pas përfundimit të studimeve, studentët përfitojnë shërbim këshillimi për karrierën, i cili ndihmon në procesin e integritimit në tregun e punës. Zyra e Karrierës dhe Alumni, përmes kurseve kualifikuese dhe konferencave shkencore, siguron komunikim të vazhdueshëm për aktivitetet në bashkëpunim me partnerët e tregut të punës, në nivel fakulteti e universiteti për studentët e diplomuar.

Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare

Evidencë 1.18: Studim i tregut të punës UT

Evidencë 2.18: Studim i tregut të punës DB - Biologji Molekulare

Evidencë 1.13: Databazë Alumni Biologji. Mars 2025

Evidencë 1.12: Database i pyetësorëve për studimin e tregut të punës të studentëve të diplomuar në Departamentin e Biologjisë

Evidencë 6.2: Formular për gjurmimin e të diplomuarve, FSHN, UT

Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021

Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi

Evidencë 1.21: Mbi thirrjen për shprehje interesi të trajnerëve të Qendrës Virtuale të Trajnimit dhe Zhvillimit profesional të UT-së

Evidencë 1.25: Komisionet UT. Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët.

Konkluzione	<p><i>FSHN disponon përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”.</i></p> <p><i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi studimi janë në përputhje me fushën kërkimore të Njesisë Kryesore (FSHN, UT) dhe Njesisë Bazë (Departamenti Biologji).</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Institucioni thekson se, për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, UT siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësive e personelit. Aktiviteti akademik dhe administrativo-financiar i institucionit pasqyrohet në analizën vjetore institucionale. Sipas takimit të zhvilluar me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë, bashkëpunimi dhe asistimi janë disa nga themelet kryesore të funksionimit të këtij institucioni.</p> <p><i>GVJ rekomandon caktimin e Përgjegjës të grup-lëndëve, në përputhje me “Ligjin nr. 80/2015” dhe “VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar”, si një mekanizëm i domosdoshëm për garantimin e organizimit akademik, cilësisë së programeve dhe zbatimit të standardeve të MAS, duke luajtur gjithashtu një rol shumë pozitiv në ndihmën për koordinimin efikas midis personelit efektiv dhe atij me kontratë.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.20: Raporti vjetor FSHN UT 2023-2024</i></p>

	<p><i>Evidencë 3.4: Raporti vjetor per vleresimin e cilesise se programeve te studimit ne FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 6.14: Plani i masave për përmirësimin e procesit mësimor</i></p> <p><i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor 2023-2024 DSBCK</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK)</i></p> <p><i>Evidencë 5.1: Vendim i Dekanit, 215. Miratim rregulloresh për Degën mësimore, DSBCK dhe Bibliotekën</i></p> <p><i>Evidencë: Ligji nr. 80/2015, neni 6, neni 23 dhe neni 71 (autonomia akademike dhe organizimi i programeve të studimit)</i></p> <p><i>Evidencë: VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, për elementët përbërës dhe organizimin e programeve të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe takimet e realizuara me drejtuesit e fakultetit dhe departamentit të biologjisë, lidhur me realizimin e procesit mësimor, për kryerjen e praktikave dhe arritjen e objektivave, UT në përgjithësi dhe FSHN në veçanti ka nënshkruar marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi me institucione arsimore në funksion të programit të studimit të biologjisë molekulare, si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, ku përmendim përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit shkencor në kuadër të programeve Erasmus+ dhe CEEPUS.</p> <p>Këto marrëveshje shërbejnë për të ofruar mundësi shkëmbimi të dijeve dhe bashkëpunimeve, ku në kuadër të realizimit të objektivave të programit të studimit Departamenti i Biologjisë bashkëpunon ngushtë edhe me institucione si: Instituti i Shëndetit Publik, Intermedica Center, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaktit, LLC Center for Ecotoxicological Research Podgorica, Qendra Kërkimore e Florës dhe e Faunës, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore - AKBN, Trimed (<i>Health care</i>), etj.</p> <p>Në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe marrëveshjet e nënshkruara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, realizohen praktikat profesionale si edhe arrihen objektivat akademike të procesit mësimor e formues të studentëve.</p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p>




	<p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 5: Institucionet dhe Oraganizat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikrat Profesionale me Institucionet e tjera.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 20: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit parashikon kryerjen e praktikave profesionale dhe klinike në institucione me të cilat UT dhe FSHN kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Në këtë kontekst, UT dhe FSHN kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore në nivel qendror si ISHP, AKBN, AKZM, QKTGJ, Klinikën Intermedica, Trimed dhe ISUV. Praktikrat realizohen gjithashtu edhe në Muzeun e Shkencave të Natyrës dhe Departamentin e Bioteknologjisë duke shfrytëzuar edhe laboratorët kërkimorë e shkencorë. Gjatë kryerjes së praktikës, studentët mbikëqyren prej stafit akademik të institucionit dhe nga drejtuesi i praktikës në institucionin përkatës.</p> <p>Përveç kësaj, duke shfrytëzuar të dhënat sasiore dhe cilësore të marra nga raste konkrete gjatë zhvillimit të praktikave mësimore, si dhe duke përfituar nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet përkatëse, realizohen kërkime shkencore dhe mobilitete të personelit akademik, por edhe të studentëve.</p> <p><i>Evidencë 1.20: Raporti vjetor FSHN UT 2023-2024</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p>

	<i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 5: Institucionet dhe Oraganizat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikrat Profesionale me Institucionet e tjera.</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>UT, FSHN dhe Departamenti Biologjisë, zbatojnë marrëveshjet e lidhura me homologët dhe institucionet e huaja dhe vendase kryesisht për realizimin e praktikave profesionale.</p> <p>GVJ konstaton raporte analitike të hartuara rreth përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të program studimit.</p> <p><i>Evidencë 1.20: Raporti vjetor FSHN UT 2023-2024</i></p> <p><i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor 2023-2024 DSBCK</i></p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 14: Raport Analitik nbi Përfitimet nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit 2021-2024</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 5: Institucionet dhe Oraganizat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikrat Profesionale me Institucionet e tjera.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 20: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i></p>
Konkluzione	<p>- UT, FSHN dhe Departamenti i Biologjisë kanë lidhur një sërë marrëveshjes bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, për të ofruar mundësi shkëmbimi dijesh e bashkëpunimi, ku realizohen praktikrat profesionale të studentëve, gjithashtu konstatohet edhe përpilimi i raporteve analitike të hartuara rreth përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit.</p> <p>- GVJ rekomandon caktimin e Përgjegjës të grup-lëndëve, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe VKM nr. 41, datë</p>

	24.01.2018, e ndryshuar, si një mekanizëm i domosdoshëm për garantimin e organizimit akademik, cilësisë së programeve dhe zbatimit të standardeve të MAS, gjithashtu këto pozicione do të luajë një rol pozitiv duke ndihmuar në koordinimin efektiv ndërmjet personelit efektiv dhe atij me kontratë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit për ciklin e dytë Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” është i strukturuar në lëndë dhe module të cilat vlerësohen me kredite, në përputhje me Ligjin 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program përfshin 120 kredite ECTS dhe 3000 orë të angazhimit. Plani mësimor përmban leksione, seminare dhe provime përfundimtare (rrallë edhe provime të ndërmjetme).</p> <p><i>Lëndët nuk janë organizuar në pesë kategori që duhet të jenë A, B, C, D dhe E, por është shtuar edhe kategoria F.</i></p> <p><i>GVJ konstaton që Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen jo në përputhje me “VKM Nr. 41. Datë 24.01.2018”, lidhur me ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave”, por për hartimin e Planit Mësimor është ndjekur</i></p>

organizimi i lëndëve i ndarë për Veprimtaritë Formuese që i përket atij të ciklit të parë të programeve të studimit në “Bachelor”, konkretisht:

- 1. **Kategoria A: Lëndë bazë - Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme**, duhet 5%-10% dhe është paraqitur 15-20%, e përbërë nga 2 module lëndësh me 11 Kredite total.*
- 2. **Kategoria B: Lëndë karakterizuese të programit - Përgatitje për disiplinën shkencore**, duhet 50%-60% dhe është paraqitur 50-55%, e përbërë nga një total prej 42 kreditesh për 7 provime të përcaktuara.*
- 3. **Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore ose integruese, Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje**, nga 12%-20% që duhej, është dhënë me 12-15%, me një total prej 15 kreditesh për 3 module lëndësh të paracaktuara.*
- 4. **Kategoria D: Lëndë plotësuese - Gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale**, duhet 10% dhe është paraqitur me 10-15%, me një total prej 22 kreditesh për 4 provime.*
- 5. **Kategoria E: Detyrime përmbyllëse, Punimi i Diplomës** nga 10%-25% që duhet, është dhënë me një shpërndarje prej 3-5% (30 ECTS).*

GVJ vlerëson që të rishikohet shpërndarja e lëndëve-moduleve në dy kategoritë përkatëse, Kategoria B - Lëndë karakterizuese të programit dhe Kategoria D - Lëndë plotësuese, në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar për këto dy kategori.

Konkretisht në kategorinë B, ka një devijim me 15% më pak se minimumi i lejuar (50%), në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar 50%-60%.

Gjithashtu edhe në kategorinë D, ka një devijim me afër 8% më shumë se përqindja e paracaktuar e lejuar 10%.

Gjithashtu GVJ konstaton një tjetër problematikë serioze lidhur me ofrimin e Lëndëve me Zgjedhje “Jo” në “Kategorinë C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese” ku duhet të jenë, por në “Kategorinë D - Lëndë Plotësuese”.

	<p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Qëllimi kryesor i programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” është të formojë biologë ekspertë diagnostikues molekularë profesionistë me kompetencë të lartë në njohjen e etikës profesionale, legjislacionit vendas dhe konventave ndërkombëtare. Biologët molekularë të formuar nga ky program studimi perfeksionohen me njohuri të thelluara në zbatimin e metodave të përshtatshme shkencore për interpretim, analizë dhe të kuptuarit të proceseve biologjike, në të gjithë kompleksitetin e tyre, si dhe të problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare, duke përdorur me lehtësi përveç teknikave laboratorike edhe metodat e duhura bioinformatike, biostatistikore dhe bioteknologjike, duke i bërë të aftë për tu punësuar në institucione publike e private shkencore, mjekësore ose industriale, në institucione të arsimit të lartë, si ekspertë të çështjeve komplekse të biologjisë molekularë dhe diagnostikimit molekular, etj.</p> <p>Ata zotërojnë njohuri të mira mbi strukturën e molekulave biologjike; shprehjen e rregullimit të gjeneve; replikimin dhe riparimin e ADN-së; sinjalizimin dhe komunikimin qelizor; strukturën dhe funksionimin e proteinave; gjenomikën dhe proteomikën; neuroshkencat, bazat molekularë të sëmundjeve; mikrobiologjinë molekulare, analizat e biologjisë së zhvillimit; fiziologjinë qelizore dhe molekulare, imunologjinë molekulare; biologjinë e kancerit; biologjinë sintetike; qelizat burimore dhe implikimin në mjekësinë rigjeneruese.</p> <p>Të gjitha lëndët bazë në këtë program pasohen nga ato të specialiteteve, duke u dhënë studentëve njohuri diagnostike specifike mbi interpretimin dhe analizën e proceseve biologjike, duke përfshirë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të vlerësimit dhe zgjidhjes së problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare. Lëndë të tilla si</p>

	<p>“Gjuhë Shkencore Angleze”, “Biofizika”, “Bioinformatika”, “Analiza Biostatistike”, etj. përfshihen me qëllim përgatitjen sa më të mirë të mundshme të studentëve.</p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, në planin mësimor të tij nuk e ka përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale, ku në fakt duhej të ishte parashikuar një ngarkesë prej minimumi 10-12 ETCS për praktikën profesionale në kategorinë përkatëse D (Lëndë plotësuese), por i ka shpërndarë orët praktike, në lëndë specifike karakterizuese të programit (Kategoria B). Në planin mësimor gjithashtu është përcaktuar finalizimi i studimeve me provimin e diplomës me Mikrotezë, me ngarkesë 30 ECTS.</p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësimit i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>

<p>programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>




<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVJ konstaton që FSHN dhe vetë Departamenti i Biologjisë si njësi përgjegjëse, është kujdesur që programi i ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, të ketë përmbajtje të ngjashme në nivelin 70% me programet ekuivalente që ofrohen me të njëjtën emërtesë dhe i përkasin të njëjtës fushë studimi dhe cikli studimi, si brenda e jashtë vendit, ku përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Universiteti Bujqësor i Tiranës / UBT - Master i Shkencave “BioKimi” - Universiteti i Mjekësisë - Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike - Master i Shkencave “Teknik Laboratori Mjekësor” - Vienna University, Austria - Master Shkencor “Biologji Molekulare” - Universita degli Studi di Padova, Italia - Master Shkencor “Biologji Molekulare” <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.18: Studim i tregut të punës DB - Biologji Molekulare</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe shoqërohet me kodin përkatës (72MS0521SH110 në ISCED 2011), sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Gjithashtu është realizuar kodifikimi i lëndëve të programit të studimit (KSHK).</p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.11: Urdhër Hapjeje e Programit - VKM1225.</i></p> <p><i>Evidencë 1.26: Certifikata e Akreditimit Institucional UT</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>

<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Nuk aplikohet.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>- Programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” përmban të gjithë elementët e strukturës së programit të studimit të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe në aktet e brendshme rregullatorë dhe ky program studimi i takon nivelit 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve,.</p> <p>- Ky program ka ngjashmëri mbi 70% me programe të tjera të njëjta që ofrohen brenda dhe jashtë vendit, ndërsa çdo lëndë ka një numër kreditesh të përcaktuara.</p> <p>- GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së lëndëve-moduleve sipas kategorive përkatëse në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar në VKM Nr. 41. Datë 24.01.2018, ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kategoria B (Lëndë Karakterizuese) ka mosplotësim të numrit minimal të Krediteve 50%-60% (-18 ECTS) ➤ Kategoria D (Lëndë Plotësuese) ka tejkalim të numrit minimal të Krediteve 10% (+10 ECTS) <p>- GVJ rekomandon gjithashtu që në planin mësimor të Programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. të përcaktohet ngarkesa në kredite për realizimin e “Praktikës Profesionale”, në kategorinë përkatëse D (Lëndë plotësuese) 2. <u>Lëndët me zgjedhje që ofrohen, të vendosen në Kategorinë C</u> - Lëndë ndërdisiplinore/integruese ku duhet të jenë. 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ka përgjegjësi për programet që ofrohen në Njësitë bazë ose Departamentet e saj, njësi të cilat përmbushin detyrimin ligjor për numrin e personelit dhe titujve akademikë. Departamenti i Biologjisë, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, është njësi bazë përgjegjëse, si edhe në të njëjtë kohë përmbush detyrimet ligjore për të ofruar programin e studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”. Në përbërje të tij, Departamenti i Biologjisë, për tre vitet e fundit akademike, është si më poshtë:</p> <p>Viti Akademik: 2023-2024: PAE 26 Prof. Dr. 11, Prof. As 4, Dr. 11, Msc. 0. PAK 9 Prof. Dr. 2, Prof. As 3, Dr. 2, Msc. 2.</p> <p>Viti Akademik 2022-2023: PAE 26 Prof. Dr. 10, Prof. As 5, Dr. 11, Msc. 0. PAK 6 Prof. Dr. 3, Prof. As 2, Dr. 0, Msc. 1.</p> <p>Viti Akademik 2021-2022: PAE 25 Prof. Dr. 11, Prof. As 5, Dr. 9, Msc. 0. PAK 5 Prof. Dr. 2, Prof. As 0, Dr. 0, Msc. 3.</p> <p>GVJ konstaton se për çdo vit akademik është respektuar standardi i kërkuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas të cilit personeli akademik efektiv (PAE) duhet të përbëjë 70% të stafit akademik kundrejt stafit të angazhuar me kohë të pjesshme. Konkretisht për vitet akademike 2021-2024, ky raport është mesatarisht në masën 80% PAE - 20% PAK.</p> <p>Departamenti i Biologjisë, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, si njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit në fushën e mësimdhënies ka për detyrë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitjen e profileve dhe përmbajtjeve të lëndëve për diplomat e ciklit të parë, të dytë e të tretë të studimit, si dhe për

	<p>programet me karakter profesional që ndodhen nën administrimin e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Administrimin dhe organizimin e profileve të kërkimit shkencor për diplomat e ciklit të dytë, veçanërisht për projektet kërkimore. - Bashkëpunimin me departamentet e tjera të Universitetit për realizimin e planeve mësimore. <p><i>Evidencë 2.11: Urdhër Hapjeje e Programit - VKM 1225.</i></p> <p><i>Evidencë 1.26: Certifikata e Akreditimit Institucional UT</i></p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 1 & 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>FNSH dhe Departamenti i Biologjisë si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, përbush plotësisht të gjitha detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Biologjisë mundësojnë angazhimin e personelit të duhur ndihmës akademik, aktualisht 6 (gjashtë) personel të punësuar në këtë cilësi pranë Departamentit të Biologjisë, i cili kontribuon në realizimin efektiv të praktikave profesionale dhe laboratorike.</p> <p>Kryesisht për zhvillimin e praktikave profesionale, studentët mbikëqyren prej stafit akademik të institucionit dhe nga drejtuesi i praktikës në institucionin përkatës, që vjen nga Muzeu i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Bioteknologjisë, Klinika Intermedica, duke shfrytëzuar laboratorët kërkimorë e shkencorë. Përgjegjësi i njësisë bazë, organizon ndarjen e punës për koordinatorët që mbikëqyrin praktikat profesionale në të gjitha institucionet me të cilat UT, FSHN dhe vetë Departamenti i Biologjisë kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, ku përmendim edhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione shtetërore në nivel qendror si ISHP, QKTGJ, AKBN, AKZM dhe ISUV.</p>

	<p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 1 & 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 5: Institucionet dhe Oraganizat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikant Profesionale me Institucionet e tjera.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) – Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p><i>Dekani i FSHN me propozim të Drejtuesit të Departamentit të Biologjisë, duhet të caktojë një personel efektiv në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili do të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e tij.</i></p> <p>Koordinatori i programit gjithashtu duhet të informojë vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse (<i>Drejtuesin e Departamentit të Biologjisë</i>) dhe të shqyrtojë cilësinë e syllabuseve përpara miratimit periodik të tyre, duhet të miratojë temat e eseve dhe tezat e provimeve, si edhe të vlerësojë ecurinë e praktikave profesionale.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p>

	<i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i>			
Konkluzione	<p><i>Departamenti i Biologjisë si pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, departament në cilësinë e ofruesit të këtij programi studimi, përmbush të gjitha kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke u bazuar në numrin e personelit dhe titujve akademikë.</i></p> <p><i>Departamenti Biologji përfaqësohet nga 35 anëtarë, ku 26 janë me kohë të plotë dhe 9 të tjerë janë personel akademik me kontratë.</i></p> <p><i>Gjithashtu, janë angazhuar edhe gjashtë staf në cilësinë e personelit ndihmës akademik të nevojshëm për realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale.</i></p> <p><i>- GVJ rekomandon emërimin e koordinators për programin e studimit, i cili do të përfaqësojë personin përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit e praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e përcaktuara.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>FSHN dhe Departamenti i Biologjisë si njësi kryesore përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, ka të disponueshëm dokumentacionin e plotë për këtë program, i cili përfshin: Kurrikulën e Programit të Studimit, Planin Mësimor dhe Syllabuset e Lëndëve. Informacioni për programin është gjithashtu i aksesueshëm online, si në sistemin “e - Learning Management” edhe në faqen e ofruar online nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës - FSHN.</p> <p>https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-biologjise/programmes/biologji-molekulare-msc</p>

	<p>Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese është e përshkruar në detaje në planin mësimor të programit, <i>por jo në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për Elementët e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", e ndryshuar,</i> duke ndjekur organizimin e lëndëve të ndarë për Veprimtaritë Formuese që i përket të ciklit të parë të studimit në "Bachelor" (<i>përshkruar me detaje në Kriterin 1 të Standartit II.1</i>).</p> <p>GVJ vlerëson pozitivisht përgatitjen e syllabuseve edhe në gjuhën angleze, duke kontribuar pozitivisht në transferimin e studentëve.</p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë 3.8: Rregullore për "Funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës"</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Departamenti i Biologjisë si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Biologji Molekulare", ka për detyrë organizimin dhe administrimin e tij. Ky program përbëhet nga gjithsej 120 kredite, përkatësisht 3000 orë të ndara në katër semestre. Lëndët janë strukturuar në module të ndryshme, të kategorizuara sipas natyrës së disiplinës (A-E).</p> <p>Nga 3000 orët totale, 502.5 orë janë leksione, 300 janë seminare, 255 orë janë dedikuar ushtimeve dhe punëve laboratorëve, për përgatitjen e diplomës janë në dispozicion 300 orë; pjesa tjetër e ngarkesës është shpërndarë për studim individual dhe jashtë auditorit. Informacioni i detajuar gjendet gjithashtu në syllabuset e çdo moduli.</p>

	<p>Njësia kryesore është përgjegjëse për ndarjen e ngarkesës mësimore dhe monitorimin e realizimit të saj. Për çdo lëndë/modul përcaktohen detyrimet përkatëse, si seminare, ushtrime, detyra kursi, projekte dhe praktika. Syllabuset e lëndëve/moduleve përmbajnë gjithashtu metodat e kontrollit të dijeve. Emërtimi i lëndëve/moduleve sipas kategorive përfshin kreditet përkatëse, të ndara në orë brenda dhe jashtë auditorit. Planifikimi i krediteve për çdo lëndë/modul dhe raporti i orëve (leksione, seminare, laboratorë) janë dhënë në detaje në planin mësimor.</p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 13: Ngarkesa totale e studentëve për format e mësimdhënies në MSc. Biologji Molekulare</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit mbështetet në strategjinë institucionale të Universitetit të Tiranës, duke synuar konkretisht përgatitjen në fushën e Biologut Molekular dhe përmbushjen e objektivave strategjike të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Departamentit të Biologjisë. Në përfundim të ciklit të studimeve 2-vjeçare, studentët pajisen me diplomën universitare në ciklin e dytë të studimeve, Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”.</p> <p>Rregullorja e programit të studimeve përfshin informacion të plotë mbi politikat dhe procedurat e pranimit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, si dhe detaje për transferimin, njohjen dhe ekuivalentimin e studimeve. Po ashtu, vendimi i Senatit Akademik mbi kriteret e pranimit përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në këtë program studimi të nivelit të dytë.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p>



	<p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.4: Kriteret e pranimit 2022-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.23: Kriteret e pranimit MSc 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë 5.5: Kuotat e pranimit FShN, 2022-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.17: Shqyrtimi i dosjeve për transferime dhe degë të dyta</i></p> <p><i>Evidencë 2.12: Praktika për transferimet komisionet ad hoc</i></p> <p><i>Evidencë 2.12: Procedurë transferimi njohje lëndësh</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në syllabuset e programit të studimit pasqyrohen informacionet e nevojshme për çdo lëndë sipas kërkesave të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Plani mësimor i përpunuar sipas këtyre përcaktimeve ofron informacionin e nevojshëm si për studentët edhe personelin akademik efektiv dhe atë me kontratë.</p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Institucioni deklaron se përmbajtja e programeve të studimit është subjekt i një procesi të vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet e nevojshme dhe arkivohet dosja përkatëse e plotë. Programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe aktivitetet formuese, si edhe numri i krediteve, i nënshtrohen një rishikimi periodik.</p> <p>Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës e Alumni-t, si edhe nga personeli akademik, në konsultim me aktorët e tregut të punës, me qëllim përshtatjen ndaj kërkesave të tregut dhe ndryshimeve të brendshme institucionale. Propozimet e argumentuara paraqiten</p>

	<p>nga palët e interesuara dhe shqyrtohen nga departamentet përkatëse dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës. Pas këtij vlerësimi, ato përcillen për miratim në mbledhjen e Dekanatit dhe më pas në Senat, ku merret vendimi përfundimtar.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.4: Raporti vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor DSBCCK, FSHN 2023-2024</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore DSBCCK, FShN, UT(2021)</i></p> <p><i>Evidencë 6.14: Plani i masave për përmirësimin e procesit mësimor</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Të gjitha informacionet e nevojshme mbi programin e studimit janë të aksesueshme nëpërmjet Njësisë Bazë. Programi përfshin të gjithë elementët thelbësorë, si planin mësimor, kurrikulën e programit dhe syllabuset, ndër të tjera.</i></p> <p><i>Gjithashtu, programi ofron dokumentacionin dhe udhëzimet procedurale të nevojshme për pranimin e studentëve në programin Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, si dhe për transferimin e studimeve dhe procedurat përkatëse.</i></p> <p><i>GVJ vlerëson pozitivisht faktin që syllabuset janë përgatitur edhe në gjuhën angleze, duke lehtësuar procesin e transferimit të studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Duke pasur parasysh që studentët e këtij programi vijnë nga një formim i përgjithshëm në ciklin e parë Bachelor në “Biologji”, vërehet se ndarja e moduleve nuk ndjek një kriter specifik varësie midis tyre. Megjithatë, organizimi i moduleve/lëndëve është strukturuar në mënyrë të tillë që t’u ofrojë studentëve një progresion logjik, duke përfshirë modulet laboratorike.</p> <p>Emërtimi dhe aktivitetet formuese të programit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” janë konceptuar dhe zhvilluar me qëllim thellimin e njohurive dhe aftësive të studentëve për një kujdes më të avancuar mbi interpretimin dhe analizën e proceseve biologjike, duke përfshirë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të vlerësimit dhe zgjidhjes së problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare, si edhe për studime më të thelluara, si në auditor, ashtu edhe në praktika profesionale. Programi i studimit i jep një rëndësi të veçantë formimit shkencor profesional të studentit.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët/modulet e programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” janë të organizuara përgjatë katër semestrave dhe dy viteve akademikë, ku formimi teorik dhe ai praktik bashkëveprojnë për të mbështetur zhvillimin profesional dhe shkencor të studentëve. Plani mësimor mundëson realizimin e objektivave formues të programit dhe sigurimin e kompetencave të avancuara dhe të thelluara në fushë.</p> <p>Ndarja e orëve në auditor, duke përfshirë leksionet dhe seminarët, është përcaktuar në planin mësimor në përputhje me kreditet e secilës disiplinë. Në varësi të natyrës së lëndës, mund të përfshihen seminare klasike, detyra kursi e praktikë lëndore, me qëllim nxitjen e punës së pavarur nga studentët. Për disa lëndë të</p>

	<p>tjera, fokusi mund të jetë më i madh në komponentët laboratorikë ose praktikë. Këto elemente mbeten pjesë e analizës së vazhdueshme të programit dhe të mundësive për përmirësim në të ardhmen, duke marrë parasysh edhe sugjerimet e studentëve të diplomuar.</p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare – Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) – Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master i Shkencave”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Në programin e studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, raporti midis komponentëve teorikë dhe praktikë është në përputhje me standardet e programeve ndërkombëtare, gjë që reflektohet në njehsimin e diplomave dhe planit mësimor, si edhe në përgatitjen e studentëve që arrijnë të punësohen në vende të ndryshme të botës.</p> <p>Gjatë takimit me stafin drejtues dhe personelin akademik të angazhuar në programin e studimit u konfirmua se programi është i ngjashëm me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare, me dallime të vogla kryesisht në numrin e krediteve ECTS për disa lëndë. Ky program siguron aftësi dhe kompetenca të avancuara, si edhe një formim të thelluar profesional e shkencor, duke krijuar bazën e nevojshme për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë. Programi ofron njohuri të thelluara teorike dhe praktike, të cilat i mundësojnë studentëve të zhvillojnë autonomi në vendimmarrje dhe të realizojnë analiza të situatave të ndryshme që mund të hasin gjatë ushtrimit të profesionit.</p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.18: Studim i tregut të punës UT</i></p> <p><i>Evidencë 2.18: Studim i tregut të punës DB - Biologji Molekulare</i></p>

	<i>Evidencë 2.4: DB, MSc Bio. Molekulare (Suplementi diplomës 2024)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” përfshin veprimtaritë formuese përkatëse, duke përcaktuar lëndët bazë, karakterizuese e ndërdisiplinore/integruese.</p> <p>Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS sigurojnë një integrim të aspekteve teorike dhe praktike, duke mundësuar arritjen e objektivave formues. Për më tepër, hartimi i këtij programi studimi rrit mundësitë për transferimin apo mobilitetin e studentëve, si dhe për mundësitë e punësimit të tyre pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 1.18: Studim i tregut të punës UT</i></p> <p><i>Evidencë 2.18: Studim i tregut të punës DB - Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.4: DB, MSc Bio.Molekulare (Suplementi diplomës 2024)</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dhe veçanërisht Departamenti i Biologjisë, analizon në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të studimit, duke marrë në konsideratë mendimet dhe opinionet e lektorëve dhe studentëve për secilin modul.</p> <p>Syllabuset e të gjitha lëndëve në program janë hartuar në përputhje me kërkesat përkatëse dhe përmbajnë pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënësve, konceptet themelore, temat e detajuara, format e kontrollit të dijeve, kërkesat e frekuentimit, mënyrat e vlerësimit të vazhdueshëm, literaturën dhe vërejtjet përfundimtare të pedagogut.</p>

	<p>Në fillim të çdo semestri, syllabuset rishikohen nga titullari i lëndës dhe më pas konsultohen me Drejtuesin e Departamentit, i cili i miraton ato.</p> <p>GVJ konstaton se në shumicën e syllabuseve nuk respektohet plotësisht standardi i përcaktuar nga udhëzimet e MAS. <i>Literatura bazë e detyrueshme dhe ajo ndihmëse shpesh nuk përfshijnë botime të pesë viteve të fundit, rrallë janë në gjuhën angleze dhe jo gjithmonë janë nga shtëpi botuese të njohura, si Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraw-Hill, Pearson, Elsevier, Sage, etj.</i></p> <p><i>Në shumicën e rasteve, literatura reduktohet vetëm në leksionet e përgatitura nga vetë lektori.</i></p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të vitit akademik 2024-2025 rezulton se një numër i konsiderueshëm lëndësh ose pothuajse të gjitha, nuk respektojnë standardin për përfshirjen e një literature bazë të detyrueshme të pesë viteve të fundit, <i>veçanërisht nga shtëpi botuese ndërkombëtare, si p.sh.:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <i>Në pjesën më të madhe të lëndëve literatura bazë e detyrueshme është më shumë se 5 edhe 10 vjeçare si:</i> <p>1999 – Enzimologji 2006 – Bioinformatika 2008 – Analiza Biostatistike 2015 – Imunologji Molekulare 2015 – Bioteknologji Molekulare 2015 – Fiziologji Qelizore dhe Molekulare 2016 – Biofizika</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ <u><i>Ndërsa në të paktën njëmbëdhjetë lëndë, si:</i></u> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Struktura e Sjelljes Makromolekulare ✓ Fiziologji Qelizore dhe Molekulare ✓ Analiza të Biologjisë së Zhvillimit ✓ Mikrobiologji e Avancuar ✓ Bioteknologji Molekulare ✓ Gjenetika Molekulare ✓ Gjenetika Humane ✓ Toksikologji ✓ Enzimologji ✓ Kulturat Qelizore ✓ Analiza Biostatistike
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> - konstatohet që si literaturë bazë e detyrueshme shërbejnë “Leksione të Përgatitura (Shkruara) nga Pedagogu i Lëndës” ose “Leksione PPT”. ➤ Gjithashtu në vijim të kësaj konstatohet që shumë lëndë kanë vetëm një tekst si literaturë bazë të detyrueshme dhe mungon një tekst i dytë po si literaturë bazë, konkretisht në lëndët: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Analiza të Biologjisë së Zhvillimit ✓ Mikrobiologji e Avancuar ✓ Gjenetika Molekulare ✓ Gjenetika Humane ✓ Bioinformatika - GVJ rekomandon përdorimin e literaturës së huaj si pjesë të literaturës bazë dhe të rekomanduar. Meqënëse ka mangësi me botime në gjuhën shqipe, studentët shpesh mbështeten në përmbledhje të leksioneve të përgatitura nga lektorët. - GVJ rekomandon gjithashtu përfshirjen e dy teksteve si literaturë bazë të detyrueshme, me qëllim marrjen e kompetencave të duhura shkencore, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe ciklin e dytë të studimeve që i përket programit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”. - GVJ sugjeron që njësisia bazë përgjegjëse për programin e studimit të mundësojë përkthimin në shqip të disa botimeve kryesore në fushën e Biologjisë Molekulare për të ndihmuar studentët në thellimin e njohurive të tyre. <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë 1.20: Raporti vjetor FSHN UT 2023-2024</i></p> <p><i>Evidencë 5.9: Raporti vjetor FSHN UT 2022-2023</i></p> <p><i>Evidencë 3.8: Rregullore për “Funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës”</i></p>
--	---

	<p><i>Evidencë 4.39: Rregullore Bibliotekës-FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor DSBCCK, FSHN 2023-2024</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore DSBCCK, FShN, UT(2021)</i></p> <p><i>Evidencë 6.14: Plani i masave për përmirësimin e procesit mësimor</i></p> <p><i>Evidencë 3.4: Raporti vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 6.9: Raport mbi pyetësin "Vlerësim i studentëve që diplomohen" FSHN, UT</i></p> <p><i>Evidencë 6.19: Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu</i></p> <p><i>Evidencë 6.18: Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të Universitetit të Tiranës</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në "Biologji Molekulare" është strukturuar në mënyrë që t'u mundësojë studentëve përfitim të njohurive të avancuara dhe zhvillimin e aftësive e kompetencave të nevojshme për përmbylljen me sukses të ciklit të dytë të studimeve. Programi siguron që studentët të marrin dije bashkëkohore të thelluara dhe të specializuara në fushën e Biologjisë Molekulare.</p> <p>Përveç aftësimit praktik të studentëve nëpërmjet seancave laboratorike dhe praktikave profesionale, programi i kushton një rëndësi të veçantë edhe përvetësimit të njohurive teorike shkencore të avancuara. Si rezultat, studenti synohet të arrijë zhvillimin e aftësive praktike dhe laboratorike, si edhe fitimin e njohurive të domosdoshme shkencore, duke u përgatitur në mënyrë të plotë për sfidat profesionale në këtë fushë.</p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në "Biologji Molekulare" është në përputhje me vizionin dhe</p>

<p>mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>misionin e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, si një institucion bashkëkohor që promovon studimin, kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive.</p> <p>Ky program adreson nevojat dhe kërkesat për specialistë të fushës së Shkencave Natyrore dhe u ofron studentëve njohuritë e domosdoshme për të vijuar më tej me ciklin e tretë të studimeve.</p> <p>Studentëve u krijohen gjithashtu mundësi për zgjerimin e njohurive të tyre përmes trajnimeve të mëtejshme, pjesëmarrjes në konferenca të dedikuara dhe specializuara në këtë fushë studimi, si edhe ndjekjes së studimeve doktorale. Niveli i njohurive të fituara nga lëndët e programit siguron një bazë të fortë profesionale dhe shkencore, duke i përgatitur studentët për t'u integruar suksesshëm në tregun e punës në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e tij.</p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.18: Studim i tregut të punës UT</i></p> <p><i>Evidencë 2.18: Studim i tregut të punës DB - Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë 1.25: Komisionet UT. Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët.</i></p> <p><i>Evidencë 2.13: Learning agreement - mobilitet student vendas</i></p> <p><i>Evidencë 11: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte kerkimore shkencore.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese të programit Master i Shkencave në "Biologji Molekulare" janë konceptuar dhe zhvilluar me qëllim thellimin e njohurive shkencore dhe forcimin e aftësive profesionale të studentëve.</i></p> <p><i>Programi synon t'u ofrojë atyre mundësi për vazhdim studimesh në ciklin e tretë si edhe perspektiva punësimi në fushën e biologjisë molekulare. Lëndët/modulet janë të organizuara</i></p>

	<p>përgjatë katër semestrave, për dy vite akademike, secila me numrin përkatës të krediteve.</p> <p><u>Rekomandimet e GVJ:</u></p> <p>1. <u>Përditësimi i syllabuseve</u> Rishikimi dhe përditësimi i literaturës bazë të detyrueshme dhe asaj ndihmëse, duke siguruar përfshirjen e botimeve të pesë viteve të fundit në gjuhën angleze, nga shtëpi botuese të njohura si Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraw-Hill, Pearson, Sage, Elsevier, etj.</p> <p>2. <u>Përfshirja e dy teksteve si literaturë bazë të detyrueshme</u> Rekomandohet që programi të përfshijë të paktën dy tekste të përditësuara si literaturë bazë dhe të detyrueshme për lëndët e tij, me qëllim sigurimin e kompetencave të nevojshme shkencore dhe përafrimin e programit me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e ciklit të dytë të studimeve. Këto tekste duhet të reflektojnë zhvillimet më të fundit në biologjinë molekulare dhe të mbështesin një formim të qëndrueshëm akademik e profesional.</p> <p><i>Këto rekomandime synojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe garantimin e aksesit të studentëve në materiale bashkëkohore dhe të vlefshme për zhvillimin e tyre profesional.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Biologjisë, deklarojnë se për të përmirësuar dhe përshtatur programin e studimit në përputhje me politikat që mbështesin punësimin e studentëve, merren parasysh mendimet, propozimet dhe zhvillon konsultime me anëtarët e stafit të departamenteve ose fakultetit. Kjo bëhet me synimin e përmirësimit të mëtejshëm të programit

<p>programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>të studimit, në mënyrë që të rritet aftësimi profesional i studentëve dhe të lehtësohet përfshirja e tyre në tregun aktual të punës.</p> <p>Në të njëjtën kohë, memorandumet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit që UT, FSHN dhe vetë Departamenti i Biologjisë kanë lidhur me institucionet partnere synojnë realizimin e praktikave të studentëve dhe lehtësimin e punësimit të tyre.</p> <p><i>Ndërkohë, GVJ vëren se mungon si strukturë Bordi i Tregut të Punës ose një Strukturë tjetër e ngjashme, e cila ose të cilat do të ishin instrumente mjaft të rëndësishëm për këshillimin e karrierës së studentëve si edhe për propozimet e mundshme që do të ndihmonin për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulave.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.18: Studim i tregut të punës UT</i></p> <p><i>Evidencë 2.18: Studim i tregut të punës DB - Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë 3.4: Raporti vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 6.14: Plani i masave për përmirësimin e procesit mësimor</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 1 & 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 5: Institucionet dhe Oraganizat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikrat Profesionale me Institucionet e tjera.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e</p>	<p>Përfshirja e studentëve në struktura të ndryshme dhe në komisionet që ngrihen është një detyrim ligjor. Pjesëmarrja e tyre në Senatin Akademik u ofron studentëve mundësinë të</p>

<p>tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>propozojnë mendime mbi përmirësimet të mundshme në programin e studimeve.</p> <p>Studentët gjithashtu kanë si strukturë të vetën Këshillin Studentor, i cili ka të hartuar qartësisht edhe rregulloren që përcakton organizimin dhe funksionimin e tij. Kontributi e mendimet e studentëve për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit mundësohen gjithashtu përmes pyetësorëve të zhvilluar nga strukturat e FSHN apo Departamenteve përkatës. Pyetësorët, të cilët shërbejnë si instrumente për mbledhjen e mendimeve e sugjerimeve të studentëve, ndihmojnë në identifikimin e problematikave dhe sugjerimeve për përmirësimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 5.4: Listat e studentëve të regjistruar në MSc Bio. Molekulare. FSHN-UT</i></p> <p><i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor DSBCK, FSHN 2023-2024</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore DSBCK, FShN, UT(2021)</i></p> <p><i>Evidencë 6.9: Raport mbi pyetësorin "Vlerësim i studentëve që diplomohen" FSHN, UT</i></p> <p><i>Evidencë 6.14: Plani i masave për përmirësimin e procesit mësimor</i></p> <p><i>Evidencë 3.4: Raporti vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 17: Perberja e keshillit studentor</i></p> <p><i>Evidencë 5.12: Vendim Nr. 17 i Komisionit Institucional Zgjedhor Studentor datë 13.12.2021</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat</p>	<p>FSHN dhe Departamenti i Biologjisë kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe shkencore, që synojnë përveç shkëmbimit të stafit e studentëve për module të</p>

<p>programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>ngjashme, edhe ndarjen e eksperiencave për përditësimin e përshtatjen e programit të studimit.</p> <p>Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë organizimin e leksioneve të hapura mbi tema specifike dhe angazhimin e personelit akademik nga institucionet partnere me të cilat janë nënshkruar marrëveshjet. Një rol të veçantë luan veçanërisht stafi akademik i departamenteve homologe, i cili jep një kontribut të rëndësishëm në fushën biologjisë diagnostike molekulare dhe ndihmon në krijimin e lidhjeve me një rrjet më të gjerë profesionistësh të fushës dhe klinikave e laboratorëve të ndryshëm, etj.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.18: Studim i tregut të punës UT</i></p> <p><i>Evidencë 2.18: Studim i tregut të punës DB - Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë 2.13: Learning agreement - mobilitet student vendas</i></p> <p><i>Evidencë 2.14: Learning agreement mobilitet studentesh te huaj</i></p> <p><i>Evidencë 11: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte kerkimore shkencore</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 1 & 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 5: Institucionet dhe Oraganizat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikant Profesionale me Institucionet e tjera.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni raporton se programi i studimit përditësohet dhe përmirësohet në përputhje me nevojat e tregut të punës, duke marrë parasysh mendimet dhe propozimet e institucioneve partnere dhe studentëve të diplomuar, me qëllim lehtësimin e integritimit të studentëve në tregun aktual të punës.</i></p>

	<p><i>Studentët, përmes përfaqësimit të tyre në Senatit Akademik dhe Këshillin Studentor, marrin pjesë aktive në procesin e përmirësimit të programit. Kontributi i tyre, përfshirë reflektimet pas diplomimit, ka një rol të rëndësishëm në aktivitete edukative të vazhdueshme.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron krijimin e Bordit të Tregut të Punës ose një strukture të ngjashme, e cila do të funksiononte si një aktor dhe kontribues i rëndësishëm për këshillimin e karrierës së studentëve dhe për propozimet mbi përmirësimin e kurrikulave.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Prioriteti i programit të studimit është përgatitja e studentëve të aftë dhe kompetentë në fushën e tyre. Programi përcakton qartë prioritetet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e situatave komplekse, jo vetëm në aspektin profesional, por edhe me vlera të larta humane.</p> <p>Misioni kryesor i programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” është të formojë biologë ekspertë diagnostikues molekularë profesionistë me kompetencë të lartë në njohjen e etikës profesionale, legjislacionit vendas dhe konventatve ndërkombëtare.</p> <p>Biologët molekularë të formuar nga ky program studimi perfeksionohen me njohuri të thelluara në zbatimin e metodave të përshtatshme shkencore për interpretim, analizë dhe të kuptuarit të proceseve biologjike, në të gjithë kompleksitetin e tyre, si dhe të problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare, duke përdorur me lehtësi përveç teknikave laboratorike edhe metodat e duhura dhe bashkëkohore bioteknologjike, biostatistikore dhe bioinformatike.</p> <p>Në këtë mënyrë synohet që studentët që diplomohen të jenë të aftë për tu punësuar në institucione publike e private shkencore,</p>

	<p>mjekësore ose industriale, në institucione të arsimit të lartë, si ekspertë të çështjeve komplekse të biologjisë molekulare dhe diagnostikimit molekular.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>FSHN dhe DB kryejnë kërkime shkencore në përputhje me fushën përkatëse që përfaqësojnë, duke respektuar gjithashtu etikën e kërkimit shkencor.</p> <p>Pedagogët e UT dhe detyrimisht ata të FSHN gëzojnë prioritetet lehtësuese e inkurajuese qoftë në mësimdhënie, ashtu edhe në veprimtari kërkimore shkencore. FSHN në përgjithësi dhe Departamenti i Biologjisë në veçanti, organizojnë dhe administrojnë procesin akademik, duke inkurajuar dhe bashkërenduar këtë veprimtari dhe duke respektuar lirinë akademike të stafit, e cila shprehet në zgjedhjen e tematikave të lëndës, literaturës, etj.</p> <p>Drejtuesi i Departamentit monitoron progresin e veprimtarisë kërkimore dhe raporton në Dekanat mbi zhvillimin dhe organizimin e programit. Shpërndarja e orëve të teorisë, projekteve kërkimore dhe praktikave gjatë vitit akademik bën të mundur ndërthurjen e njohurive dhe siguron respektimin e lirisë akademike të pedagogut. Kjo qasje ndihmon studentët në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore specifike dhe prezantimin e rasteve konkrete të hasura në fushën e studimit në projektet e tyre lëndore.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p>




	<p><i>Evidencë 2.17: Ngarkesa totale e personelit akademik të programit të studimit Master i Shkencave në Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 6.14: Plani i masave për përmirësimin e procesit mësimor</i></p> <p><i>Evidencë 6.19: Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu</i></p> <p><i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor DSBCK, FSHN 2023-2024.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Sipas rregullores së Departamentit, studentët kanë të drejtë të përdorin, në përputhje me rregullat përkatëse, të gjitha mundësitë dhe pajisjet që ofron Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Biologjisë, për të përmbushur programin mësimor dhe për të kryer aktivitetin e planifikuar shkencor.</p> <p>Institucioni raporton se Departamenti i Biologjisë inkurajon studentët të marrin pjesë në konferenca, seminare dhe workshop, si dhe të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore bashkë me profesorët përkatës, për projektet kërkimore në UT me anë të punimit të tezës së diplomës.</p> <p>Produktet shkencore, temat e kursit dhe temat e diplomës së studentëve depozitohen në mënyrë elektronike ose në formë të printuar pranë departamenteve dhe shërbejnë si të dhëna kërkimore. Pedagogët kanë inkurajuar studentët të publikojnë dhe botojnë këto punime, si edhe i kanë përfshirë ata në punën e tyre kërkimore, duke i angazhuar në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si dhe në publikime e mundshme në Buletinin shkencor të FSHN.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.20: Raporti vjetor FSHN UT 2023-2024</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Udhëzues Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.4: MSc Bio. Molekulare (Suplementi diplomës 2024)</i></p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë 2.13: Learning agreement - mobilitet student vendas</i></p>

	<p><i>Evidencë 2.14: Learning agreement mobilitet studentesh te huaj</i></p> <p><i>Evidencë 11: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte kërkimore shkencore</i></p> <p><i>Evidencë 6.18: Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 18.1: Listë mobilitetesh për stafin akademik</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 19: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Institucioni raporton se mbështet financiarisht aktivitetet studimore, kërkimore dhe shkencore, sipas buxhetit të miratuar. Organizimi i konferencave shërben si një instrument për të mbështetur këto aktivitete. Gjatë takimeve me stafin akademik u theksua se është ofruar mbështetje financiare nga Institucioni për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe për publikimin e artikujve shkencorë. Departamenti i Biologjisë merr mbështetje financiare nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.16: Organigrama dhe struktura drejtuese e FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 4.38: Mbledhje bordi administrimi UT per miratim buxheti 2024</i></p> <p><i>Evidencë 4.20: Projekt-buxheti 2023</i></p> <p><i>Evidencë 4.21: Buxheti 2023 FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 13: Procedure Ribursimi Artikuj Shkencore</i></p> <p><i>Evidencë 18.1: Liste mobilitetesh per stafin akademik</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 18: Të ardhurat dhe Financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 20: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i></p>

Konkluzione	<p><i>Prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit Master i Shkencave në "Biologji Molekulare" janë të përcaktuara qartë.</i></p> <p><i>FSHN dhe DB angazhohen në kërkimin shkencor në përputhje me fushën përkatëse dhe duke respektuar etikën e kërkimit shkencor.</i></p> <p><i>Studentët janë të përfshirë në aktivitete kërkimore, ndërsa stafi raporton për mbështetje financiare mbi këto iniciativa shkencore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Projektet kërkimore-shkencore realizohen në struktura mbështetëse dhe departamente tjera, duke siguruar bashkëpunim me institucione të tjera kërkimore për realizimin e qëllimeve të programit të studimit. Institucioni raporton për bashkëpunime me partnerë të tillë si: Universiteti i Mesinës (Itali), Universiteti Presov (Sllovakia), Muzeu Kombëtar i Vienës dhe Universiteti BOKU (Austri).</p> <p>Departamenti raporton që për një periudhë dy vjeçare (2022-2024) stafi akademik i tij në bashkëpunim njësitë e tjera të FSHN dhe QKFF, ka marrë pjesë në 33 projekte kërkimore e shkencore.</p> <p>FSHN dhe Departamenti i Biologjisë raportojnë se mbledhja e të dhënave kërkimore prej studentëve gjatë realizimit të detyrave të kursit dhe temave të diplomës, mbështet projektet dhe kontribuon në arritjen e objektivave të programit të masterit. Pedagogët theksojnë se studentët arrijnë të mbledhin të dhëna në subjekte me të cilat institucioni ka realizuar marrëdhënie dhe memorandume bashkëpunimi. Gjithashtu, FSHN ka arritur të sigurojë projekte kërkimore të financuara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>

	<p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë 2.13: Learning agreement - mobilitet student vendas</i></p> <p><i>Evidencë 2.14: Learning agreement mobilitet studentesh te huaj</i></p> <p><i>Evidencë 11: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte kerkimore shkencore</i></p> <p><i>Evidencë 18.1: Liste mobilitetesh per stafin akademik</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 5: Institucionet dhe Oraganizat bashkëpunuese në rang Programi studimi për Praktikant Profesionale me Institucionet e tjera.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 18: Të ardhurat dhe Financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 20: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Biologjisë janë angazhuar vazhdimisht për të realizuar dhe siguruar marrëveshje të reja bashkëpunimi me aktorë të rinj në fushën shkencore, duke iu përgjigjur pozitivisht kërkesave për analiza, studime dhe projekte kërkimore shkencore.</p> <p>Personeli akademik realizon modele bashkëpunimi që mund të jenë afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata. FSHN dhe DB gjithashtu bashkëpunojnë në mënyrë permanente me institucione homologe për të promovuar kërkimin shkencor. Pedagogët e huaj angazhohen në mësimdhënie dhe organizojnë leksione të hapura dhe aktivitete që rrisin mundësitë për zhvillimin e kërkimit shkencor.</p> <p>FSHN dhe DB inkurajojnë gjithashtu pedagogët të marrin pjesë në mobilitete afatshkurtra jashtë vendit përmes programit Erasmus+. Ky program ka lejuar një numër të konsiderueshëm të stafit akademik të zhvillojë mobilitete jashtë shtetit, duke kontribuar në aktivitetet e tyre kërkimore. FSHN dhe DB aplikojnë periodikisht në projekte kërkimore shkencore si me partnerë të brendshëm ashtu edhe me ata ndërkombëtarë.</p>

	<p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera për periudhën 2016-2021</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë 14: Raport Analitik mbi Përfitimet nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit 2021-2024</i></p> <p><i>Evidencë 18.1: Liste mobilitetesh per stafin akademik</i></p> <p><i>Evidencë 2.13: Learning agreement - mobilitet student vendas</i></p> <p><i>Evidencë 2.14: Learning agreement mobilitet studentesh te huaj</i></p> <p><i>Evidencë 11: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte kerkimore shkencore</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 19: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 20: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës mbështet organizimin e konferencave ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale, si dhe aktivitete të ndryshme që ndihmojnë personelin akademik dhe studentët në arritjen e objektivave të vendosura. Studentët kanë marrë pjesë në aktivitete trajnuese të ndryshme, ndërsa personeli ka mundësi të angazhohet në konferenca dhe aktivitete të tjera me karakter kërkimor dhe shkencor.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.20: Raporti vjetor FSHN UT 2023-2024</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Udhëzues Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 6.18: Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 11: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte kerkimore shkencore.</i></p>

	<i>Evidencë 18.1: Listë mobilitetesh për stafin akademik</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>Prioriteti kryesor i programit të studimit është përgatitja e studentëve të aftë dhe kompetentë në fushën e tyre. Programi përcakton qartë synimet dhe përgjegjësitë që lidhen me menaxhimin e situatave të ndërlikuara, jo vetëm në aspektin profesional, por edhe mbështetur në vlera thelbësore humane.</p> <p>Qëllimi kryesor i këtij programi studimit është të formojë biologë diagnostikues molekularë profesionistë me kompetencë të lartë në njohjen e etikës profesionale të cilët të jenë perfeksionuar me njohuri të thella në zbatimin e metodave të duhura shkencore për interpretim, analizë dhe të kuptuarit të proceseve biologjike, në të gjithë kompleksitetin e tyre, si dhe të problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare, duke përdorur me lehtësi përveç teknikave laboratorike edhe metodat e duhura dhe bashkëkohore bioteknologjike, biostatistikore e bioinformatike.</p> <p>Kështu synohet që studentët e diplomuar të jenë të aftë për tu punësuar në institucione publike e private me natyrë shkencore, mjekësore apo industriale, në institucione të arsimit të lartë, si ekspertë të çështjeve komplekse të biologjisë molekulare dhe diagnostikimit molekular, etj.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk aplikohet.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e	Nuk aplikohet.

<p>rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Departamenti i Biologjisë angazhohen për të inkurajuar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e vazhdueshme të stafit akademik dhe studentëve në aktivitete kërkimore dhe shkencore, të zhvilluara në mënyrë periodike, me qëllim përgatitjen e tyre për të qenë konkurrues në tregun e punës, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij.</i></p> <p><i>FSHN dhe Departamenti i Biologjisë gjithashtu angazhohen për krijimin e marrëveshjeve të reja për zhvillimin e veprimtarive kërkimore dhe shkencore, si dhe mbështesin organizimin e konferencave dhe aktiviteteve të tjera shkencore e kërkimore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<p>Standardi III.1</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qëndër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies</p>	<p>Me qëllim arritjen e një përvetësimi sa më të mirë të njohurive, format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të</p>

<p>dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>dijes, ashtu sikurse është përshkruar në VKM 41 të ndryshuar, parashikojnë leksione, seminare, laboratorë, projekte, praktika profesionale, leksione të hapura dhe konferenca studentore, të cilat realizohen në përputhje me planin mësimor.</p> <p>UT dhe FSHN ndjekin një politikë të qartë dhe hartojnë udhëzues institucional për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të cilat bazohen në fushën e studimeve dhe lëndët/modulet përkatëse.</p> <p>Gjatë ndjekjes së ciklit të dytë të studimeve, studentët inkurajohen të thelojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në fushën përkatëse. Orët e mësimimit janë të përshtatura sipas natyrës së lëndëve, me qëllim angazhimin e të gjithë studentëve për arritjen e një nxënie efektive të njohurive.</p> <p>Çdo syllabus përcakton qartë format dhe metodologjinë e mësimdhënies, e cila ndryshon nga lënda në lëndë dhe respekton lirinë akademike. Kontrolli i dijeve është programuar si një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që FSHN të hartojë një udhëzues për unifikimin e veprimtarive akademike në nivel institucional, për të siguruar plotësisht që kontrolli i dijeve të jetë i vazhdueshëm dhe të lejojë studentët të identifikojnë e plotësojnë mangësitë e tyre para përfundimit të semestrit.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra,</p>	<p>Duke u bazuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” dhe opinionin e marrë prej studentëve, personeli akademik përdor forma të ndryshme mësimdhënie dhe mësimnxënie, përveç metodave tradicionale, si referimet</p>

<p>metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>verbale të studentëve, projekte studimi në grup, mjete audio-vizuale, metodat e simulimit dhe role-play të studentëve.</p> <p>FSHN dhe DB raportojnë se personeli akademik respekton diversitetin dhe nevojat e studentëve duke përdorur forma, mënyra e metoda alternative të mësimdhënies për të siguruar gjithë përfshirjen. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në konsultime të organizuara nga personeli akademik, që i ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve themelore të lëndëve, njohurive dhe aftësive praktike. Në përfundim të çdo lënde/moduli, parashikohet zhvillimi i provimit përfundimtar përkatës. Gjithashtu, janë përcaktuar format e kontrollit të dijeve përmes testeve ndërmjetëse (<i>jo gjithmonë</i>), punëve laboratorike, mbrojtjes së detyrave dhe projekteve të kursit, etj.</p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Departamenti i Biologjisë raporton se ka marrë masat për të ofruar mbështetje dhe mundësi për mobilitetin e personelit akademik dhe ndihmës akademik në universitetet partnere me të cilat janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim parësor përmirësimin e kompetencave didaktike aktuale.</p> <p>Për të rritur cilësinë e mësimdhënies, personeli akademik aplikon forma të ndryshme, të cilat priten mirë prej studentëve. Këto forma të larmishme mbështeten gjithashtu me efikasitet nga infrastruktura që FSHN dhe Departamenti i Biologjisë kanë në dispozicion, duke lehtësuar në përdorimin e teknologjisë dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Për më tepër, UT ofron qasje në programin online nëpërmjet faqes së internetit të FSHN dhe sistemin “<i>e - Learning Management</i>”.</p> <p>Gjithashtu, personeli akademik kryen trajnime të vazhdueshme të ofruara nga institucioni, me qëllim përmirësimin e aftësive të tij në fusha që lidhen me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.</p>

	<p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë 4.15.1: Infrastruktura FShN (Sallat, laboratorët, biblioteka)</i></p> <p><i>Evidencë 3.8: Rregullore për "Funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës"</i></p> <p><i>Evidencë 5.15: Udhëzues për stafin akademik, Platforma TEAMS</i></p> <p><i>Evidencë 4.33: Faqja online UT</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qëndër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>FSHN përcakton kriteret e detajuara në rastet kur ka nevojë për rekrutim, si të personelit të nevojshëm për tu angazhuar me kohë të plotë dhe në rastet kur lind nevoja për angazhim të stafit me kohë të pjesshme në mësimdhënien akademike. Bazuar në CV-të e personelit akademik që janë përzgjidhur për angazhim në cilësinë e lektorit në mësimdhënie, konstatohet që stafi akademik zotëron kompetencat e nevojshme për të shpjeguar njohuri të avancuara shkencore në këtë nivel studimi.</p> <p>Personeli akademik është i hapur ndaj aplikimit të formave, metodave dhe mënyrave alternative të mësimdhënies, duke u përshtatur me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi, si dhe me modulet dhe aktivitetet formuese në veçanti.</p> <p>Zhvillimi i orëve interaktive stimulon angazhimin intensiv të studentëve, duke i shoqëruar ata me diskutime, studime rastesh, punë në grupe dhe prezantime detyrash kursi apo projektesh.</p> <p>Studentët vlerësojnë stafin dhe programin e studimeve përmes pyetësorëve që u vihen në dispozicion. Rezultatet e anketimeve të studentëve të realizuara nga NJSBC, si edhe konsultimet midis stafit akademik të angazhuar në programin e studimit,</p>

	<p>ndihmojnë personelin akademik për të përmirësuar aspektet e mësimdhënies, duke marrë në konsideratë edhe opinionet e studentëve. Këto opinione lidhen kryesisht me ndryshimet në programet e lëndëve të caktuara dhe në kurrikulën e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë: CV e stafit akademik në MSc. Bio. Molekulare (2025)</i></p> <p><i>Evidencë 1.15: Dëshmi kualifikimi PAE (MSc Bio. Molekulare)</i></p> <p><i>Evidencë 2.7: Dëshmi të kualifikimit të stafit akademik të DB</i></p> <p><i>Evidencë 2.8: Kualifikimi i stafit, dokumenti i titujve</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 5.1: Vendim i Dekanit, 215. Miratim rregulloresh për Degën mësimore, DSBCK dhe Bibliotekën</i></p> <p><i>Evidencë 4.39: Rregullore Bibliotekës FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 12: Pasurimi i Biblotekes në 5 vitet e fundit</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore DSCBK, FSHN, UT (2021)</i></p> <p><i>Evidencë 6.22: Paketa e instrumentave të cilësisë i UT</i></p> <p><i>Evidencë 6.10: Raport pyetësor i studentëve për vlerësimin e programeve FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 10: Angazhim i studenteve ne kontributin e permiresimit te program studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Biologjisë, në cilësinë si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” në bashkëpunim edhe me DSBC, realizon kontrole periodike mbi planin e aktiviteteve të personelit akademik duke qënë në gjendje të vlerësojë dhe përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme format dhe metodat e mësimdhënies.</p> <p>Në këtë proces bazuar në pyetësorët e plotësuar nga studentët, janë integruar gjithashtu edhe reflektimet e studentëve.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p>

	<p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.6: UT Manual i sigurimit të cilësisë</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore DSCBK, FSHN, UT (2021)</i></p> <p><i>Evidencë 6.10: Raport pyetësor i studentëve për vlerësimin e programeve FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 10: Angazhim i studenteve në kontributin e përmirësimit të programit studimit</i></p> <p><i>Evidencë 6.14: Plani i masave (përgjigja e shkresës së Dekanit, evidenca 6.13).</i></p> <p><i>Evidencë 6.19: Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu</i></p> <p><i>Evidencë 3.4: Raporti vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor 2023-2024 DSBCK</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Dega Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës - DSBCK e cila është edhe njësi përgjegjëse në nivel institucional, por edhe në bashkëpunim me njësitë e tjera të UT, si Këshilli i Sigurimit të Cilësisë në UT, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave apo Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, kanë si detyrë promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. DSBCK gjithashtu kryen vlerësime periodike dhe analitike të veprimtarive mësimore dhe kërkimore dhe propozon ndryshime për përmirësime.</p> <p>UT, FSHN dhe DB angazhojnë stafin e tyre përmes organizimit të eventeve të ndryshme, si promovimi i librave dhe revistave, organizimi i tryezave të debatit me aktorë të ndryshëm të biznesit për çështje aktuale si edhe ftesa për personalitete të njohura nga fusha të caktuara të shkencës. Një nga prioritetet kryesore të strategjisë së zhvillimit të UT është kualifikimi i mëtejshëm i stafit akademik.</p> <p>UT dhe DB si pjesë e FSHN në mënyrë të vazhdueshme nxisin kualifikimin e stafit akademik, me fokus në organizimin e konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Përveç kësaj, promovimi i personelit akademik mbështetet financiarisht për aktivitete të ndryshme shkencore dhe trajnuese, si edhe për hartimin e teksteve mësimore akademike.</p>

	<p>Departamenti i Biologjisë për studentët e Programit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” organizon takime dhe leksione të hapura, me qëllim implementimin në praktikë të zhvillimeve më të fundit të teknologjisë, si dhe për të promovuar projekte dhe praktika inovative bashkëkohore.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore DSCBK, FSHN, UT (2021)</i></p> <p><i>Evidencë 3.4: Raporti vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 18: Të ardhurat dhe Financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 19: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UT, FSHN dhe Departamenti i Biologjisë zbatojnë një politikë të qartë institucionale dhe hartojnë udhëzues për përdorimin dhe zhvillimin e metodave të ndryshme dhe inovative, me synim përmirësimin e cilësinë së mësimdhënies. Një element thelbësor në këtë drejtim është infrastruktura që i vihet në dispozicion stafit akademik, e cila mundëson integrimin e teknologjisë dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Departamenti i Biologjisë, vlerëson dhe përmirëson në mënyrë të rregullt format dhe metodat e mësimdhënies përmes planit të aktiviteteve të stafit akademik, kontrollit të vazhdueshëm dhe pyetësorëve të studentëve. Ky proces realizohet në bashkëpunim me “NJSBC”, “Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave” dhe “Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin”.</i></p> <p><i><u>GVJ rekomandon</u> hartimin e një udhëzuesi për unifikimin e veprimtarive akademike në nivel institucional, në mënyrë që vlerësimi i njohurive të kryhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë gjithë semestrit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe metodat për testimin dhe vlerësimin e studentëve në programin e ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, në syllabuset e çdo lëndë dhe në metodikën e zhvillimit të veprimtarive akademike. Këto kriteret përfshijnë vlerësimin e studentëve gjatë gjithë vitit, përmes punës në auditor, përgatitjes së detyrave të kursit, punëve laboratorike, seminareve dhe provimit përfundimtar. Mënyrat e vlerësimit paraqiten në mënyrë të detajuar në syllabuset e secilës lëndë, në përputhje me specifikimet e tyre. Informacioni është i disponueshëm edhe në “e - Learning Management” dhe në web-faqen e FSHN.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Bio. Molekulare – Viti 1&2</i></p> <p><i>Evidencë 3.12: Model teze provimi</i></p> <p><i>Evidencë 3.14: Model Proces Verbali Bio. Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.8: Rregullore për “Funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës”</i></p> <p><i>Evidencë 4.40: Manual përdorimi e-Student</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>

<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo semestri, studentëve u prezantohet syllabusi përkatës nga titullari i lëndës/modulit, ku janë përcaktuar me detaje temat që do të zhvillohen, metodat e kontrollit dhe format e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe njohurive shkencore që synohen të përfitohen.</p> <p>Studentët gjithashtu informohen edhe për afatet e plotësimit të çdo detyrimi akademik deri në përfundimin e lëndës përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Bio. Molekulare - Viti 1&2</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve realizohen sipas rregullores së programit të studimit, me anë të realizimit të detyrave të kursit, projekteve, punëve laboratorike, provimeve të ndërmjetme (<i>në rastet e pakta kur ofrohet</i>) dhe provimit përfundimtar.</p> <p>Vlerësimi i njohurive në këtë mënyrë i jep studentëve mundësinë të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Metodot e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve për secilën lëndë/modul përcaktohen sipas një modeli të detajuar nga departamenti, <i>me një total prej 100 pikësh.</i></p> <p>Megjithatë, përcaktimi i peshës specifike për secilin komponent të mësimdhënies (<i>si leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike dhe provimi përfundimtar</i>) mbetet në kompetencën e pedagogut përgjegjës të lëndës.</p> <p>Konkretisht nisur nga shqyrtimi i syllabuseve për vitet akademik 2024-2025 konstatohen lëndë që nuk ndjekin të njëjtin standard për mënyrën e kontrollit të dijeve në detyrimet respektive, si p.sh.:</p> <p>➤ Pothuajse në të gjitha lëndët <u>mungon vlerësimi me Provim të Ndërmjetëm</u> si: Struktura e Sjelljes Makromolekulare / Mikrobiologji Qelizore dhe Molekulare / Biofizika / Biologji Molekulare / Fiziologji Qelizore dhe Molekulare / Analiza të Biologjisë së Zhvillimit / Enzimologji / Imunologji Molekulare / Bioteknologji Molekulare / Kulturat Qelizore, etj.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Edhe në tre raste që paraqitet Provimi i Ndërmjetëm peshan dryshon: Gjenetika Humane me 5%, Analiza Biostatistike me 15% dhe Mikrobiologji e Avancuar me 40%. • Kulturat Qelizore - Aktivizim & Detyrë Kursi 15% (5/10) / Laborator 15% / Provimi Përfundimtar 70%; ❖ Gjenetika Molekulare / Kulturat Qelizore - Aktivizim & Detyrë Kursi 15% (5/10) / Laborator 15% / Provimi Përfundimtar 70%; ❖ Fiziologji Qelizore dhe Molekulare / Enzimologji - Seminar ose Detyrë Kursi & Laborator 30% (10/20) / Provimi Përfundimtar 70% • Struktura e Sjelljes Makromolekulare - Aktivizim 5 % / Seminare 10% / Laboratore 5 % / Provimi Përfundimtar 80%, ❖ Analiza Biostatistike - Aktivizim 5% / Laborator 15 % / Provimi Përfundimtar 80%. • Analiza të Biologjisë së Zhvillimit - Aktivizim / Seminare 15% (10/5) / Laborator 10 % / Provimi Përfundimtar 75%, ❖ Biofizika – Aktivizim, Seminare dhe Laborator 15 % (5/5/5) / Provimi Përfundimtar 85%. • Biologji Molekulare / Bioteknologji Molekulare, <i>komponentë vlerësimi kanë</i> - Detyrë Kursi 10% / Seminare 20% / Laboratore 10% / Provimi Përfundimtar 60%. • Immunologji Molekulare – Aktivizim/Detyrë Kursi 35% (10/25) - Laborator 15% / Provimi Përfundimtar 50%. • Mikrobiologji e Avancuar – Laborator (10%) dhe Aktivizim/Detyrë Kursi (5%-5%) me 20% total / ndërsa Provimi Ndërmjetëm e Provimi Përfundimtar secili nga 40%. ➤ Një formë totalisht e re e vlerësimit të kontrollit të vazhdueshëm me tre forma të Kontrollit, konstatohet në lëndët: <ul style="list-style-type: none"> ❖ Gjenetika Humane – Aktivizimi dhe Detyra Kursi me nga 5% / Punë Laboratori 10%, dhe 3 forma Kontrolli ku Provimi 1 dhe 2 me nga 10%, ndërsa Provimi 3 me 60%.
--	--




	<p>❖ Toksikologji – Aktivizimi dhe Detyra Kursi me nga 10% / Punë Laboratori 10%, dhe 3 forma Kontrolli ku Provimi 1 me 20%, ndërsa Provimi 2 dhe 3 me nga 25%.</p> <p>❖ BioInformatika – Aktivizimi dhe Detyra Kursi me nga 20% / dhe 3 forma Kontrolli ku Provimi 1, 2 dhe 3 janë me nga 20% secili.</p> <p><i>GVJ rekomandon unifikimin e shpërndarjes së veprimtarive akademike në nivel institucional, duke përfshirë procesin e mësimdhënies, mësim-nxënies dhe vlerësimit të njohurive. Një qasje e tillë do të siguronte një kontroll të vazhdueshëm të dijeve gjatë gjithë semestrit dhe një shpërndarje të njëtrajtshme të ngarkesës mësimore sipas veprimtarive formuese.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare – Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) – Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kriteret dhe metodat për testimin dhe vlerësimin e njohurive, aftësive profesionale dhe kompetencave shkencore janë të përcaktuara qartë në rregulloren e departamentit dhe në atë të programit të studimit.</i></p> <p><i>Studentët informohen në mënyrë transparente mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit, ndërsa pedagogët zbatojnë metoda alternative të vlerësimit në përputhje me kërkesat e syllabuseve.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon unifikimin e shpërndarjes së veprimtarive akademike në nivel institucional, duke përfshirë procesin e mësimdhënies, mësim-nxënies dhe vlerësimit të njohurive. Një qasje e tillë do të siguronte një kontroll të vazhdueshëm të dijeve gjatë gjithë semestrit dhe një shpërndarje të njëtrajtshme të ngarkesës mësimore sipas veprimtarive formuese.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët që ndjekin ciklin e studimeve Master Shkencor në “Biologji Molekulare” testohen vazhdimisht gjatë vitit akademik përmes angazhimit gjatë seminareve, projekteve, detyrave të kursit, punëve laboratorike, provimeve të ndërmjetme (<i>në rastet kur ofrohet</i>) dhe atij final.</p> <p>Format dhe metodat e vlerësimit u bëhen të njohura studentëve që në fillim të lëndës. Nota përfundimtare përbëhet nga Aktivizimi në Seminare, Frekuentimi, Punët e Laboratorit e Detyrat e Kursit, Provimi i Ndërmjetëm (jo gjithmonë) dhe Provimi Përfundimtar, por jo të unifikuar midis syllabuseve, sikundër është përmendur në Standartin III.1, kriteri 1 dhe Standartin III.2, kriteri 3.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>FSHN dhe detyrimisht edhe Departamenti i Biologjisë, nuk kanë arritur të implementojnë dhe integrojnë një sistem të automatizuar për korrigjimin e provimeve, që do shërbente për të minimizuar abuzimin dhe subjektivizmin në vlerësimin e studentëve.</p> <p>- <i>GVJ rekomandon implementimin e një sistemi elektronik korrigjimi, me qëllim rritjen e transparencës dhe shmangjen e formave të ndryshme abuzuese gjatë procesit të vlerësimit.</i></p>

	<p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.8: Rregullore për “Funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës”</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Institucioni dhe njëkohësiht Departamenti i Biologjisë, kanë përcaktuar që vlerësimi përfundimtar i lëndës të realizohet me anë të provimit përfundimtar, proces që zhvillohet në përputhje me syllabusin si edhe sipas rregullores përkatëse të studimeve të FSHN, rregullores të studimeve të Departamentit Biologji dhe rregullores së programit të studimit Master i Shkencave në Biologji Molekulare.</p> <p>Provimi dhe vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga një komision provimesh i përbërë nga të paktën 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit të zhvilluar dhe anëtari tjetër është staf efektiv i departamentit me gradë shkencore ose titull akademik.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Me anë të komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik i ofron studentëve komentet e nevojshme gjatë orëve të leksionit dhe seminareve, lidhur me performancën e shfaqur prej tyre në përvetësimin e njohurive gjatë zhvillimit të seminareve dhe testimeve të ndërmjetme, si edhe duke argumentuar e komentuar nivelin e përgatitjes dhe prezantimit të detyrave dhe projekteve të kursit, gjithashtu edhe të punëve të laboratorit. Gjithashtu stafi akademik ofron këshilla dhe orientimet përkatëse lidhur me përmirësimin e performancës në vijim prej tyre. Pas korrigjimit të provimit nga pedagogët e shpalljes së vlerësimit paraprak, zhvillohen seanca sqaruese, ku studentët mund të shohin në detaje tezën e korrigjuar dhe të marrin</p>

	<p>komentet përkatëse të detajuara mbi vlerësimin e tyre prej pedagogut.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) – Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p><i>Institucioni dhe stafi akademik raportojnë se nuk kanë akses në sisteme dhe platforma të ofruara nga FSHN, që bëjnë të mundur kontrollin e plagjiaturës, por secili prej tyre në mënyrë individuale e kryen kontrollin për plagjiaturën duke përdorur aplikacionet që ofron falas online si Grammarly dhe PlagScan.</i></p> <p>UT gjithsesi ka miratuar një kod etike për kërkimin shkencor.</p> <p>Salla ku zhvillohet provimi monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë, të cilët emërohen me miratim nga Drejtuesi i Departamentit të Biologjisë, dhe janë pikërisht këta anëtarë të stafit akademik që janë përgjegjës për menaxhimin korrekt e konform rregullave të procesit të provimit. Pas dhënies së tezës, nuk lejohet që studentë tjerë të kursit të futen në provim. Anëtarët e komisionit të provimit mbikëqyrin zhvillimin e saktë të provimit, nga dhënia e tezës deri në dorëzimin final të tij.</p> <p>Studenti nuk lejohet të marrë pjesë në dy provime të ndryshme në të njëjtën ditë. Hyrja në provim e personave të jashtëm, përfshirë anëtarë të stafit akademik nuk lejohet, përveçse në rastin e Drejtuesit të Departamentit, Drejtuesit të Fakultetit ose individëve të autorizuar me shkrim nga Drejtuesit e FSHN për të siguruar ecurinë korrekte të zhvillimit të provimeve. Rregulla të rëndësishme e të detajuara për zhvillimin e provimeve janë përcaktuar qartësisht në rregulloren përkatëse. Studentët janë në dijeni të faktit që kopjimi është kategorikisht i ndaluar dhe ndëshkohet e ata penalizohen sipas rregullores përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p>

	<p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.13: Kodi i etikës UT (Neni 5, Pika f)</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në rregulloren e hartuar posaçërisht për programin e studimit është përcaktuar qartësisht procedura e testimit, kontrollit të dijeve dhe e vlerësimit të njohurive. Niveli i përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me anë të sistemit të notave, ku nota kaluese më e ulët është nota pesë. Rezultatet e provimit bëhen të njohura për studentët nga komisioni përkatës pas përfundimit të provimit, brenda 15 ditëve. Në rastin e riprovimeve, rezultatet shpallen pas një jave akademike.</p> <p>Pas zhvillimit të seancave sqaruese dhe ankimese të mundshme me studentët, pedagogu i lëndës ose modulit vazhdon me regjistrimin e vlerësimit përfundimtar në sekretari dhe në sistemin elektronik të UT “e-student”.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.12: Model teze provimi</i></p> <p><i>Evidencë 3.14: Model Proces Verbali Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.8: Rregullore për “Funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës”</i></p> <p><i>Evidencë 4.40: Manual përdorimi “e-Student”</i></p> <p><i>Evidencë 4.41: Manual përdorimi për Pedagogët “e-Student”</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Stafi akademik regjistron rezultatet e provimit në sistemin sistemin elektronik të UT “e-student” brenda një jave, bazuar në Rregulloren e FSHN. Pas shpalljes së rezultateve paraprake, studentët kanë detyrimin të kontrollojnë notën e tyre në sistem dhe të paraqesin një ankesë të mundshme brenda 48 orëve (periudhë që mund të bëjnë kontestimin e rezultatit). Ankesa duhet të jetë me shkrim dhe i drejtohet Drejtuesit të Departamentit të Biologjisë, i cili e vlerëson atë dhe merr vendimin përkatës, i cili mund të jetë edhe ngritja e një</p>

	<p>komisioni <i>ad-hoc</i> për rivlerësimin e provimit dhe komunikimin me studentin.</p> <p>Në përfundim të këtij procesi, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin që të mbyllë përfundimisht këtë proces me dorëzimin e procesverbalit përkatës. Në takimet me Drejtuesit përkatës të Njësive Kryesore/Bazë, pedagogët dhe studentët raportuan se nuk ka pasur asnjëherë ankesa, ndaj nuk ekziston një dokumentim për këtë tip procedure.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.14: Model Proces Verbali Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.8: Rregullore për "Funkcionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës"</i></p> <p><i>Evidencë 4.40: Manual përdorimi "e-Student"</i></p> <p><i>Evidencë 4.41: Manual përdorimi për Pedagogët "e-Student"</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.</p> <p>Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studentët janë në dijeni të faktit që kanë të drejtën e tyre të kontestojnë vlerësimin e marrë në rastin që gjykon dhe konsideron vlerësimin si të pamerituar. Ankesa duhet të dorëzohet me shkrim brenda 48 orëve pas shpalljes së rezultateve, drejtuar drejtuesit të Departamentit dhe Dekanit të Fakultetit.</p> <p>Drejtuesi i Departamentit shqyrton nëse ankesa është e justifikueshme dhe ngarkon një komision <i>Ad-hoc</i> për të rivlerësuar provimin e kryer dhe për të organizuar një komunikimin më pas me studentin ankimues. Ky vendim konsiderohet përfundimtar dhe depozitohet në njësinë bazë dhe sekretarinë mësimore. Procesverbalet e rivlerësimit nënshkruhen dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore për arkivim, ndërsa procesi shoqërohet me regjistrimin e rezultatit të ri në sistem.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p>

	<i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i>			
Konkluzione	<p><i>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik. Vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet sipas përcaktimeve të syllabusit, zakonisht përmes provimit përfundimtar të lëndës ose modulit.</i></p> <p><i>Aktualisht, UT nuk ka implementuar një sistem elektronik për kontrollin e dijeve, që do të mundësonte reduktimin e abuzimeve dhe subjektivitetit në vlerësimin e studentëve, apo një sistem elektronik të licensuar për kontrollin e plagjiaturës.</i></p> <p><i>Studentët, në rast ankesash, gëzojnë të drejtën të kërkojnë rishikimin e tezës dhe të marrin komentet përkatëse pas përfundimit të procedurës së ankimimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” përfshin lëndë dhe module që i mundëson studentëve të thellojnë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale. Plani mësimor i këtij program studimi përfshin 16 lëndë, duke përfshirë provimin përfundimtar me mikrotezë, ku studentët thellojnë njohuritë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale dhe specifike në profilin e biologut molekular (me fokus kryesor në zbatimin e metodave të përshtatshme shkencore për interpretim, analizë dhe të kuptuarit të proceseve biologjike, në të gjithë kompleksitetin e tyre, si edhe të problemeve që lidhen me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare), si dhe synojnë përparimin e studentëve në kërkimin shkencor.

	<p>Gjithashtu programi i studimit nxit aplikimin e njohurive praktike dhe zhvillimin e aftësive kërkimore shkencore, duke përgatitur të diplomuarit me aftësitë e nevojshme për një integrim të suksesshëm në tregun aktual të punës. Kjo sigurohet përmes zhvillimit të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyshjes së detyrimeve përfundimtare.</p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare – Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) – Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Departamenti i Biologjisë deklaron se, konfirmuar edhe nga plani mësimor, programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” përfshin kredite të dedikuara jo aq për lëndët sociale sesa për ato të komunikimit. Kjo kurrikulë siguron zhvillimin e aftësive të veçanta, përveç atyre specifike për profilin, duke ofruar module në fushat e shkencave statistikore dhe ndërveprimit.</p> <p>Në kuadër të kurrikulave të programit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, studentët ndjekin lëndë në fusha të specializuara si “BioInformatika”, “Gjuhë Shkencore Angleze”, “Analiza Biostatistike”, të cilat japin kontributin e tyre në formimin e përgjithshëm të studentëve.</p> <p><i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p> <p><i>Evidencë 3.18: Udhezimi Nr. 52 dhe ndryshimet e tij mbi nivelet e mbrotjes se gjuheve te huaja</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 9: Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E) - Programi i studimit MSc. Biologji Molekulare 2024-2026.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e</p>	<p>Kryesisht gjatë zhvillimit të javës së fundit të çdo semestri, pedagogët e moduleve përkatëse realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që studentët pritet të</p>

<p>studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p> <p>Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>arrinjnë në përfundim të modulit apo lëndës që kanë zhvilluar. Studentët orientohen gjithashtu edhe për çështjet kryesore që do të jenë në fokus dhe që duhet të përgatiten për zhvillimin e provimit final, duke përfshirë strukturën dhe natyrën e pyetjeve të provimit si dhe peshën që ato do të mbajnë në vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde, studentët kanë mundësinë të njihen me informacionin e duhur rreth kompetencave dhe aftësitë që do të fitohen, të ofruara nga moduli përkatës.</p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i> <i>Evidencë 2.5&2.6: Syllabus MSc. Biologji Molekulare - Viti 1 & Viti 2, 2024-2025</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mësimdhënia bazohet në kombinimin e njohurive të fituara në auditor, laborator dhe gjatë zhvillimit të mundshëm të orëve të praktikave klinike, me qëllim arritjen e kompetencave të synuara. Kjo mënyrë paraqitjeje didaktike e procesit mësimor, u mundëson studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre. Për disa module të veçanta të kurrikulës së programit të studimit, pasi studentëve u jepet paraprakisht informacioni i duhur teorik mbi grupet e kompetencave që do të aftësohen, studentët testohen më tej për zbatimin praktik të këtyre kompetencave në laboratorët ku zhvillohet praktika.</p> <p>Punët laboratorike dhe praktikat profesionale realizohen me grupe të vogla studentësh. Siç është theksuar, infrastruktura laboratorike e dedikuar për biologun molekular në institucion është e kënaqshme dhe e pajisur me instrumentat më bashkëkohore, ku përmendim labororet e Biologjisë Molekulare, Fiziologjisë, Mikrobiologjisë apo edhe të Informatikës.</p> <p>Nisur edhe nga fakti që shumica e personelit akademik është gjithashtu e angazhuar dhe specializuar në çështje komplekse molekulare, si edhe ka njohuri bashkëkohore për teknikat dhe teknologjitë më të fundit të përdorura në mikrobiologji molekulare, fiziologji dhe imunologji të avancuar, teknologjinë e ADN-së rekombinante dhe inxhinierinë gjenetike, stafi akademik i angazhuar vazhdimisht mbështet, udhëzon dhe</p>

	<p>drejton studentët në realizimin e detyrave të caktuara apo edhe deri në zbatimin praktik të njohurive teorike.</p> <p>Institucioni dhe stafi akademik bashkëpunojnë me partnerët për të mundësuar dhe përmirësuar mobilitetin e studentëve. Gjithashtu, konstatohet rritje e pjesëmarrjes së stafit akademik në mobilitete jashtë vendit në kuadër të projektit Erasmus+ gjatë viteve të fundit.</p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.5: Strategjia e Zhvillimit të Dep. Biologji 2017-2027</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë 4.15.1: Infrastruktura FShN (Sallat, labororet, biblioteka, etj.)</i></p> <p><i>Evidencë 4.15.2: Infrastruktura FShN (Gjithsej)</i></p> <p><i>Evidencë 4.15: Infrastruktura DB, FShN.</i></p> <p><i>Evidencë 4.16: Foto laboratorit i Biologjisë Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore DSCBK, FSHN, UT (2021)</i></p> <p><i>Evidencë 4.20: Projekt Buxheti Dep Biologji 2023</i></p> <p><i>Evidencë 3.6: UT Manual i sigurimit të cilësisë</i></p> <p><i>Evidencë 13: Procedure Ribursimi Artikuj Shkencore</i></p> <p><i>Evidencë 18.1: Liste mobilitetesh për stafin akademik</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 18: Të ardhurat dhe Financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 19: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 20: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me</p>	<p>FShN dhe Departamenti i Biologjisë organizojnë vazhdimisht orë të hapura për studentët e interesuar për zhvillimet më të</p>

<p>kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>fundit në fushën e zbatimit të metodave shkencore adekuate për interpretim, analizë dhe të kuptuarit të proceseve biologjike, si edhe me fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare.</p> <p>FSHN dhe DB ftojnë pedagogë nga universitete dhe institucione partnere, me të cilat janë lidhur edhe marrëveshjet e bashkëpunimit përkatëse, në kuadër të projekteve ose konferencave të ndryshme që organizohen, gjatë të cilave mbahen leksione për studentët me përmbajtje të dakordësuar paraprakisht me departamentin. Qëllimi është që leksionet jashtë programit të studimit të përfshijnë zhvillimet më të fundit në shkencë dhe/ose teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e saj në biologji molekulare, gjenetikë, imunologji, mikrobiologji apo bioteknologji molekulare, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimet më të reja të teknologjisë brenda strukturës së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 1.11: Programi MSc. Biologji Molekulare 2023-2025</i></p> <p><i>Evidencë 1.20: Raport vjetor 2023-2024, FSHN, UT</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Udhezues Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 6.18: Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 11: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte kerkimore shkencore.</i></p> <p><i>Evidencë 18.1: Listë mobilitetesh për stafin akademik</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 19: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>FSHN dhe Departamenti i Biologjisë, me anë të stafit akademik të tij mbështetin studentët në idetë e tyre inovatore dhe në kërkimet shkencore, duke i përfshirë ata dhe bërë pjesë në realizimin e projekteve kërkimore, rezultatet e të cilave, në raste të caktuara mund të publikohen në Buletinin shkencor të FSHN.</p>

	<p>Gjithashtu, institucioni u ofron studentëve mundësinë për të marrë pjesë në aktivitete shkencore të financuara nga UT, si për shembull konferenca studentore.</p> <p><i>Evidencë 1.2: Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore DSCBK, FSHN, UT (2021)</i></p> <p><i>Evidencë 3.6: UT Manual i sigurimit të cilësisë</i></p> <p><i>Evidencë 4.19: Projekt Buxheti Dep Biologji 2022</i></p> <p><i>Evidencë 4.20: Projekt Buxheti Dep Biologji 2023</i></p> <p><i>Evidencë 13: Procedure Ribursimi Artikuj Shkencore</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 18: Të ardhurat dhe Financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidencë Aneks Tabelat Përmbledhëse: Tabela 19: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Departamenti i Biologjisë, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, organizon orë të hapura për studentët e interesuar në zhvillimet më të fundit në fushën e zbatimit të metodave shkencore të përshtatshme për interpretimin, analizën dhe të kuptuarit e proceseve biologjike në nivel molekular, gjithashtu edhe në fushat e zbatimit të Biologjisë Molekulare.</i></p> <p><i>FSHN fton vazhdimisht pedagogë nga universitete dhe institucione partnere, të cilët marrin pjesë në projekte apo konferenca dhe zhvillojnë leksione të hapura me studentët.</i></p> <p><i>Programi Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” ofron thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale e shkencore të studentëve, të cilët angazhohen vazhdimisht në kërkime shkencore gjithnjë nën mbikëqyrjen e stafit akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>UT dhe vetë FSHN janë kujdesur që në hartimin e rregulloreve të studimeve, të jenë përcaktuar qartë procedurat për detyrimet përmbyllëse para realizimit të tyre dhe njëkohësisht merren masat e nevojshme për publikimin e këtyre procedurave për studentët e FSHN. Këto rregulla gjithashtu janë të përfshira përveçse në rregulloren e FSHN, edhe në rregulloren e Departamentit të Biologjisë dhe në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, deri edhe të paraqitura në suplementin e diplomës.</p> <p>Studentët informohen për këto rregulla në fillim të studimeve. Për të marrë diplomën në Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, studenti duhet të kalojë me sukses provimin përfundimtar me anë të mbrojtjes së “Temës së Diplomës”, në përputhje me kreditet e përcaktuara në planin mësimor. Për të pasur të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar, studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët, duke përmbyllur kështu kreditet e nevojshme.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Udhezues Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.4: DB, MSc Bio. Molekulare (Suplementi diplomës 24)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimeve, Dekani, Drejtuesi i Departamentit dhe stafi akademik përkatës, ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve. Drejtuesi i Departamentit është përgjegjës për sigurimin e informacionit, udhëzimeve dhe materialeve të nevojshme për të garantuar një proces të suksesshëm gjatë provimit të përgjithshëm përfundimtar që zhvillohet me mbrojtje të një “Teme Diplome”.</p>

	<p>Departamenti merr masat që studentët të informohen dhe të kenë kryer të gjitha detyrimet përmbyllëse. Dokumentacioni udhëzues lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve është dhënë në rregulloren e programit të studimit Master Shkencor në “Biologji Molekulare”.</p> <p>Drejtuesi i Departamentit disponon gjithashtu edhe evidencën përkatëse me temat specifike të miratuara për mbrojtjen e diplomës nga studentët në bashkëpunim të ngushtë me pedagogun udhëheqës.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Udhezues Master Biologji Molekulare</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studenti zotëron të drejtën e futjes në provimin përfundimtar vetëm nëse ka marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët, duke përmbushur kështu kreditet e nevojshme.</p> <p>Studenti duhet të kalojë me sukses provimin përfundimtar me anë të mbrojtjes së temës së diplomës, për të marrë diplomën në Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”. Komisioni i propozuar nga Drejtuesi i Departamentit të Biologjisë dhe miratuar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e të gjithë procesit të zhvillimit të mbrojtjes së diplomës, shpalljes së rezultateve dhe trajtimit të ankesave. Vlerësimi final i studentëve realizohet përmes administrimit të provimit me anë të mbrojtjes së temës së diplomës, i cili fokusohet në vlerësimin e punimit shkencor në tërësi dhe referimit të temës së diplomës nga studenti.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Udhezues Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.16: Rregullore Diploma MSc Studentëve</i></p>

	<p><i>Evidencë 3.17: Rregullore e vlerësimit te diplomave MSc Biologji</i></p> <p><i>Evidencë 2.3: Model diplome Master</i></p> <p><i>Evidencë 2.4: Suplement Diplome Biologji Molekulare 2024</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar.</p> <p>Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>FSHN, përfaqësuar nga njësia bazë që ofron këtë program studimi Departamenti i Biologjisë, orienton studentët në fund të vitit të parë duke u vendosur në dispozicion evidencën përkatëse me temat specifike të miratuara (<i>si raste studimore</i>) për mbrojtjen e diplomës të studentëve në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës. Në mënyrë të vazhdueshme, pedagogët udhëheqës asistojnë studentin në nxjerrjen dhe përpunimin statistikor të rezultateve, si edhe respektimin e standarteve të shkrimit akademik të strukturuar të punimit përmbyllës të diplomës, sipas udhëzuesve miratuar në rregulloren e FSHN dhe DB. Pedagogu udhëheqës si proces përmbyllës bën një vlerësim paraprak të punimit duke garantuar cilësinë e rezultateve dhe vendos nëse punimi është i gatshëm për prezantimin shkencor para komisionit përkatës të paracaktuar nga departamenti.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Udhëzues Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 3.16: Rregullore Diploma MSc Studentëve</i></p> <p><i>Evidencë 3.17: Rregullore e vlerësimit te diplomave MSc Biologji</i></p> <p><i>Evidencë 2.3: Model diplome Master</i></p> <p><i>Evidencë 2.4: Suplement Diplome Biologji Molekulare 2024</i></p> <p><i>Evidencë 3.15: Diploma studentesh MSc Bio. Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 5.18: MSc Bio. Molekulare. Titulli i temës, studenti, udhëheqësi.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo</p>	<p>Gjatë gjithë procesit të zhvillimit të punimit të diplomës pedagogu udhëheqës përkatës jep udhëzimet dhe asistencën e nevojshme, ku studenti merr trajnimin e duhur për aspektet</p>

<p>jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>metodologjike, përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore, punën në laborator, shkrimin dhe nxjerrjen e rezultateve.</p> <p>Departamenti i Biologjisë vendos në dispozicion të studentëve për realizimin e pjesës teorike dhe praktike të punimit shkencor të temës së diplomës, infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme didaktike, si edhe bazën materiale të laboratorëve, si edhe bibliotekën fizike dhe online të FSHN.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Udhezues Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 4.15.1: Infrastruktura FShN (Sallat, labororet, biblioteka)</i></p> <p><i>Evidencë 4.15.2: Infrastruktura FShN (Gjithsej)</i></p> <p><i>Evidencë 4.16: Foto laboratorit të Biologjisë Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 4.39: Rregullore Bibliotekës FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 12: Pasurimi i Biblotekes në 5 vitet e fundit</i></p> <p><i>Evidencë 3.16: Rregullore Diploma MSc Studentëve</i></p> <p><i>Evidencë 3.17: Rregullore e vlerësimit të diplomave MSc Biologji</i></p> <p><i>Evidencë 1.19.1: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi</i></p> <p><i>Evidencë 5.1: Vendim i Dekanit, 215. Miratim rregulloresh për Degën mësimore, DSBCCK dhe Bibliotekën</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, specifikohet që pas përfundimit të mbrojtjes së punimit të diplomës të mbajtur para komisionit të paracaktuar nga Drejtuesi i Departamentit Biologji dhe miratuar nga Dekani i FSHN, komision i përbërë prej pesë anëtarësh me titull akademik Profesorë dhe me përvojë në fushën e Biologjisë Molekulare, studenti vlerësohet me notë, ku nota pesë është notë kaluese dhe nota 10 paraqet vlerësimin maksimal. Në suplementin e diplomës shënohen edhe kreditet respektive.</p>

	<p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.4: Suplement Diplome Biologji Molekulare 2024</i></p> <p><i>Evidencë 3.16: Rregullore Diploma MSc Studentëve</i></p> <p><i>Evidencë 3.17: Rregullore e vlerësimit të diplomave MSc Biologji</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Nisur nga Rregullorja e Programit të Studimit, është përcaktuar qartë se studentët që përfundojnë të gjitha detyrimet e programit të studimit, janë të gatshëm të pajisen me Diplomën Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” si edhe me suplementin e diplomës, shoqëruar me listën e notave. Diploma përmban të dhënat e sakta të studentit në përputhje me formatin e miratuar nga MAS. Ajo nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Naturës dhe Rektori i Universitetit të Tiranës.</p> <p>Në çdo diplomë shënohen emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor i Drejtuesve të UT. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e institucionit UT.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore Programi Master Biologji Molekulare</i></p> <p><i>Evidencë 2.3: Model diplome Master</i></p> <p><i>Evidencë 2.4: Suplement Diplome Biologji Molekulare 2024</i></p> <p><i>Evidencë 3.16: Rregullore Diploma MSc Studentëve</i></p> <p><i>Evidencë 3.17: Rregullore e vlerësimit të diplomave MSc Biologji</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës arkivon dokumentacionin e çdo studenti, gjithmonë në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi, ku njësia përgjegjëse është sekretaria mësimore. Pikërisht sekretaria mësimore mban të formatuara sipas akteve nënligjore në fuqi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - regjistrat bazë (<i>themeltar</i>) të plotësuar manualisht ku janë të dhënat personale të studentëve,

	<ul style="list-style-type: none"> - regjistrin e vlerësimeve të marra nga studentët gjatë studimeve, - regjistrin e lëshimit të diplomave apo certifikatave të lidhura me diplomën e marrë. <p>Gjatë vizitës së kryer nga GVJ në sekretarinë mësimore për programin e studimit, u vërtetua se në sekretari arkivohen të gjitha dokumentet e plota të studentëve të diplomuar, përfshirë që nga dokumentacioni i aplikimit deri tek listat e notave.</p> <p>GVJ konstatoi gjithashtu që regjistrat e studentëve plotësohen si në format të shkruar ashtu edhe në format elektronik, duke u mbajtur në ruajtje të përhershme. Çdo student që regjistrohet në UT merr një numër unik matrikullimi, i cili e shoqëron deri në marrjen e diplomës. Të dhënat ruhen gjithashtu në format elektronik në sistemin e brendshëm të FSHN.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë</i></p> <p><i>Evidencë 3.16: Rregullore Diploma MSc Studentëve</i></p> <p><i>Evidencë 3.17: Rregullore e vlerësimit diplomave MSc Biologji</i></p> <p><i>Evidencë 4.24: Rregullore e Sekretarisë Mësimore, FSHN</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UT dhe FSHN kanë hartuar procedurat e nevojshme për zhvillimin e provimit përfundimtar të mbrojtjes së diplomës përmes paraqitjes së temës së diplomës, duke u garantuar studentëve të drejtën e diplomimit pasi të kenë përfunduar me sukses të gjitha detyrimet përkatëse që kërkon cikli i studimeve.</i></p> <p><i>Departamenti i Biologjisë, së bashku me udhëheqësit shkencorë, ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët duke siguruar udhëzime, informacion dhe materiale të nevojshme për përgatitjen dhe paraqitjen finale të punimit të diplomës.</i></p> <p><i>Rregullorja e programit të studimit përcakton qartë se studentët që kanë përmbytur të gjitha detyrimet akademike pajisen me diplomën dhe suplementin përkatës, në përputhje me formatin e miratuar nga MAS.</i></p>

Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet.
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e	Nuk aplikohet.

trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	NA.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit,	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Biologji Molekulare është Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN). GVJ konstanton se personeli akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personeli ndihmës akademik janë angazhuar në realizimin e programit dhe përmbushin kërkesat ligjore, të cilat përfshijnë nivelin akademik, drejtimin e programit, mbulimin e lëndëve etj. Profili i personelit akademik dhe ndihmës akademik të Departamentit të Biologjisë është në përputhje me drejtimet kërkimore shkencore të programit të studimit, natyrën dhe veçoritë e moduleve të tij. Përbërja e personelit akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi është: Viti akademik 2024-2025 PAE 13 Prof. Dr. 6, Prof. Asoc. Dr. 3, Dr. 3, Dr. proc. 1 PAK 1 Prof. Asoc. Dr. 1

<p>natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Viti akademik 2023-2024 PAE 14 Prof. Dr. 6, Prof. Asoc. Dr. 2, Dr. 5, Dr. proc. 1 PAK 1 Prof. Asoc. Dr. 1</p> <p>Viti akademik 2022-2023 PAE 13 Prof. Dr. 5, Prof. Asoc. Dr. 2, Dr. 5, Dr. proc. 1 PAK 2 Prof. Dr. 1, Prof. Asoc. Dr. 1</p> <p>GVJ konstatoi se raporti PAE/PAK është për të treja vitet akademike 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025 është në favor të PAE duke respektuar kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të informacionit lidhur me personelin akademik dhe ndihmës akademik të paraqitur në tabelat përmbledhëse dhe CV e stafit, GVJ konstatoi se numri i stafit dhe i kualifikimit të tij është i qëndrueshëm duke përmbushur kriteret e përcaktuar në IAL për kategoritë Profesor, Doktor. Secila lëndë jepet nga specialistë të fushës përkatëse, të cilët janë me grada shkencore e titujt akademikë përkatës.</p> <p>Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të studimit të ciklit të dytë Msc në “Biologji Molekulare”, në vitet 2022-2025 është angazhuar edhe 1 (një) personel staf akademik me Msc, por që është në proces Doktorature.</p> <p><i>Evidencë: Aneks Tabela MSc. Biologji Molekulare.</i> <i>Evidencë 2.5 dhe 2.6: Sylabuse MASTER SHKENCOR Biologji Molekulare (firmosur).</i> <i>Evidencë 1.14: CV e personelit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në programin Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” janë angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, të cilët janë përgjegjës për mbulimin e moduleve/lëndëve të programit të studimit dhe që zotërojnë titujt e duhur akademik, gradë shkencore dhe master shkencor.</p> <p>GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion lidhur me planet mësimorë, ngarkesën mësimore vjetore si edhe CV e stafit, konstatoi se anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohen në mësimdhënie janë në përputhje të plotë me fushën e programit të studimit dhe profilin</p>

	<p>e lëndëve/moduleve që mbulojnë të cilat pasqyrohen qartë edhe në syllabuset e tyre. GVJ konstatoi se personeli akademik me kohë të plotë mbulon rreth 90 % të ngarkesës mësimore për programin e studimit duke qënë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>2024-2025 – PAE 3512 orë (97%) + PAK 81 orë (3%) = 3593 orë;</p> <p>2023-2024 – PAE 4404.5 orë (98%) + PAK 81 orë (2%) = 4485.5 orë;</p> <p>2022-2023 – PAE 3562.5 orë (96%) + PAK 140 orë (4%) = 3702.5 orë;</p> <p><i>Evidencë: Aneks Tabela 12.1, 12.2, 12.3 MSc. Biologji Molekulare.</i></p> <p><i>Evidencë 1.14: CV e personelit akademik.</i></p> <p><i>Evidencë 1.10 dhe 1.11: Programi i studimit 22-24 dhe 23-25.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar në drejtorinë e burimeve njerëzore si edhe tabelat e karrierës akademike dhe shkencore, në raportet vjetore të departamentit ku zhvillohet programi i studimit, CV e stafit, GVJ konkludon se ka qëndrueshmëri dhe progres të personelit akademik falë edhe mbështetjes institucionale të promovimit të tij.</p> <p>Gjithashtu, nga kontrolli i kontratave të punës dhe respektimit të praktikave të punësimit u konstatua se janë paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>Evidencë 1.8: Model kontrate personel akademik.</i></p> <p><i>Evidencë 4.3: Statusin dhe trajtimin e personelit akademik</i></p> <p><i>Evidencë 4.4: Procedurë punësimi.</i></p> <p><i>Evidencë: Aneks Tabela MSc. Biologji Molekulare.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore si edhe shqyrtimit të evidencave të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, GVJ u informua mbi procedurën dhe praktikën e punësimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, me modelin e kontratave të punës</p>

<p>garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>dhe gjithashtu verifikoi përmbajtjen e dosjes se PAE dhe PAK. Gjatë këtij verifikimi dosja përmbante dokumentacionin si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formatin europass të CV. • Fotokopje e pasaportës ose ID, adresën e banimit. • Formular vetë deklarami/Dëshmi penaliteti, Pozicioni i punës. • Diplomat e noterizuara me listat e notave përkatëse: Bachelor, Master, Doktoratë, Specializim, Dëshmi Titulli Shkencor. • Kualifikimet. • Librezën e punës. • Procedurën e punësimit. <p>Dosjet përditësohen periodikisht në fillim të çdo viti akademik. Institucioni disponon një procedurë të rekrutimit dhe punësimit të PAE/PAK bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, akteve ligjore dhe nënligjore të arsimit të lartë, Statutit e Rregullores së UT.</p> <p>Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur duke garantuar një proces transparent në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Çdo vit departamentet përcaktojnë ngarkesën mësimore, planifikimin e personelit që përfshihet në programin e studimit dhe nevojat për staf akademik nëse ka, të cilat i paraqiten dekanatit që ia përcjell rektoratit dhe më pas kalojnë për miratim në senat. Pas miratimit njësia kryesore bën shpalljen publike të pozicioneve të punës për PAE/PAK duke e publikuar njoftimin. Kandidatët informohen nëpërmjet faqës zyrtare të njësisë kryesore për kriteret përgjithshme/specifike të punësimit, dokumentacionin e nevojshëm, afatet kohore si edhe pikëzimin.</p> <p>Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, drejtuesi i njësisë kryesore ngrre komisionin ad/hoc për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Komisioni ad/hoc kryen vlerësimin e kandidatëve nëpërmjet 2 fazave, shqyrtimit të dokumenteve/dosjes dhe intervistës. Në përfundim të fazës së parë komisioni ad/hoc i përcjell sektorit të burimeve njerëzore listën e kandidatëve të skualifikuar me arsytet përkatëse, të cilët brenda një afati kohor mund të bëjnë ankimmim. Vetëm kandidatët e kualifikuar në fazën e parë vijojnë me fazën e dytë të intervistës për të cilën njoftohen mbi datën dhe orën. Procedura mbyllet dhe vendimi i komisionit i përcillet rektoratit,</p>
--	---

	<p>i cili harton kontratën e punës në bazë të legjislacionit në fuqi dhe kodit të punës. Performanca e stafit akademik vlerësohet jo vetëm në momentin e rekrutimit por vazhdimisht nëpërmjet pyetësorëve të studentëve dhe formularëve të vlerësimit të pedagogut.</p> <p><i>Evidencë 4.4: Procedure punesimi.</i></p> <p><i>Evidencë 4.5: Lista e dokumentave ne dosjen e punonjesit akademik me kontrate.</i></p> <p><i>Evidencë 4.6: Kriteret per hapje vend pune per punonjesit akademik me kontrate. Shpallja e procedurës së aplikimit për pedagogë të jashtëm pranë departamenteve të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Faqja FSHN.</i></p> <p><i>Evidencë 4.7: Kriteret per hapje vend pune per punonjesit akademik efektiv.</i></p> <p><i>Evidencë 4.8: Manual mbi punesimin e personelit ne UT</i></p> <p><i>Evidencë 4.9: Njoftim vend i lire pune ne Departamentin e Biologjisë 2021-2022 faqja FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 4.11: Vendim dekani shpallje fituesi per departamentin e Biologjisë.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit GVJ evidentoi angazhimin e personelit ndihmës akademik të cilët asistojnë në realizimin e orëve laboratorike dhe kujdesen për mirëmbajtjen e laboratorëve që lidhen me programin e studimit MSc. Biologji Molekulare.</p> <p>Personeli ndihmës akademik dhe ai me kohë të pjesshme që angazhohen në veprimtarinë mësimore është i mjaftueshëm, i përket profilit dhe zotëron të gjitha kualifikimet dhe kompetencat për realizimin me cilësi të orëve laboratorike.</p> <p><i>Evidencë: Aneks Tabela Përmbledhëse MSc. Biologji Molekulare.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në vizitën institucionale si edhe bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se UT nëpërmjet kësaj drejtorie disponon, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik, ndihmës akademik</p>

<p>të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” të UT, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Të dhënat që lidhen me aktivitetin dhe ngarkesën mësimore, aktivitetin kërkimor shkencor dhe të çdo angazhimi tjetër të stafit akademik përdoren për tu pasqyruar në analiza dhe raporte vjetore të departamentit dhe drejtorisë së burimeve njerëzore në kuadër të vlerësimit të performancës e dhe në kuadër të vetëvlerësimit në procese tjera angazhimi.</p> <p>Zyra e Burimeve njerëzore disponon dosjet personale të stafit akademik së bashku me marrëveshjet e realizimit të ngarkesës mësimore si edhe dosjet personale të stafit jo akademik. Të dhënat ruhen në regjistrin themeltar të stafit, por edhe në formatin elektronik, theksojmë gjithashtu faktin që këto të dhëna përditësohen çdo vit nga Zyra e Burimeve Njerëzore përfshirë këtu edhe ndryshimet e vendit të punës nëse ka apo tërheqjen e librezës së punës nga individi.</p> <p>Nëpërmjet dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ u njoh me të dhënat tabelore të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, ngarkesën e tyre mësimore në çdo semestër/vit akademik dhe kualifikimin përkatës.</p> <p><i>Evidencë 4.3: Statusi dhe trajtimi i personelit akademik</i></p> <p><i>Evidencë 4.5: Lista e dokumentave në dosjen e punonjesit akademik me kontrate</i></p> <p><i>Evidencë: Aneks Tabelat Përmbledhëse MSc. Biologji Molekulare.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi se FNSH disponon laboratorë të dedikuar për zhvillimin e praktikave laboratorike për programin MSc në Biologji Molekulare të mirëmbajtura dhe të mirë pajisura në të cilat angazhohen personel akademik të profilit përkatës me eksperiencë disa vjeçare në fushën e laboratorit. Gjithashtu, GVJ evidentoi se UT, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete të ndryshme, ISHP, IKV, QSUT dhe institucione të tjera për realizimin e praktikës profesionale.</p>

<p>diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Marrëveshjet kanë si qëllim jo vetëm realizimin e praktikave profesionale por edhe zhvillimin e studimeve kërkimore të studentëve, punimin e diplomave, njohjen e tregut të punës dhe krijimin e lidhjeve për mundësi punësimi në të ardhmen.</p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani e institucione.</i></p> <p><i>Evidencë 1.20: Raport vjetor 2023-2024, FSH, UT.</i></p> <p><i>Evidencë 1.2; Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës</i></p> <p><i>Evidencë 4.15: Infrastruktura e FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 4.16: Foto te laboratoreve (Master shkencor ne Biologji Molekulare)</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të mirë përcaktuar që koordinohet nga përgjegjësit e departamenteve në bashkëpunim me dekanatin dhe titullarin e lëndës për shpërndarjen e praktikës profesionale në bazë të marrëveshjeve me institucionet pritëse duke angazhuar personelin e atij shërbimi si mbikëqyrës i praktikës profesionale.</p> <p>Mbikëqyrësit e praktikave në mjediset përkatëse të angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme bashkëpunojnë ngushtë me stafin akademik efektiv sipas shërbimeve klinike përkatëse. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve/raportin përfundimtar të praktikës si dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për zhvillimin e praktikës profesionale.</p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera</i></p> <p><i>Evidencë 4.15: Infrastruktura e FSHN</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>– <i>Departamenti i Biologjisë përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” përmbush kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me personelin akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, i cili ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</i></p>

	<p>– Rekrutimi i stafit realizohet sipas legjislacionit në fuqi të arsimit të lartë, statutit dhe rregullores së institucionit UT. Institucioni disponon një fond fizik dhe elektronik të të dhënave të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit si dhe kryen përditësimin e këtyre të dhënave çdo vit akademik.</p> <p>– Në këtë program studimi anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohen në mësimdhënie janë në përputhje të plotë me fushën e programit të studimit dhe profilin e lëndëve/moduleve që mbulojnë. Gjithashtu, raporti PAE/PAK është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p> <p>– Institucioni disponon laboratorë të dedikuar për zhvillimin e praktikave laboratorike dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore për realizimin e praktikës profesionale, të konstatuara nga GVJ që janë aktive.</p> <p>– Gjatë kryerjes së praktikës profesionale në mjediset specifike studentët mbikëqyren nga staf akademik me kohë të plotë me profil specifik të cilët marrin pjesë edhe në procesin e vlerësimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedisë mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të	<p>GVJ ka vizituar mjediset mësimore dhe infrastrukturën në shërbim të mësimdhënies dhe aktivitetit shkencor, mjedisit të bibliotekës, shërbimit të teknologjisë së informacionit, si edhe zyrat e administratës dhe personelit akademik në mbështetje të veprimtarisë mësimore dhe shërbimit ndaj studentëve.</p> <p>Aktiviteti mësimor zhvillohet kryesisht në FSHN, i cili përbëhet nga katër godina me një infrastrukturë të përshtatshme dhe në përmbushje të standardeve për zhvillimin e një procesi mësimor sa më cilësor. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ u njoh</p>

<p>programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>me të dhënat për zhvillimin e infrastrukturës, investimet, planimetritë dhe sipërfaqët në funksion të procesit akademik, stafit dhe studentëve.</p> <p>GVJ konstatoi se FSHN ka në dispozicion 2570 m² në dispozicion për salla leksionesh dhe rreth 3500 m² për laboratore, ku programi i biologjisë shfrytëzon 6 laboratore. FSHN disponon gjithashtu zyrën e informacionit për studentët, zyrën e shërbimit informatik IT si edhe arkivën. Organizimi i orarit mësimor realizohet në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Në takimin me stafin dhe drejtuesit GVJ u informua se procesi mësimor për programin e ciklit të dytë zhvillohet pasdite.</p> <p><i>Evidencë 4.15: Infrastruktura e FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 4.16: Foto të laboratoreve (MSc në Biologji Molekulare)</i></p> <p><i>Evidencë: Aneks Tabelat Përmbledhëse MSc. Biologji Molekulare.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore të FSHN janë të mjaftueshme dhe garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik duke marrë në konsideratë jo vetëm kapacitetet e posteve në raport me numrin e studentëve, por edhe mjetet didaktike dhe të kancelarisë në funksion të procesit mësimor.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi se disponohen klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, të cilat janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teoriko-praktik, përmes përdorimit të metodave e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Laboratorët janë të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për procesin mësimor. Zyrat e personelit janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme të punës, duke përfshirë pajisjet teknologjike dhe elektronike.</p> <p>Mjediset e FSHN kanë shërbime tualeti, sistem të mbrojtjes kundër zjarrit të cilat u konstatuan edhe gjatë vizitës në institucion. Ndriçimi natyral dhe artificial është i mjaftueshëm për realizimin e aktivitetit akademik.</p>

	<i>Evidencë 4.15: Infrastruktura e FSHN</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>FSHN disponon 6 laboratorë të dedikuar për programin MSc. “Biologji Molekulare”. GVJ vizitoi mjediset e laboratorëve të cilat ishin të pajisur me mjetet e nevojshme për aftësimin praktik të studentëve sipas natyrës specifike të programit si mikroskop për ekzaminime, pajisje mikrobiologjike, fotometër, laborator i biologjisë molekulare, kultura qelizore, etj.</p> <p><i>Evidencë 4.15: Infrastruktura e FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 4.16: Foto te laboratoreve (Master shkencor ne Biologji Molekulare)</i></p> <p><i>Evidencë 4.2:0 Projekt Buxheti Dep Biologji 2023</i></p>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>FSHN disponon një laborator të teknologjisë së informacionit në funksion të programit MSc. “Biologji Molekulare”. Institucioni ka përmirësuar vazhdimisht infrastrukturën laboratorike nëpërmjet investimit të drejtpërdrejtë por edhe falë pjesëmarrjes në projekte.</p> <p><i>Evidencë 4.23: Inventar Laboratori Bioinformatika</i></p>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë	<p>Institucioni, në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), disponon mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera të domosdoshme praktike.</p> <p>FSHN dhe DB, edhe pse zotërojnë kapacitetet e duhura për të zhvilluar praktikën profesionale, bashkëpunojnë me institucione të tjera të arsimit të lartë si dhe me institucione private laboratorike të cilët vënë në dispozicion të studentëve personel të kualifikuar për udhëheqjen e studentëve në praktikën profesionale.</p> <p><i>Evidencë 1.19: Marrëveshje të FSHN me kompani dhe institucione të tjera.</i></p> <p><i>Evidencë 4.15: Infrastruktura e FSHN</i></p>

strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.	<i>Evidencë 4.16: Foto te laboratoreve (Master shkencor ne Biologji Molekulare)</i>			
	<i>Evidencë: Aneks Tabela Përmbledhëse MSc. Biologji Molekulare.</i>			
Konkluzione	<p>- <i>Institucioni siguron mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik të studentëve.</i></p> <p>- <i>FSHN dhe DB zotërojnë laboratorë të dedikuar për programin MSc. "Biologji Molekulare", që përmbajnë aparatura dhe mjete të nevojshme për aftësimin praktik të studentëve sipas natyrës specifike të programit.</i></p> <p>- <i>Në funksion të programit të studimit është laborator i teknologjisë së informacionit i dedikuar veçanërisht për bioinformatikën.</i></p> <p>- <i>Institucioni në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera disponon ambiente dhe mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>FSHN siguron literaturë bazë dhe ndihmëse në dispozicion të studentëve në programin e studimit MSc. "Biologji Molekulare" qoftë si fond fizik, qoftë duke aksesuar bibliotekën dixhitale në mbështetje të mësimdhënies dhe mësim nxënies.</p> <p>Studentëve u rekomandohet gjithashtu ndjekja e revistave apo aksesimi online i teksteve, kjo u konstatua edhe gjatë takimit me studentët dhe stafin në vizitën institucionale. Biblioteka disponon fond fizik të librave mësimore, postë interneti dhe</p>

	<p>kompjuterë që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës në mbështetje të procesit mësimor.</p> <p><i>Evidencë 4.39: Rregullore e bibliotekes.</i></p> <p><i>Evidencë 4.40: Manual përdorimi e-student</i></p> <p><i>Evidencë 4.33: Faqja on-line UT https://unitir.edu.al/</i></p> <p><i>Evidencë 2.5 dhe 2.6: Programet e lëndëve (Syllabus-et) të programit mësimor Master i shkencave në "Biologji molekulare"</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Biologjisë, u deklarua se çdo fillim viti akademik në mbledhjen e departamentit kërkohet prej pedagogëve përditësimi i literaturës me botime të 5 viteve të fundit, i cili duhet pasqyruar në syllabuset e lëndëve. Titullari i lëndës dorëzon në njësinë përgjegjëse (Departamenti i Biologjisë) syllabusin e lëndës ku jepet informacioni mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar.</p> <p><i>Gjatë shqyrtimit të syllabuseve dhe kurrikulës, GVJ evidentoi se literatura bazë e detyruar në disa lëndë nuk ishte e përditësuar me botime të 5 viteve të fundit.</i></p> <p>Në syllabuse ajo referohet si "<i>leksione të përgatitur nga pedagogu</i>", "<i>leksione të shkruara</i>" ose si tekst mësimor pa dhënë detaje si viti i botimit, emri i shtëpisë botuese, ISBN, numri i botimit ose i volumit etj., në mungesë të mënyrës së paraqitjes të një reference bibliografike.</p> <p>Nisur nga syllabuset e lëndëve të vëna në dispozicion vihet re që në disa lëndë, literatura bazë dhe e rekomanduar nuk është e pesë viteve të fundit (p.sh. sipas kronologjisë së materialit të ngarkuar të syllabuseve mund të evidentojmë se në lëndën "Struktura dhe Sjellja e Makromolekulave", mungojnë në literaturë vitet e botimit; lënda "Gjenetika Molekulare", literaturë bazë ka vetëm leksione të shkruara pa specifikuar mbi cilin tekst është mbështetur, etj.) Gjithashtu, gjatë vizitës në bibliotekë dhe shqyrtimit të referencës që ka të bëjë me informacionin mbi bibliotekën e FSHN-së u evidentua literaturë kryesisht jo e viteve të fundit. Aksesimi online ose në bibliotekën dixhitale</p>

	<p>përmbush standardin për botime të viteve të fundit dhe janë tekste kryesisht me autorë e gjuhë të huaj.</p> <p>Rekomandim: GVJ rekomandon përditësimin e literaturës bazë të detyruar me botime të viteve të fundit dhe pasurimin e fondit fizik të bibliotekës me literaturë të përditësuar brenda 5 viteve të fundit, mundësisht edhe në gjuhën shqipe.</p> <p>GVJ rekomandon modelin e një reference bibliografike me detajet e duhura në përshkrimin e literaturës bazë në syllabuse.</p> <p><i>Evidencë 2.5: Programet e lëndëve (Syllabus-et) të programit mësimor Master i shkencave në “Biologji molekulare”</i></p> <p><i>Evidencë 2.6: Programet e lendeve Syllabus Msc molekulare viti 2</i></p> <p><i>Evidencë 12: Pasurimi i Biblotekës në 5 vitet e fundit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët dhe stafi akademik mund të përdorin ambientet e bibliotekës për të punuar dhe studiuar, aksesuar në literaturën fizike dhe atë online. Në faqen web të bibliotekës ata mund të marrin informacion mbi burimet e vëna në dispozicion. Burimet online mund të aksesohen brenda rrjetit të universitetit përmes regjistrimit me email-in institucional, ndërsa jashtë rrjetit realizohet në mënyrë “remote” përmes Pikës Qendrore të Regjistrimit, në varësi të licencës. Stafi i bibliotekës është në dispozicion të interesuarve, nëse ata kanë nevojë për informacion mbi burimet e kërkuara apo udhëzime gjatë kërkimit online. Gjatë vizitës institucionale GVJ evidentoi se biblioteka e FSHN përmban një sallë leximi me hapësirë të bollshme dhe të dedikuar për studentët duke u garantuar atyre mundësi të barabarta të shfrytëzimit të literaturës sipas programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 4.39: Rregullore e bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën</p>	<p>Biblioteka e FSHN është ndërtuar mbi bazën e nevojave që burojnë nga kurrikulat e ofruara. Ajo ofron një numër të konsiderueshëm tituj literaturë fizike, të cilët mbulojnë nevojat për realizimin me sukses të programeve të studimit, zbatimin e</p>

<p>shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>syllabuseve, zhvillimin e praktikave profesionale dhe përgatitjen e temave të diplomës.</p> <p>Në këtë program studimi, një vend qendror zë literatura në gjuhën angleze, ndërkohë që biblioteka ofron edhe literaturë mbështetëse në gjuhën shqipe. Biblioteka mundëson huazimin e burimeve fizike për një periudhë të caktuar kohe në përputhje me rregulloren.</p> <p><i>Evidencë 4.39: Rregullore e bibliotekes.</i></p> <p><i>Evidencë 12: Pasurimi i Biblotekës në 5 vitet e fundit</i></p> <p><i>Vizita institucionale</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët e FSHN kanë akses falas në bibliotekën fizike dhe online të institucionit në funksion të programit mësimor. Në takimin me studentët në vizitën institucionale GVJ u informua se biblioteka fizike dhe online e FSHN shfrytëzohet në mënyre të barabartë dhe pa pagesë për studentët. Bazuar në dokumentacion, UT është pjesë e librarive të ndryshme online ku studentët mund të gjejnë dhe aksesojnë literaturën e dëshiruar nga salla e bibliotekës por mund ta aksesojnë atë online në çdo kohë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. ASTM 2. Edgar 3. IOP 4. MSP 5. JStore 6. Unpay Wall <p><i>Evidencë 4.39: Rregullore e bibliotekes.</i></p> <p><i>Evidencë 12: Pasurimi i Biblotekës në 5 vitet e fundit</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e FSHN është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për studentët, fakt i evidentuar nga GVJ në vizitën institucionale.</p>

<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e FSHN është në dispozicion të studentëve për literaturë bazë dhe suplementare, fizike dhe online. Ajo funksionon dhe organizohet sipas rregullores së fakultetit.</p> <p>GVJ konstatoi gjatë vizitës institucionale se orari i shërbimit të bibliotekës është nga ora 08:00 deri në orën 19:00, në çdo ditë të javës, orar ky i përshtatshëm me oraret e programit të studimit dhe nevojave të studentëve. FSHN ka punonjës të veçantë për bibliotekën në shërbim të mirëmbajtjes dhe nevojave të studentëve.</p> <p><i>Evidencë 4.39: Rregullore e bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qënë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>FSHN planifikon çdo vit buxhet për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës. Departamentet propozojnë kërkesat buxhetore për pasurimin e fondit fizik dhe online të bibliotekës. Bazuar në këto kërkesa Biblioteka i drejtohet administratorit të fakultetit për sigurimin e botimeve të reja dhe aksesin në libraritë online nëpërmjet abonimit.</p> <p>Gjatë bisedës me studentët dhe stafin në vizitën institucionale u deklarua prej tyre se ata shfrytëzojnë në mënyrë të kënaqshme veçanërisht informacionin dixhital si edhe atë fizik të bibliotekës.</p> <p><i>Evidencë 4.17: Projekt Buxheti Dep Biologji 2021</i></p> <p><i>Evidencë 4.18: Buxheti FSHN 2021</i></p> <p><i>Evidencë 4.19: Projekt Buxheti Dep Biologji 2022</i></p> <p><i>Evidencë 4.20: Projekt Buxheti Dep Biologji 2023</i></p> <p><i>Evidencë 4.21: Buxheti FSHN 2023</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>– <i>FSHN dhe DB sigurojnë literaturë bazë dhe ndihmëse në dispozicion të studentëve si fond fizik dhe akses dixhital në mbështetje të mësimdhënies dhe mësim nxënies.</i></p> <p>– <i>Biblioteka është në funksion të programit mësimor për studentët, personelin akademik të FSHN dhe programit Biologji Molekulare.</i></p>

	<p>–Biblioteka e FSHN ka hapësira të bollshme dhe të dedikuar për studentët sipas programit të studimit.</p> <p>– Institucioni siguron shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekën fizike dhe online të fushës së programit të studimit. Orari i shërbimit të bibliotekës është 08:00 - 19:00 çdo ditë të javës, orar ky i përshtatshëm me oraret e programit të studimit dhe nevojave të studentëve.</p> <p>– Fondi fizik i bibliotekës dhe literatura bazë e detyruar në disa lëndë, në syllabuse nuk është e përditësuar me botime të 5 viteve të fundit dhe shpesh referohet si "leksione të përgatitur nga pedagogu i lëndës", "Leksione të shkruara".</p> <p>– Literatura bazë e detyruar në syllabuse shpesh ka mungesë të të mënyrës së paraqitjes të një reference bibliografike.</p> <p>– GVJ rekomandon përditësimin e literaturës bazë të detyruar me botime të viteve të fundit duke qënë se institucioni e disponon aksesin online prestigjioz për literaturë mjekësore dhe pasurimin vazhdimisht të fondit fizik të bibliotekës me tituj të rinj, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e ciklit të dytë të studimeve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në	UT dhe FSHN disponojnë një sistem të dedikuar të menaxhimit të veprimtarive akademike dhe mësimdhënies, informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim mbahet nga njësitë administrative, si zyrat e Sekretarisë Mësimore dhe Burimeve Njerëzore. Gjatë vizitës në Sekretarinë

<p>diplomim në programin e studimit.</p>	<p>mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Evidencë 4.24: Regullore sekretaria mesimore</i> <i>Evidencë: 4.40: Manual perdorimi e-student</i> <i>Evidencë 4.41: Manual perdorimi e-pedagog.</i> <i>Evidencë 4.27: Fatura sherbimesh Cikli dyte.</i> <i>Evidencë 4.28: Vertetim studenti</i> <i>Evidencë 4.29: Liste notash</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës/akademik dhe administrativ të angazhuar në realizimin e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion por edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ verifikoi se institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, të cilat aksesohen nga stafi dhe studentët.</p> <p><i>Evidencë: 4.40: Manual perdorimi e-student</i> <i>Evidencë 4.41: Manual perdorimi e-pedagog.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se aksesit në sistemin e FSHN mundësohet nëpërmjet faqes web, ku mundësohet hyrja e dedikuar e studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Nëpërmjet këtij sistemi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studentët kanë akses në të dhënat e tyre akademike, notat, mungesat, si dhe të dhënat financiare; 2. Stafi akademik ka akses për të parë rezultatet akademike të studentëve me qëllim që të ndjekë ecurinë e tyre dhe për të bërë këshillimin e duhur në lidhje me lëndët që studenti duhet të ndjekë në semestrin pasardhës. <p><i>Evidencë: https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-biologjise/programmes/biologji-molekulare-msc</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që</p>	<p>Institucioni nëpërmjet sistemit elektronik të të dhënave siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për të gjithë studentët dhe stafin akademik (PAE/PAK), të cilët kanë profilin</p>

<p>mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>e tyre në sistem. Institucioni u ka vendosur në shërbim studentëve dhe stafit adresat e-mail zyrtar@fshn.edu.al të cilat shërbejnë për komunikim interaktiv midis personelit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Evidencë:</i> https://fshn.edu.al/departments/departamenti-i-biologjise/programmes/biologji-molekulare-msc</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, por gjithashtu mundësi për raportime dhe të dhëna për organet drejtuese. Gjithashtu informacioni mundësohet edhe nëpërmjet faqes zyrtare të FSHN dhe UT, të cilat pasqyrojnë veprimtarinë administrative, akademike, institucionale, zgjedhore, programin e transparencës, kulturore e sociale, të gjitha ciklet dhe programet e studimit, disertacionet e doktoratave të mbrojtura.</p> <p>Përveç sistemeve të sipërpërmendura, forma të komunikimit interaktiv janë edhe përdorimi i email-eve zyrtare të institucionit, google classroom, google site, google meet pa limit për personelin akademik dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 4.33: Faqja online e UT https://unitir.edu.al/</i> <i>Faqja online e FSHN http://fshn.edu.al</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Institucioni disponon faqen zyrtare https://unitir.edu.al/ në të cilën pasqyrohen aktivitetet në nivel njësie kryesore. FSHN disponon faqen zyrtare https://fshn.edu.al/ e cila përditëson periodikisht aktivitetet e organizuara nga departamentet dhe stafi akademik, programin mësimor, strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, etj.</p> <p>Nëpërmjet kësaj platforme studentët, partnerët dhe gjithë të interesuarit informohen në lidhje me thirrje, njoftime, kërkesa apo mundësi të ndryshme që ofrohen nga institucioni. Faqja zyrtare në web është në gjuhën shqipe dhe angleze.</p> <p><i>Evidencë 4.33: Faqja online e UT https://unitir.edu.al/</i> <i>Evidencë: Faqja online e FSHN http://fshn.edu.al.</i></p>

Konkluzione	<p>- Institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit dhe e vendos atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p> <p>- Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin akademik, sekretarinë mësimore, autoritetet drejtuese e studentët e programit të studimit.</p> <p>- Sistemi Easy-Web ka në shërbim të studentëve dhe stafit, adresat email zyrtar@fshn.edu.al., të cilat shërbejnë për komunikim interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>- Institucioni disponon faqen zyrtare http://fshn.edu.al/ në të cilën pasqyrohen aktivitetet në nivel njësie kryesore në gjuhën shqipe dhe angleze.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Institucioni FSHN harton çdo vit akademik Raportin Vjetor i cili është dokumentacioni kryesor përmbledhës i analizës vjetore të veprimtarisë akademike, shkencore dhe financiare të çdo njësie kryesore dhe strukturave të tjera të UT.</p> <p>Departamenti i Biologjisë harton buxhetin në funksion të mbështetjes së programeve të studimit. Fondet për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi miratohen nga Bordi i Administrimit dhe burojnë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e universitetit. Shpërndarja bëhet në bazë të kërkesave buxhetore të planifikuara në fillim të çdo viti akademik nga njësitë kryesore.</p>

	<p><i>Evidencë 4.17: Projekt Buxheti Dep Biologji 2021-2022</i></p> <p><i>Evidencë 4.18: Buxheti FSHN 2021</i></p> <p><i>Evidencë 4.19: Projekt Buxheti Dep Biologji 2022</i></p> <p><i>Evidencë 4.20: Projekt Buxheti Dep Biologji 2023</i></p> <p><i>Evidencë 4.21: Buxheti FSHN 2023</i></p> <p><i>Evidencë 4.37: Mbledhje bordi administrimi UT per miratim buxhetesh 2023.</i></p> <p><i>Evidencë 4.38: Mbledhje bordi administrimi UT per miratim buxhetesh 2024.</i></p>
<p>Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>FSHN harton çdo vit akademik buxhetin në bazë të kërkesave dhe planifikimeve të departamenteve, i cili miratohet nga Bordi i Administrimit. Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, shpenzimet e personelit në veprimtari të ndryshme shkencore si pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare apo mobilitete të miratuara nga Departamenti i Biologjisë si njësi bazë e ofrimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se laboratorët i përmbushnin standardet për bazën materiale në funksion të programit të studimit. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se institucioni ka investuar nëpërmjet kërkesave buxhetore të përvitshme për materiale dhe pajisje laboratorike në mbështetje të programit të studimit, për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe mbështetjen e stafit në aktivitete të ndryshme shkencore.</p> <p><i>Evidencë 4.18: Buxheti FSHN 2021</i></p> <p><i>Evidencë 4.20: Projekt Buxheti Dep Biologji 2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e</p>	<p>Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>




<p>financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe dokumentacion, GVJ evidentoi se struktura përgjegjëse për auditimin e brendshëm e ngritur nga UT është Drejtoria e Auditit të Brëndshëm dhe Sektori i Auditimit të Performancës të cilat ushtrojnë veprimtari të pavarur, sigurojnë zbatimin e duhur dhe respektimin e kërkesave ligjore, politikave etj., sigurojnë vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të kontrollit të brendshëm.</p> <p>GVJ konstatoi se UT përdor dhe instrumente të tjerë të jashtëm (audit i jashtëm) për procesin e mbikëqyrjes dhe vlerësimin, për përmirësimin e proceseve të menaxhimit të brendshëm.</p> <p><i>Evidencë 4.1: Struktura organizative e UT</i></p> <p><i>Evidencë: https://unitir.edu.al/en/tabela-raportim-monitorimi/</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>FSHN informon dhe raporton Departamentin e Biologjisë në cilësinë e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p> <p>Ky informim realizohet jo vetëm me hartimin e Raportit Vjetor të UT/FSHN por dhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit që mundëson raportimin në kohë reale për veprimtaritë që kryhen nga njësitë. Nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi jo vetëm shpenzimet financiare në bazë të kërkesave dhe planifikimit që bën çdo fakultet në mbështetje të veprimtarisë akademike por edhe të ardhurat financiare nga tarifat e shkollimit, grantet dhe projektet ndërkombëtare. GVJ ka gjetur disa të dhëna që rimbursojnë pedagoget në punët e tyre kërkimore shkencore. GVJ ka evidentuar gjithashtu buxhetin afatmesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit.</p> <p><i>Evidencë: https://unitir.edu.al/en/tabela-raportim-monitorimi/</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të</p>	<p>UT dhe FSHN garantojnë qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Këto kapacitete bazohen në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit, tarifa regjistrimi, buxheti i shtetit, dhe projektet.</p>

këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<p><i>Evidencë 4.18: Buxheti FSHN 2021</i></p> <p><i>Evidencë 4.19: Projekt Buxheti Dep Biologji 2022</i></p> <p><i>Evidencë 4.20: Projekt Buxheti Dep Biologji 2023</i></p> <p><i>Evidencë 4.21: Buxheti FSHN 2023</i></p> <p><i>Evidencë 4.38: Mbledhje bordi administrimi UT per miratim buxhetesh 2024</i></p>
---	--

Konkluzione	<p>- <i>UT dhe FSHN hartojnë çdo vit akademik një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</i></p> <p>- <i>Fondet burojnë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e universitetit. Shpërndarja bëhet në bazë të kërkesave buxhetore të planifikuara në fillim të çdo viti akademik nga njësitë kryesore.</i></p> <p>- <i>FSHN harton çdo vit akademik buxhetin në bazë të kërkesave dhe planifikimeve të departamenteve, i cili miratohet nga Bordi i Administrimit të UT.</i></p> <p>- <i>Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit, tarifa e regjistrimit, të ardhurat e përfuara nga buxheti i shtetit dhe nga grante dhe projekte.</i></p>
--------------------	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës kanë hartuar Statute dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi ku përshkruhen qartë politikat e procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Bazuar në Statutin e UT, Rregulloren FSHN, Rregulloren e Departamentit të Biologjisë që mbulon programin e Biologjisë Molekulare, GVJ evidentoi se FSHN zbaton politika të pranimit të studentëve duke respektuar kriteret bazë të pranimit, kriteret përzgjedhëse, kuotat e planifikuara për kandidatët vendas, kandidatët nga vende shqip folëse, për kategoritë e marginalizuara, etj. Gjithashtu në këto dokumente përcaktohen qartë procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta.</p> <p>Në funksion të informimit të studentëve nga regjistrimi në diplomim janë në dispozicion sekretaritë mësimore në nivel departamenti dhe fakulteti, zyra e këshillimit të karrierës si edhe stafi akademik. Për studentët e regjistruar organizohen ditët informative. Studentët gjithashtu marrin informacion nëpërmjet Rregullores së FSHN dhe Departamentit lidhur me organizimin e programeve, diplomimin, etj.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë.</i></p> <p><i>Evidencë 1.23: Kriteret e pranimit në Ciklin e Dytë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UT dhe FSHN sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët për student sipas programeve të studimit. Bazuar në dokumentacion, GVJ evidentoi se UT ka ngritur komisione ad-hoc të përbëra nga përfaqësues të çdo fakulteti që zbatojnë bazuar në kriteret, procedurat e përzgjedhjes së studentëve të rinj. Studentët kanë mundësi të njëjta për informim, kandidim në forume drejtuese, konkurrim për bursa, pjesëmarrje në mobilitete në kuadër të projekteve Erasmus apo pjesëmarrje në</p>

	<p>aktivitete të ndryshme promocionale. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente dhe meritokrasi.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore e programit të studimit Master i shkencave në "Biologji molekulare".</i></p> <p><i>Evidencë 1.22: Kuotat e pranimit për Ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në FSHN.</i></p> <p><i>Evidencë 2.13: Learning agreement mobilitet studentësh vendas</i></p> <p><i>Evidencë 2.14: Learning agreement mobilitet studentësh të huaj</i></p> <p><i>Evidencë 1.23: Kriteret e pranimit në Ciklin e Dytë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, pas kërkesës dhe udhëzimeve të MAS, Departamenti i Biologjisë propozon dhe përcakton numrin e kuotave dhe kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve, të cilat dërgohen në UT, miratohen në Senat dhe më pas nga MAS.</p> <p>I gjithë informacioni publikohet në faqen zyrtare të UT/FSHN. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe transferimit të studentëve sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 1.23: Kriteret e pranimit në Ciklin e Dytë.</i></p> <p><i>Evidencë 5.6: Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në programet e UT bazohet në Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, në Statutin e UT dhe Rregulloren e UT.</p> <p>FSHN zbaton të gjitha kërkesat ligjore në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për të përfunduar procesin e regjistrimit, i cili dorëzohet në sekretarinë mësimore përkatëse. Rregullorja e departamentit të biologjisë, rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset paraqesin qartë dhe në mënyrë të detajuar programin mësimor, format e mësimdhënies, mënyrën e kontrollit të dijeve, detyrat/projektet, procesin e diplomimit, etj.</p>

	<p>Gjithashtu në rregulloren e departamentit paraqiten qartë rregullat për ndërprerjen e studimeve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme. Informacionet e mësipërme janë të publikuara dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të UT dhe FSHN.</p> <p>Në takimin me studentët gjatë vizitës institucionale, GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur në lidhje me informimin dhe komunikimin me sekretariatë mësimore, zyrën e këshillimit të karrierës dhe aksesimit të informacionit në faqen web të FSHN.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë.</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore e programit të studimit Master i shkencave në "Biologji molekulare".</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Rregullore diplomimi master në nivel departamenti</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>FSHN dhe Departamenti i Biologjisë organizojnë ditët e hapura informuese për programet e studimit, kriteret e përgjithshme e të veçanta të tij dhe disponon një kalendar të këtyre aktiviteteve. Informacioni përcillet dhe pasqyrohet përmes faqës zyrtare të web (https://fshn.edu.al/), e cila përditësohet vazhdimisht duke iu ofruar studentëve dhe të interesuarve një informacion të detajuar jo vetëm për programet dhe kurrikulën, por edhe në lidhje me aktivitetet studentore, akademiko-shkencore, social-kulturore, etj. Gjithashtu, FSHN vendos në dispozicion të studentëve dhe kandidatëve të interesuar materiale informuese si broshura dhe fletëpalosje, të cilat reflektojnë zhvillimin e institucionit dhe programeve të tij. FSHN dhe DB marrin pjesë në panairët e organizuara nga dhoma e tregtisë në qytetet e Shqipërisë që i japin mundësinë këtij institucioni të promovojë programet që ofron dhe eventet e ndryshme që organizon në shërbim të studentëve.</p> <p><i>Evidencë 5.7: Raport mbi vizitë njohëse dhe informuese per shkollat e mesme, 2021&2022.</i></p> <p><i>Evidencë 5.14: Broshurë: Ditë informimi për maturantët. 2019.</i></p>

	<p><i>Evidencë 5.16.1: Ditet e informimit te maturanteve online 2022.</i></p> <p><i>Evidencë 5.16.2: Takimet ne auditor.</i></p> <p><i>Evidencë 5.19: Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, 22-23.</i></p> <p><i>Evidencë 5.20: Panairi i karrierës.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UT, FSHN dhe Departamenti i Biologjisë planifikojnë kuota të dedikuara për studentët që vijnë nga kategori të veçanta sociale, studentë me aftësi të kufizuara/veçanta; studentë romë, ballkanas, egjiptian, studentët me statusin e jetimit, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, etj., në përputhje me strategjitë kombëtare përkatëse. UT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara duke ofruar njëkohësisht mbështetje të vazhdueshme veçanërisht mbështetje financiare në kuadër të politikave mbështetëse për arsimin gjithëpërfshirës.</p> <p><i>Evidencë 1.22: Kuotat e pranimi për Ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në FSHN.</i></p> <p><i>Evidencë 1.23: Kriteret e pranimi në Ciklin e Dytë.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>UT harton dhe publikon kriteret dhe kuotat për kategoritë e studentëve nga trojet përpara çdo viti akademik bazuar në historikun e kërkesave gjatë viteve paraardhëse. Këto kriteret janë në përputhje me aktet nënligjore të MAS.</p> <p><i>Evidencë 1.22: Kuotat e pranimi për Ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në FSHN.</i></p> <p><i>Evidencë 1.23: Kriteret e pranimi në Ciklin e Dytë.</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Çdo vit akademik, UT dhe FSHN hartojnë dhe realizojnë procedura specifike të bursave dhe ndihmës financiare për studentët me mesatare të lartë hyrëse në Universitet, për studentët me aftësi të kufizuara, studentët me një prind, fëmijë të ish të dënuarve, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, etj. Këto vendime merren nga Bordi i Administrimit të UT.</p> <p>Studentët e interesuar për fitimin e mbështetjes financiare duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm në zyrat e</p>

	<p>protokollit të cilat me shkresë shoqëruese të Dekanit të Fakultetit, depozitohen dhe shqyrtohen në Bordin e Administrimit. Kjo procedurë bazohet në Statutin dhe Rregulloren e UT, ndërsa kostot financiare rimbursohen nga buxheti i shtetit për llogari të UT.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 5.26: Përcillen kuotat e propozuara nga Departamenti i Biologjisë për 2022-2023.</i></p> <p><i>Evidencë 5.30: Vendimi i bordit për listat e studentëve që përfitojnë bursë, përjashtimreduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2023-2024.</i></p>			
Konkluzione	<p>– UT/FSHN ndjekin dhe zbatojnë politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore.</p> <p>– Çdo vit akademik, UT mbështet studentët me bursa dhe ndihmë financiare, kryesisht studentët ekselentë dhe shtresat në nevojë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe	FSHN dhe Departamenti i Biologjisë si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në Biologji Molekulare, nëpërmjet rregullores së saj, rregullores së programit të studimit dhe syllabuseve, disponon për studentët e programit të studimit informacion të plotë dhe të hollësishëm

<p>kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Gjithashtu, për të ndjekur ecurinë dhe rezultatet akademike të studentëve, institucioni siguron informacion zyrtar edhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit, i cili aksesohet nga stafi akademik me kohë të plotë.</p> <p>Në rregullore, studenti gjen informacion për shkallen e frekuentimit të detyruar të programit të studimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75%. 2. Frekuentimi i seminareve/ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75%. 3. Frekuentimi i punëve laboratorike, detyrave të kursit dhe mësimit praktik është i detyrueshëm në masën 100%. <p>Kur studenti nuk ka frekuentuar mbi 25% për pikat 1 dhe 2 ai është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimit në vitin pasardhës me të njëjtin detyrim frekuentimi.</p> <p>Për pikën 3, nëse studenti nuk ndjek qoftë edhe një seancë mësimi, atij i krijohet një mundësi për ta shlyer frekuentimin e detyruar përpara përfundimit të semestrit.</p> <p>Në rast të përsëritjes së mungesave, studenti i ndjek ato në vitin pasardhës. Gjatë bisedës me studentët në vizitën institucionale, GVJ u informua se studentët njihen me kriteret e vlerësimit për secilën lëndë edhe në orën e parë të leksionit ku pedagogu përkatës bën prezantimin e syllabusit. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi regjistrat e frekuentimit të procesit mësues nga studentët e çdo grupi mësues, i cili plotësohet në çdo orë mësuese nga pedagogu përkatës. Në rregullore studenti gjen informacion në lidhje me kriteret e kalimit nga një vit në tjetrin:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 20 kredite të vitit të parë, e vlefshme për ciklin e dytë të programit të studimit. <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë.</i></p>
---	--

	<p><i>Evidencë 2.1: Rregullore e programit të studimit Master i shkencave në "Biologji molekulare".</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Rregullore diplomimi master në nivel departamenti</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Zyra e Sekretarisë Mësimore të FSHN informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Rregullorja e Departamentit të Biologjisë dhe e programit të studimit ka nene specifike për procedurat e transferimit, ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësinë e ndjekjes së programeve të dyta.</p> <p>Në nivel departamenti ngrihet një komision ad-hoc, i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme, shqyrton kërkesën e studentëve për transferimin e krediteve. Kreditet e transferuara të studentëve hyjnë në fuqi me miratimin e Rektoratit..</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë.</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore e programit të studimit Master i shkencave në "Biologji molekulare".</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Rregullore diplomimi master në nivel departamenti</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit janë të specifikuar në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i studentëve mbështetet në vlerësimin semestral/vjetor të punës në auditor, rezultateve të praktikave, laboratorëve, seminareve, detyrave, projekteve etj., por provimi është forma kryesore për kontrollin e dijeve të fituara. Studenti gjen informacion të detajuar edhe në syllabuset e lëndëve, gjithashtu për çdo paqartësi kërkon ndihmë në sekretarinë mësimore ose tek pedagogu përkatës.</p> <p>Syllabusi i çdo lënde të programit të studimit përcakton mënyrën dhe kriteret e vlerësimit të studentëve. Kontrolli i dijeve behet me shkrim, me gojë dhe i kombinuar.</p> <p>Mënyrat e vlerësimit dhe detyrimet i bëhen të ditura studentëve në fillim të procesit mësimor, kurse piket e fituara dhe vlerësimet gjatë vitit i bëhen të njohura para provimit. Në</p>

	<p>takimin me studentët, GVJ konstatoi se studentët ishin të kënaqur me transparencën e vlerësimit dhe kishin të drejtën për rishikimin e tezës së provimit.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë.</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore e programit të studimit Master i shkencave në "Biologji molekulare".</i></p> <p><i>Evidencë 2.5: Programet e lëndëve (Syllabuset) të programit mësues Master i shkencave në "Biologji molekulare"</i></p> <p><i>Evidencë 2.6: Programet e lëndëve Syllabus Msc molekulare</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e departamentit dhe e programit të studimit Msc "Biologji Molekulare" përcakton qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit. Sipas rregullores, studimet e ciklit të dytë Master Shkencor përmbillen me punim/temë diplome.</p> <p>Bazuar në këto rregullore, Departamenti i Biologjisë, si strukturë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi, informon studentët lidhur me kriteret e diplomimit, procedurën e vlerësimit, mundësinë e ankimimit dhe rivlerësimit me qëllim që t'u krijojë atyre kushtet e nevojshme për realizimin me sukses të të gjithë këtij procesi.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin në dispozicion (diploma dhe suplementi i diplomës), GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit, objektivat formuese dhe karakterizuese të tij.</p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë.</i></p> <p><i>Evidencë 2.1: Rregullore e programit të studimit Master i shkencave në "Biologji molekulare".</i></p> <p><i>Evidencë 2.2: Rregullore diplomimi master në nivel departamenti</i></p> <p><i>Evidencë 3.16: Rregullore e shkrimit të diplomave për MSc Biologji Molekulare.</i></p> <p><i>Evidencë 3.17: Rregullore e vlerësimit të Diplomave për MSc Biologji Molekulare.</i></p>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike stafi akademik dhe administrativ i FSHN organizon ditë të hapura (open day) për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe infrastrukturën e institucionit.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI realizon gjurmimin e studentëve dhe luan rol në informimin e tyre për çdo paqartësi edhe gjatë frekuentimit të vitit akademik. Institucioni publikon broshura, fletëpalosje si edhe përditësime në faqen zyrtare web, rrjetet sociale të UT, FSHN me qëllim promovues dhe informues të programeve të studimit.</p> <p><i>Evidencë 5.14: Broshurë: Ditë informimi për maturantët. 2019.</i></p> <p><i>Evidencë 5.16.1: Ditët e informimit të maturantëve online 2022.</i></p> <p><i>Evidencë 5.16.2: Takimet në auditor.</i></p> <p><i>Evidencë 5.19: Guida e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, 22-23.</i></p> <p><i>Evidencë 5.20: Panairi i karrierës.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>-Institucioni vendos në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e vlerësimit të dijeve dhe diplomimit në programin e studimit Master i Shkencave në Biologji Molekulare.</i></p> <p><i>-Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UT/FSHN/DB informojnë publikun dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit duke organizuar ditë të hapura dhe duke publikuar broshura dhe informacione të përditësuara në faqen zyrtare web të universitetit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Studentët që ndjekin programin MSc. Biologji Molekulare informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes zyrës së sekretarisë mësimore, platformës online, takimeve me stafin akademik, faqes zyrtare në rrugë elektronike apo broshurave informuese të publikuara.</p> <p>Kandidatët e interesuar mund të gjejnë fizikisht dosjen e programit të studimit pranë zyrave të shërbimit të studentëve, dosje ku mund të gjejnë informacion mbi objektivat formuese të programit, planet mësimore, syllabuset, rregulloren, suplementin e diplomës etj.</p> <p><i>Evidencë 4.24: Regullore sekretaria mesimore..</i></p> <p><i>Vizita institucionale - Takimi me sekretarine, stafin dhe studentet</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Institucioni disponon dokumentacion për programin e studimit/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese i organizuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Studenti gjen informacion për organizimin dhe shpërndarjen e lëndëve në semestra, kreditet për secilën prej tyre, klasifikimin e lëndëve sipas llojit të veprimtarisë formuese. Studenti merr informacion gjithashtu nga syllabuset çdo fillim semestri si edhe nga faqja zyrtare web e institucionit.</p> <p><i>Evidencë 2.5: Programet e lëndëve (Syllabus-et) të programit mësimor Master i shkencave në "Biologji molekulare"</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Gjatë vizitës institucionale, në takimin me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, GVJ kërkoi informacion për mundësitë e punësimit të studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon Panairin e Punës, në të cilin janë të ftuar të marrin pjesë partnerët.</p> <p>Panairi Vjetor i Punës është tregues kryesor mbi mbështetjen për punësimin e studentëve për arsye të pjesëmarrjes të një numri të</p>

	<p>konsiderueshëm institucionesh/kompani të cilat ofronin mundësi punësimi e praktike për studentët e programit të studimit. Për më tepër, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se Zyra e Karrierës organizon gjatë vitit një numër të konsiderueshëm aktiviteteve me natyrë orientuese e këshilluese të studentëve drejt tregut të punës.</p> <p><i>Evidencë 5.20: Panairi i karrierës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se studentët marrin pjesë edhe në ditët e hapura të organizuara nga institucioni në fillim të çdo viti akademik, ku gjatë vizitave të tyre në ambientet e universitetit informohen në lidhje me zyrat dhe shërbimet e ndryshme që ato ofrojnë.</p> <p>Gjithashtu, GVJ në takimin me studentët konstatoi se studentët ishin të mirë informuar për infrastrukturën, organizimin e programit si syllabuset, oraret mësimore, organizimin e praktikave profesionale dhe orëve të laboratorit. Në shërbim të studentëve janë Biblioteka, Zyra e Këshillimit dhe Sekretaria Mësimore.</p> <p><i>Evidencë 5.14: Broshurë: Ditë informimi për maturantët. 2019.</i> <i>Evidencë 4.15: Infrastruktura e FSHN</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>UT dhe FSHN disponojnë sistemin e menaxhimit online përmes të cilit studentëve u ofrohet informacion në lidhje me programin e studimit. Zyra IT u siguron studentëve një emër përdorimi dhe kod për të pasur akses në listën e tyre të notave, mungesat e tyre si dhe situatën e tyre financiare - email@fshnstudent.info.</p> <p>Informacioni dhe aksesit në platformë është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p> <p><i>Evidencë 5.15: Udhëzues për stafin akademik për platformën TEAMS.</i></p>

Konkluzione	<p>- Institucioni mundëson përfshirjen e studentëve në aktivitete informuese dhe mbështetëse për orientimin dhe promovimin e tyre drejt tregut të punës.</p> <p>- FSHN dhe DB për programin e studimit MSc. në Biologji Molekulare sigurojnë infrastrukturën e nevojshme dhe informacion të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, organizimin e syllabuseve, literaturën e nevojshme, orarin e mësimi, praktikave profesionale dhe orët laboratorike, dhe aktivitetet jashtë kurrikulare.</p> <p>- Institucioni disponon sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>FSHN disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve sipas programit të studimit, të diplomuarit dhe të dhënat e punësimit të tyre.</p> <p>Gjatë vizitës institucionale në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se sekretaria disponon regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e lëshimit të diplomave, regjistrin me të dhënat akademike, të cilat depozitohen në institucion dhe arkivohen në arkivën e shtetit.</p> <p>Studentët e diplomuar për tre vitet e fudnit akademike janë si më poshtë:</p> <p>2021-2022 7 studentë 2022-2023 18 studentë 2023-2024 20 studentë</p>

	<p>Në takimin me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumni si edhe të Drejtorisë së Kurrikulave, GVJ u informua se ata disponojnë informacion të përditësuar çdo vit mbi punësimin e studentëve, emrat e kompanive/institucioneve ku ata janë pozicionuar, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me të diplomuarit dhe Alumni. Këto të dhëna mblidhen, analizohen dhe pasqyrohen në raportet vjetore të këtyre strukturave zyrtare.</p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.27: Raport vjetor 2020-2021 - Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, FSHN.</i></p> <p><i>Evidencë: Alumni Biologji_Punesimi dhe cilesia e stuenteve</i></p> <p><i>Evidencë: Alumni Biologji Mars 2025</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon sistem menaxhimi që mundëson dhe ruan të dhënat e studentëve të regjistruar në programin e studimit, studentët që diplomohen, studentë që ndërpresin përkohësisht ose në mënyrë të përhershme studimet.</p> <p>Ky sistem menaxhohet nga sekretaria mësimore e cila i përdor këto të dhëna për raportime të ndryshme apo analiza statistikore në zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ASCAL-it apo QSHA-së, etj. Numri i studentëve të regjistruar për tre vitet e fundit akademike është si më poshtë:</p> <p>2022-2023 20 studentë; 2023-2024 17 studentë; 2024-2025 16 studentë;</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi gjithashtu se sekretaria disponon dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor, listat e studentëve frekuentues, dokumente të transferimit, regjistrimit në programe të dyta dhe të ç' regjistrimit të tyre.</p> <p><i>Evidencë 5.10: Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët.</i></p>

<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p><i>Evidencë 4.24: Regullore sekretaria mesimore.</i></p> <p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Aksesit në arkivin elektronik është i dedikuar dhe administrohet nga personeli informatik që ka rektorati dhe fakultetet. Kjo platformë përdoret lehtësisht edhe nga sekretaria mesimore, si njësi e autorizuar për hedhjen, verifikimin dhe ruajtjen e të dhënave.</p> <p>Në kuadër të ruajtjes së të dhënave personale, informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahet vetëm për palët e autorizuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe rregulloren e UT. Në vizitën institucionale në sekretarinë mesimore të FSHN, GVJ inspektoi dokumentacionin e arkivuar dhe u informua se sekretaria disponon dokumentacion në dy formate, fizik (kopja në letër) dhe elektronik. Të dhënat e studentëve ruhen në versionin zyrtar dhe skanohen në formatin elektronik.</p> <p><i>Evidencë 4.24: Regullore sekretaria mesimore.</i></p> <p><i>Evidencë 5.34: Personeli akademik i Departamentit të Biologjisë përgjegjës për perditësimin e faqes web të departamentit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mesimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse të FSHN ruajnë dhe administrojnë informacionin mbi të dhënat e studentëve të këtij programi studimi. Informacioni shkresor administrohet në përputhje me rregullat e administrimit dhe arkivimit të informacionit. Informacion mbi të dhënat e studentëve, përveç Sekretarisë Mësimore, disponojnë edhe një sërë strukturash të tjera si departamentet, dekanati etj.</p> <p>Aktet e brendshme të institucionit rregullojnë edhe marëdhëniet hierarkike brenda strukturave, duke përcaktuar kompetenca të vlerësimit dhe kontrollit periodik të informacionit. Nuk konstatohet një praktikë auditimi ku institucioni të kryejë auditime të brendshme për të siguruar përputhshmërinë dhe zbatimin e akteve ligjore dhe akteve të brendshme të njësive përgjegjëse për menaxhimin.</p>

	<p><i>Evidencë 3.8: Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në UT (2014).</i></p> <p><i>Evidencë 5.17: Procesverbal notash (demostrim).</i></p> <p><i>Evidencë 6.18: Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të Universitetit të Tiranës.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Bazuar ne dokumentacion, GVJ gjeti raporte analitike të hartuara nga Departamenti i Biologjisë në cilësinë e njësive bazë. Këto raporte ofrojnë informacion mbi veprimtarinë mësimore, kërkimore/shkencore, financiare, monitorimin e provimeve dhe diplomimit, etj. Sekretaria mësimore harton gjithashtu një raport analitik mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.</p> <p>Pranë Sekretarisë Mësimore administrohen dosjet e studentëve ku pasqyrohet edhe informacion mbi notën mesatare të maturës shtetërore. Bazuar në këto të dhëna, institucioni harton dhe administron statistika që i referohen cilësisë së studentëve në hyrje, në fazën e regjistrimit në këtë program studimi, si dhe në dalje në përfundim të ciklit akademik.</p> <p><i>Evidencë 6.10: Raport për pyetësorin “raport i studentëve” për vlerësimin e programeve të studimit në FSHN - UT</i></p> <p><i>Evidencë 6.26: Raporti vjetor 2019-2020 - Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, FSHN.</i></p> <p><i>Evidencë 6.27: Raport vjetor 2020-2021 - Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, FSHN.</i></p> <p><i>Evidencë: Alumni Biologji _Punesimi dhe cilesia e stuenteve</i></p> <p><i>Vizita institucionale</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>– <i>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</i></p> <p>– <i>Njësia bazë dhe strukturat në shërbim të studentëve hartojnë raporte analitike vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre,</i></p>

	<i>shoqëruar me masat e ndërmarra për përmirësimin e këtyre treguesve konkretë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015, neni 54, 55, Statutin e UT dhe rregulloren e FSHN, institucioni garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se ka 4 përfaqësues të studentëve në Senatin Akademik të UT, Komisioni KVMMS ka tre student anëtarë, Komisioni i përhershëm për sigurimin e standarteve të cilësisë ka 3 studentë anëtarë, Komisioni i Kurrikulës ka 2 student në përbërje.</p> <p>Gjithashtu studentët janë organizuar në Këshilla Studentorë në nivel universiteti dhe fakulteti, të cilat funksionojnë edhe si tutoriat studentor. Këshillat studentore e bazojnë aktivitetin e tyre në Statutin dhe rregulloren e Këshillit Studentor. Studentët janë pjesëmarrës në hartimin e RVB, gjë që u konstatua jo vetëm nga përbërja e komisionit në dokumentacion, por edhe në takimin me përfaqësues të GVB në vizitën institucionale.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 5.12: Vendim Nr. 17 i Komisionit Institucional Zgjedhor Studentor datë 13.12.2021 "Mbi caktimin e ditës për hedhjes e shortit për të zgjedhur anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit (KQV).</i></p>

	<p><i>Evidencë 5.13: Anëtarët e grupeve të vlerësimit të brendshëm (GVB), FSHN.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në zgjedhjet për organet dhe autoritet drejtuese, si Senati Akademik, NJSBC, Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor, etj.</p> <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se studentët plotësojnë çdo vit akademik pyetësorët duke dhënë vlerësimin e tyre mbi procesin akademik.</p> <p>Ata konfirmuan gjithashtu se marrin pjesë aktive në aktivitete promovionale dhe projekte studimore në bashkëpunim me pedagogët e tyre, gjë që është lehtësisht e verifikueshme në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.10: Raport për pyetësorin "raport i studentëve" për vlerësimin e programeve të studimit në FSHN - UT.</i></p> <p><i>Evidencë 17: Përbërja e këshillit studentor</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>FSHN përdor një sërë mekanizmash për përfshirjen e studentëve në përmirësimin e programit të studimit. Këshilli studentor është organi ku studentët diskutojnë problematikat në procesin e mësimdhënies dhe kanë të drejtën e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit bazuar edhe në rregulloren me të cilën funksionon këshilli. Studentët shprehin opinionin e tyre në lidhje me kurrikulën dhe programin mësimor edhe nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar prej tyre.</p> <p>Gjatë takimit me studentët, ata vlerësuan se programi përmbush pritshmërinë e tyre dhe i përgatit për tregun e punës, gjithashtu vlerësuan raportin teori/praktike dhe cilësinë e mësimdhënies. Institucioni në bashkëpunim me këshillat studentore kontribuon në përmirësimin e jetës profesionale dhe sociale të studentëve nëpërmjet mbështetjes me kapacitete akademike dhe bursa financimi të ndryshme në funksion të punës kërkimore shkencore.</p>

	<p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.7: Raporti i vlerësimit të lëndëve nga studentët, për semestrin e parë, viti akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Evidencë 6.8: Raporti i vlerësimit të lëndëve nga studentët, për semestrin e dytë, viti akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Evidencë 6.9: Raport mbi pyetëtorin “Vlerësim i studentëve që diplomohen” Fakulteti i Shkencave të Natyrës Universiteti i Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.10: Raport për pyetëtorin “raport i studentëve” për vlerësimin e programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.</i></p> <p><i>Vizita institucionale, takimi me studentet</i></p> <p><i>Evidencë 10: Angazhim i studenteve ne kontributin e permiresimit te program studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloren e FSHN dhe të Departamentit të Biologjisë përcaktohet qartë procedura e ankimimit të studentit për rezultatin e provimit. Kur student i ka kryer ankimim për vlerësimin, i drejton kërkesë me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve i cili bën verifikimet e duhura së bashku me komisionin e provimit dhe njofton studentin për vendimin e marrë.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.7: Rregullore e Departamentit të Biologjisë.</i></p> <p><i>Evidencë 5.10: Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>- Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e UT dhe Rregulloren e UT, institucioni garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese.</p> <p>- Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në zgjedhjet për organet dhe autoritet drejtuese, si: Senati Akademik, NJSBC, Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor, etj., si edhe përmes vlerësimit të opinionit të tyre në lidhje me</p>

	<p><i>kurrikulën, cilësinë e mësimdhënies, raportit teori/praktikë dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore dhe promovionale.</i></p> <p><i>- GVJ evidentoi se FSHN përdor një sërë mekanizmash për përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>- Në rregulloren e UT dhe të Departamentit përcaktohet qartë procedura e ankimimit të studentit për rezultatin e provimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni disponon procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatorë të institucionit.</p> <p>Në shërbim të informimit të studentëve janë Sekretaria Mësimore, Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, Zyra e IT, etj.</p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), FSHN-UT.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve është funksional dhe bazohet në misionin dhe detyrimet e strukturave përgjegjëse të përmendura në kriterin 1. Këto struktura mbështesin dhe informojnë studentët në lidhje me aktivitetin akademik, karrierën që do të ndjekin, licencimin dhe akreditimin e programeve, etj. Në takimin me studentët, ata u shprehen të kënaqur lidhur me disponibilitetin e këtyre strukturave për informim dhe shërbime.</p>

	<i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), FSHN - UT.</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në institucion funksionon Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), e cila informon dhe mbështet studentët për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Ky sektor gjithashtu organizon dhe koordinon aktivitete shkencore si trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar, promovon aftësitë dhe prijet e studentëve në fusha të tjera si letërsi, art, etj. <i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor 2023-2024 DSBCK.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në takimin me përfaqësues të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), GVJ verifikoi se kjo njësi disponon të dhëna për të diplomuarit mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit, ndjek integrimin e tyre në tregun e punës dhe mban kontakte me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të email-it me qëllim bashkëpunimin midis tyre. Zyra harton raporte statistikore mbi studentët e punësuar dhe i vendos në dispozicion të organeve e autoriteteve drejtuese. <i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor 2023-2024 DSBCK.</i> <i>Evidencë: Alumni Biologji_Punesimi dhe cilesia e stuenteve</i>
Konkluzione	- FSHN disponon procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatorë të institucionit. Në funksion të informimit janë Sekretaria Mësimore, Zyra e IT, Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). - Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) realizon informimin e studentëve dhe shërbime të tjera nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tyre. Ajo mban kontakte me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre

	<p><i>personale të email-it dhe disponon databasë për të diplomuarit mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të cilat përditësohen vazhdimisht duke hartuar njëkohësisht edhe raporte statistikore.</i></p> <p><i>- Informacioni i Alumnit i vihet në dispozicion departamentit përkatës me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1


Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstaton që institucioni nuk ka vënë në dispozicion në nivel institucional një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>Gjithsesi, për arritjen e këtyre objektivave dhe në kuadër të strategjisë për ndërkombëtarizimin është bërë i mundur mobiliteti i stafit në universitete prestigjioze për të përfituar përvoja akademike ndërkombëtare dhe për të implementuar metoda inovatore të mësimdhënies dhe të të nxënit me në qendër studentin.</p> <p><i>Rekomandohet hartimi dhe vënia në dispozicion e udhëzuesve mbi metodat inovative të mësimdhënies, të përshtatura me programet e studimit të ofruara.</i></p> <p><i>Evidencë 18.1: Liste mobilitetesh per stafin akademik</i></p>

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>UT ka miratuar dhe ka funksional struktura të sigurimit të cilësisë, të cilat janë përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin në mënyrë periodike të programeve të studimit, duke vlerësuar performancën në mësimdhënie dhe inovacion si të personelit akademik ashtu edhe atij ndihmës akademik.</p> <p>Këto struktura përgjegjëse përfshijnë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisionin e Kurrikulës, dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) dhe Departamentet përkatëse në Fakultet.</p> <p><i>Evidencë 6.15: Model i kërkesës për performancën e punës të stafit akademik.</i></p> <p><i>Evidencë 6.16: Vendim i Rektoratit, Nr. 3, Për miratimin në parim të rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT".</i></p> <p><i>Evidencë 6.17: Vendim i Senatit Akademik Nr. 30: "Miratimi i manualit të vlerësimit të performancës të personelit akademik".</i></p> <p><i>Evidencë 6.18: Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.19: Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu, semestri i parë, viti akademik 2020-2021, fq. 3-36.</i></p> <p><i>Evidencë 6.20: Manuali i cilësisë i Universitetit të Tiranës.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Statuti i UT sanksionon të drejtën e studentëve për të qënë pjesë e strukturave përgjegjëse për sigurimin dhe standardet e cilësisë, por edhe të komisioneve të tjera në nivel institucional, njësie bazë. Studentët përfshihen në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. Gjithashtu, institucioni gjurmon pakënaqësitë ose kërkesat e ndryshme të studentëve nëpërmjet zhvillimit online/onsite të peticioneve/ankimimeve të tyre me natyrë akademike dhe administrative. Në këtë mënyrë, studentët japin kontributin e tyre në zhvillimin institucional dhe sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.7: Raporti i vlerësimit të lëndëve nga studentët, për semestrin e parë, viti akademik 2020-2021.</i></p>

	<p><i>Evidencë 6.8: Raporti i vlerësimit të lëndëve nga studentët, për semestrin e dytë, viti akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Evidencë 6.9: Raport mbi pyetëtorin "Vlerësim i studentëve që diplomohen" FSHN - UT, viti akademik 2020-2021, fq. 11-19.</i></p> <p><i>Evidencë 6.10: Raport për pyetëtorin "raport i studentëve" për vlerësimin e programeve të studimit në FSHN – UT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Institucioni dhe njësitë bazë të tij hartojnë raporte dhe analiza vjetore për vlerësimin e veprimtarisë dhe performancës akademike në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë e sanksionuar në nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 80/2015: "Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë". Vlerësimi i performancës së stafit akademik përfshin mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe aktivitetin administrativ apo mbështetës. Detyrimet akademike dhe aktivitetet e parashikuara në planin vjetor të punës deklarohen nga stafi nëpërmjet një formulari standard të vlerësimit, i cili dorëzohet tek drejtuesi i Departamenti Biologji si njësi bazë.</p> <p>Gjithashtu, siç u theksua edhe me lart, (DSBCK) bën publike rezultatet e pyetësorëve të studentëve duke adresuar sugjerimet në mbështetje të rritjes së cilësisë e standardeve të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë 6.11: Statistika në nivel lëndësh për programet e studimit, semestri parë, viti akademik 2020-2021, fq. 4-17.</i></p> <p><i>Evidencë 6.12: Statistika në nivel programi studimi për lëndët nga studentët, semestri parë, viti akademik 2020-2021, fq. 6-26.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni përdor instrumente dhe mekanizma të brendshëm për vlerësimin e stafit akademik, të cilat kanë për qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe promovimin e praktikave më të mira. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi disa instrumente për vlerësimin e stafit akademik siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ <i>pyetësorët e plotësuar nga studentët apo analizat statistikore nga DSBCK dhe FSHN,</i> ❖ <i>raporti vjetor në nivel fakulteti dhe departamenti që vlerëson veprimtarinë mësimore, aktivitetin botues dhe kërkimor-shkencor të stafit akademik si edhe</i>

	<p>❖ <i>raport vlerësimi i performancës individuale me komentet dhe sugjerimet që i përcillen Rektoratit nga përgjegjësi i departamentit të çdo njësie bazë.</i></p> <p>Në këto raporte janë promovuar shembuj të praktikave të mira dhe janë evidentuar adresimi i problematikave dhe janë përcaktuar objektivat për përmirësimin e këtyre problematikave.</p> <p><i>Evidencë 6.4: Shembull analize e Departamentit të Biologjisë: Mbi realizimin e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore gjatë vitit akademik 2018-2019.6.14</i></p> <p><i>Evidencë 6.13: Përcillen nga Dekani, Nr. 1841/1 prot.: raportet e pyetësorëve të zhvilluar për vitin akademik 2020-2021.</i></p> <p><i>Evidencë 6.14: Plani i masave (përgjigjja e shkresës së Dekanit, evidenca 6.13).</i></p>		
Konkluzione	<p>– <i>Institucioni nuk ka hartuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</i></p> <p>– <i>Institucioni ka miratuar dhe ka funksionale, struktura të sigurimit të cilësisë, të cilat janë përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin në mënyrë periodike të programeve të studimit. Kjo njësi, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore zhvillon pyetësorët e studentëve për matjen e performancës dhe cilësisë në mësimdhënie.</i></p> <p>– <i>Institucioni përdor instrumentë dhe mekanizma të brendshëm për vlerësimin e stafit akademik. GVJ gjeti raporte që promovojnë shembuj të praktikave të mira, adresim të problematikave dhe përcaktim të objektivave për përmirësimin e problematikave.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon hartimin dhe vënien në dispozicion të udhëzuesve mbi metodat inovative të mësimdhënies, të përshtatura me programet e studimit të ofruara.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë, UT dhe FSHN kanë ndërtuar politika dhe procedura si edhe kanë ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e UT. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ gjeti evidence të formatit të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë se mësimdhënies dhe shërbimeve administrative, formatin për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe administrativ. Gjithashtu në RVB theksohet roli i komisioneve të ngritura në nivel institucional për veprimtari të ndryshme në shërbim të institucionit, si: Këshilli i Etikës, Komisioni i Përhershëm i Promovimit të Personelit Akademik - KPPA, Njësia Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës për FSHN, etj.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 3.5: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT (miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020).</i></p> <p><i>Evidencë 3.7: Paketa e instrumenteve të cilësisë (miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020).</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), FSHN - UT</i></p> <p><i>Evidencë 6.21: Vendim i Senatit Akademik, Nr. 51: "Për miratimin e paketës së instrumentave për sigurimin e cilësisë në UT".</i></p> <p><i>Evidencë 6.22: Paketa e instrumenteve të cilësisë i UT.</i></p> <p><i>Evidencë 6.23: Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të</p>	<p>UT ka ngritur Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Kjo degë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur me vendim senati dhe është organ</p>

<p>Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>kolegjial. Ajo e bazon aktivitetin e saj në legjislacionin në fuqi, në Standardet Shtetërore të Cilësisë, Statutin dhe Rregulloren e UT, Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, vendimet e senatit, urdhrat e brendshëm dhe kodin e cilësisë miratuar me VKM. DSBCK ka përbushur detyrimin ligjor për të hartuar një raport vjetor për veprimtarinë e saj. Ajo funksionon si një strukturë e pavarur dhe e përhershme pranë institucionit dhe ushtron një sërë aktivitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bën mbledhjen e të dhënave sipas treguesve sasiorë dhe cilësorë për institucionin dhe programet e studimit. - Organizon vlerësimin periodik në të gjitha fushat apo specifike të sigurimit të cilësisë. - Krijon një sistem dokumentacioni për sigurimin e cilësisë dhe përditëson procedurat e ndryshme për sigurimin e cilësisë. - Realizon vlerësimin për stafin akademik me anë të anketimeve dhe pyetësorëve të studentëve, merr në konsideratë vlerësimin për performancën e stafit në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor, mbështetjen administrative. - Kryen analizën e pyetësorëve institucionale. - Bashkërendon dhe asiston procesin e vlerësimit të brendshëm në të gjitha nivelet, etj. <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), FSHN - UT.</i></p> <p><i>Evidencë 1.4: Vendim i Senatit Akademik, Nr. 15. Datë 21.06.2018, propozim i planit strategjik të zhvillimit të Universitetit e Tiranës .</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si</p>	<p>GVI, bazuar në dokumentacion dhe në takimin me përfaqësues të DSBCK, evidentoi se institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë, si: sondazhet dhe pyetësorët me studentët, vlerësimin e performancës së personelit akademik, takime/trajnime me ekspertë të fushës, vëzhgime të procesit mësimor dhe monitorimit të provimeve, etj.</p> <p>Vetëvlerësimi apo vlerësimi i jashtëm institucional i UT, por edhe Fakulteteve përkatës, kanë qënë dhe janë gjithashtu procese të rëndësishme që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë dhe mekanizmave të sigurimit të saj brenda institucionit.</p>

<p>dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p><i>Evidencë 3.3: Raport Vjetor per vleresimin e programeve te studimit 2021-22.</i></p> <p><i>Evidencë 3.4: Raporti vjetor per vleresimin e cilesise se programeve te studimit ne FSHN</i></p> <p><i>Evidencë 5.11 Raporti Vjetor 2023-2024 DSBCK</i></p> <p><i>Evidencë 6.10 Raport për pyetësorin “raport i studentëve” për vlerësimin e programeve të studimit në FSHN – UT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>FSHN përdor tregues të qartë, të matshëm në vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nëpërmjet plotësimit të formularit të performancës së stafit akademik dhe administrativ.</p> <p>Ky vlerësim bëhet nga përgjegjësit e departamenteve dhe përfshijnë vlerësimin për veprimtarinë akademike për çdo pedagog, vlerësimin e aktivitetit shkencor të stafit akademik nëpërmjet evidentimit të artikujve të botuar dhe prezantimeve orale kombëtare dhe ndërkombëtare, vlerësimin e aktivitetit administrativ të tyre, korrektësinë në kryerjen e dhe realizimin e shërbimeve ndaj studentëve, respektimin e afateve kohore të këtyre aktiviteteve dhe të rregullores së fakultetit.</p> <p><i>Evidencë 6.17: Vendim i Senatit Akademik Nr. 30.: “Miratimi i manualit të vlerësimit të performancës të personelit akademik”.</i></p> <p><i>Evidencë 6.18: Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.19: Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu, semestri i parë, viti akademik 2020-2021, fq. 3-36.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>- Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë, UT ka ndërtuar politika dhe procedura si edhe ka ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e UT.</p> <p>- Njësia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë është ngritur me vendim senati dhe funksionon si një strukturë e pavarur dhe e përhershme pranë institucionit duke ushtruar një sërë aktivitete bazuar në rregulloren e NJSBC.</p>

	<i>- Institucioni përdor në mënyrë të vazhdueshme tregues të qartë, të matshëm për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe administrativ.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të akreditimit të programit të studimit të ciklit të dytë, FSHN monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike ecurinë e programit duke përdorur mekanizma e procese të dokumentuara. Gjatë takimit me drejtues të institucionit dhe përfaqësues të DSBCK, GVJ konstatoi se FSHN përdor disa mekanizma për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorime të procesit mësimor nga përgjegjësit e departamenteve, të cilët në analizën vjetore evidentojnë arritjet, dobësitë dhe planin e masave për përmirësim. - Monitorime nga DSBCK në nivel institucional. - Realizim sondazhesh dhe mbledhje informacioni nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. - Vlerësime dhe monitorime nga komisione ad/hoc të ngritur nga dekani si Njësia e Sigurimit të Cilësisë për FSHN. <p><i>Evidencë 3.3.1: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, viti akademik 2022-2023.</i></p> <p><i>Evidencë 3.4: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, viti akademik 2023-2024.</i></p> <p><i>Evidencë 4.12: Njoftim mbi ngritjen e njesise se sigurise se brendeshme te cilesise kurikulave FSHN (05.10.2022)</i></p> <p><i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor 2023-2024 DSBCK.</i></p>

	<i>Evidencë 6.25: Për miratimin e komisionit të përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë të Universitetit të Tiranës.</i>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>FSHN, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore që është një përmbledhje e analizës së çdo departamenti dhe përfshin veprimtarinë akademike me rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, arritjet më të mira, mangësitë e mundshme dhe masat e marra për adresimin e tyre.</p> <p>DSBCK si strukturë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e programit të studimit me standardet shtetërore të cilësisë për programet e ofruara dhe për institucionin. Bazuar në rezultatet e vlerësimit, DSBCK ka hartuar planin e masave për rritjen e cilësisë me strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 3.4: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, viti akademik 2023-2024.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>FSHN ka përdorur një sërë mekanizmesh dhe metoda të drejtpërdrejta në kuadër të vlerësimit, realizimit dhe mbarëvajtjes të cilësisë së programit të studimit, si: përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies, procesi i vetëvlerësimit si një strategji për reflektim dhe përmirësim, iniciativa për rishikim të kurrikulave me qëllim përmirësimin e programit të studimit, procedura për monitorimin e dokumentacionit dhe sezonit të provimeve në kuadër të transparencës së vlerësimit për të identifikuar dhe minimizuar paragjykimet e mundshme gjatë këtij procesi.</p> <p><i>Evidencë 6.10: Raport për pyetëtorin “raport i studentëve” për vlerësimin e programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, viti akademik 2020-2021, fq.11-17.</i></p>


<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni ka përdorur një numër instrumentash për të vlerësuar realizimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>GVJ e evidentoi këtë vlerësim nëpërmjet informacionit të përpunuar nga Zyra e Degës së Këshillimit të Karrierës si edhe rezultatet e pyetësorëve të studentëve. Kjo zyrë bën gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi e evidentohen pozicionet e punësimit dhe kualifikimeve.</p> <p>Njëkohësisht institucioni analizon rezultatet e pyetësorëve të studentëve me qëllim përmirësimin në vazhdimësi. Konstatohet që studentët gjithashtu plotësojnë një anketë dalëse pas diplomimit ose ndërprerjes së studimeve me qëllim përfshirjen e tyre në vlerësimin e stafit dhe përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p><i>Evidencë 6.9: Raport mbi pyetësorin “Vlerësim i studentëve që diplomohen” Fakulteti i Shkencave të Natyrës Universiteti i Tiranës, viti akademik 2020-2021, fq. 11-19.</i></p> <p><i>Evidencë 6.10: Raport për pyetësorin “raport i studentëve” për vlerësimin e programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, viti akademik 2020-2021, fq.11-17.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>- FSHN përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Disa nga instrumentet e përdorur janë vlerësimi i performancës së stafit akademik dhe ndihmës/akademik, pyetësorët e studentëve për vlerësimin e programeve dhe cilësisë në mësimdhënie, raporte dhe analiza vjetore në nivel departamenti dhe fakulteti, monitorime nga DSBCK në nivel institucional.</p> <p>- Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit analizon në raportet vjetore rezultatet e procesit të anketimit të studentëve me qëllim përmirësimin e programeve të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Ne statutin dhe rregulloren e UT përshkruhet qartë përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Përfaqësimi i studentëve e bën efektive kontributin real të studentëve në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1.1: Statuti i Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidence 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), FSHN - UT.</i></p> <p><i>Evidenca 10: Angazhim i studenteve ne kontributin e përmirësimit te program studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e UT, por edhe të FSHN janë përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Disa nga aspektet që garantojnë sigurimin e cilësisë dhe ushtrimin e përgjegjësisë së aktorëve të përfshirë në këtë proces lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none">-Hartimin dhe përditësimin e një programi cilësor të përshtatshëm me kërkesat e tregut të punës.-Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës në funksion të cilësisë se programit të studimit.-Vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.-Përcaktimin e procedurave të përshtatshme për monitorimin e cilësisë, vlerësimin e brendshëm në departamente, zbatimin e detyrave nga auditit i jashtëm dhe hartimin e planit të masave.

	<p>GVJ, gjatë takimit me përfaqësues dhe drejtues të veprimtarisë akademike në institucion, si Dekani FSHN, Drejtuesi i Departamentit të Biologjisë, përfaqësues të stafit akademik, studentë, anëtarë të grupit të vetëvlerësimit, përfaqësues të DSBCK, konstatoi se të gjithë këta aktorë kanë ushtruar me përgjegjësi detyrat e tyre duke bashkëpunuar dhe u koordinuar konform rregullave për të realizuar në mënyrë korrekte procesin e akreditimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Nga ana tjetër studentët referuan se janë të përfshirë përmes pyetësorëve si edhe përfaqësuesve të tyre në këshillin studentor, për adresimin e problematikave dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm duke dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e programit të studimit dhe sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 1.6: Rregullore e Universitetit të Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), FSHN - UT.</i></p> <p><i>Evidenca 10: Angazhim i studenteve në kontributin e përmirësimit të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>DSBCK funksionon në nivel institucioni dhe ndjek një politikë të transparencës në lidhje me proceset e ndryshme të cilësisë duke rritur seriozitetin, besimin dhe përgjegjshmërinë e gjithësecilit në mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>DSBCK koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit me të gjitha njësitë bazë të institucionit. Në zbatim të rregullores, njësia bazë garanton përfshirjen e të gjitha strukturave përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentëve.</p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), FSHN - UT.</i></p> <p><i>Evidencë 6.26: Raporti vjetor 2019-2020 - Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, FSHN.</i></p> <p><i>Evidencë 6.27: Raport vjetor 2020-2021 - Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, FSHN.</i></p>

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Procesi ciklik i vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës i cili është hartuar nga UT në zbatim të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe realizohet në bashkëpunim mes KPSSC dhe DSBCCK. Anëtarët e komisioneve të lartpërmendura përbëhen nga anëtarë të stafit akademik me eksperiencë dhe integritet, të cilëve u respektohet liria, etika akademike dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>GVJ konstatoi se pyetësi i vlerësimit të programit të studimit është plotësuar duke respektuar anonimitetin dhe nuk janë referuar ankesa nga stafi/studentët për pabarazi/diskriminim.</p> <p><i>Evidencë 3.13: Kodi i etikës i UT (miratuar 2011).</i></p> <p><i>Evidencë 6.3: Vendim i Senatit Akademik, Nr. 43.: Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme Institucionale dhe të Këshillit të Etikës në Universitetin e Tiranës.</i></p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), FSHN - UT.</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni ka përfshirë edhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Institucioni, për të rritur sigurimin e brendshëm të cilësisë, përdor komentet/sugjerimet/vërejtjet si nga studentët ashtu edhe nga personeli akademik por edhe reagime nga burime të jashtme si komunitetet profesionale, në të cilat janë punësuar të diplomuarit e UT në funksion të përmirësimit të programit të studimit dhe lidhjes me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidencë 6.1: Rregullore e Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), FSHN - UT.</i></p> <p><i>Evidencë 6.11: Alumni Biologji_Punesimi dhe cilesia e stuateve</i></p>

Konkluzione	<p>- Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UT, është ngritur dhe funksion Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës. Gjithë përfshirja, veçanërisht përfaqësimi i studentëve në këtë strukturë e bën efektive kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>- DSBCK koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit me të gjitha njësitë bazë të institucionit.</p> <p>- Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>- Në procesin e vlerësimit dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, institucioni ka përfshirë edhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit të cilët ofrojnë ekspertizën e tyre në lidhje me përmirësimin e programit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe janë bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UT www.unitir.edu.al.</p> <p>Gjithashtu, statuti i UT, rregulloret, raportet vjetore, vendimet e organeve kolegjiale, raportimet periodike të rektoratit që lidhen me procesin mësimor dhe sigurimit të cilësisë së mësimdhënies, janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Evidencë: https://unitir.edu.al/</p> <p>Evidencë: https://www.fshn.edu.al/</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>DSBCK realizon pyetësorët e studentëve dhe publikon rezultatet e tyre në kuadër të transparencës dhe duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale (ligji 9887/10.03.2008).</p> <p>Gjithashtu, FSHN bën publike në faqen zyrtare të fakultetit (www.fshn.edu.al) rezultatet e vlerësimit të programit të studimit. Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm dhe adreson gjetjet apo rekomandimet e lëna në raportet repsektive.</p> <p><i>Evidencë: https://www.fshn.edu.al/</i> <i>Evidencë 5.11: Raporti Vjetor 2023-2024 DSBCK.</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>FSHN harton planin e masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna të cilat pasqyrohen në raportet vjetore. Gjithashtu, në kuadër të procesit të akreditimit institucional, rezultatet e këtij vlerësimi të brendshëm u raportohen rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve të cilëve u lihet për detyrë përmbushja e rekomandimeve të dala nga ky proces.</p> <p><i>Evidencë 3.3: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, viti akademik 2021 - 2022.</i> <i>Evidencë 3.3.1: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, viti akademik 2022 - 2023.</i> <i>Evidencë 3.4: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, viti akademik 2023 - 2024.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se raportet vjetore shoqërohen me plane masash ose adresim problematikash të cilat synojnë përmirësimin e mangësive të identifikuara me impakt rritjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 3.3: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, viti akademik 2021 - 2022.</i> <i>Evidencë 3.3.1: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, viti akademik 2022 - 2023.</i> <i>Evidencë 3.4: Raport Vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit në FSHN, viti akademik 2023 - 2024.</i> <i>Evidencë 6.14: Plani i masave (përgjigjja e shkresës së Dekanit, evidenca 6.13).</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me përfaqësues të DSBCK dhe studentët, GVJ u informua se institucioni organizon aktivitete periodike me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kjo reflektohet edhe në dokumentacionin e vendosur në dispozicion të GVJ ku jepen të dhëna për një sërë aktivitete të zyrës së karrierës dhe këshillit studentor. Gjithashtu, DSBCK vazhdimisht organizon takime me strukturat e fakultetit për të rritur efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin e mëtejshëm.</p> <p><i>Evidencë 6.29: Vendim i Senatit Akademik, Nr. 26, datë 21.10.2020: "Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore të Universitetit të Tiranës".</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe janë bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UT dhe FSHN.</i> - <i>Në kuadër të procesit të akreditimit institucional, rezultatet e këtij vlerësimi të brendshëm u raportohen rektoratit dhe dekanëve të fakulteteve të cilëve u lihet për detyrë përbushja e rekomandimeve të dala nga ky proces.</i> - <i>Raportet vjetore të FSHN shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të mundshme të evidentuara.</i> - <i>Institucioni organizon aktivitete periodike me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i> 			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Biologji Molekulare” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës.”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. UT dhe FSHN përfaqësojnë institucione të mirëkonsoliduara, të cilat prej dekadash operojnë në fushën e arsimit të lartë në Shqipëri. Stafit akademik, me përvojë të gjerë dhe kualifikime të larta profesionale e shkencore, kontribuon në zhvillimin e veprimtarive akademike të orientuara drejt nevojave reale dhe aplikimit praktik të dijeve në formimin e brezave të rinj të specialistëve në shkencat humane; **(Standarti I.2, Kriteri 1)**
2. UT dhe FSHN mbështesin zhvillimin profesional të stafit akademik përmes organizimit të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe duke ofruar mbështetje financiare për aktivitete kërkimore shkencore dhe trajnuese; **(Standarti II.6, Kriteri 2.3.4)**
3. Institucioni disponon një personel efektiv të mjaftueshëm dhe me kualifikimet e duhura, duke përmbushur tërësisht standardet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas të cilave personeli akademik efektiv (PAE) duhet të përbëjë 70% të stafit total në raport me personelin e angazhuar me kontratë (PAK); **(Standarti IV.1, Kriteri 1)**
4. Bashkëpunimet me një gamë të gjerë institucionesh arsimore dhe shkencore e diagnostike, brenda dhe jashtë vendit, krijojnë mundësi për shkëmbime institucionale që kontribuojnë në zhvillimin e vazhdueshëm të programit të studimit; **(Standarti IV.1, Kriteri 7)**
5. Institucioni siguron qëndrueshmëri financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij, duke u mbështetur në të ardhurat e gjeneruara nga tarifat e shkollimit, tarifa e regjistrimit, mbështetja nga buxheti i shtetit, si edhe nga grante dhe projekte të ndryshme; **(Standarti IV.5, Kriteri 5);**
6. Çdo vit akademik institucioni harton dhe zbaton procedura specifike për mbështetjen e studentëve përmes bursave dhe ndihmës financiare, me fokus të veçantë tek studentët ekselentë dhe ata që i përkasin shtresave në nevojë; **(Standarti V.1, Kriteri 8)**

b. Pika të dobëta:

1. Konstatohet që veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen jo në përputhje me “VKM Nr. 41. Datë 24.01.2018”, e ndryshuar, lidhur me ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave”, por është ndjekur organizimi i lëndëve i ndarë për Veprimtaritë Formuese që i përket atij të ciklit të parë të programeve të studimit në “Bachelor”; **(Standarti II.1, Kriteri 1)**
2. Konstatohet që programi i studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, në planin mësimor të tij nuk e ka përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës

profesionale, në përputhshmëri me “VKM Nr. 41, datë 21.01.2028”, e ndryshuar me 10% të krediteve; (Standarti II.1, Kriteri 3)

3. Konstatohet mungesa e koordinatorit të programit të studimit, ic cili do të ishte përgjegjës për ecurinë, zhvillimin dhe praktikën profesionale të programit të studimit, në përputhje me objektivat e tij; (Standarti II.2, Kriteri 3)
4. Konstatohet se në një numër të konsiderueshëm lëndësh, literatura bazë e detyrueshme është më shumë se 5 edhe 10 vjeçare, shumë lëndë kanë vetëm një tekst si literaturë bazë, si dhe nuk janë përditësuar syllabuset me literaturë bazë të detyrueshme e të rekomanduar, duke përfshirë tekste në gjuhën angleze dhe shqipe të botuara nga shtëpi botuese prestigjioze dhe të datuara brenda pesë viteve të fundit; (Standarti II.4, Kriteri 5); (Standarti IV.3, Kriteri 2)

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes të lëndëve-moduleve sipas kategorive përkatëse në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar në “VKM Nr. 41. Datë 24.01.2018, e ndryshuar”, si edhe në planin mësimor të programit të studimit duhet që “Lëndët me zgjedhje” që ofrohen, të pozicionohen në Kategorinë C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese; (Standarti II.1, Kriteri 1)
2. GVJ rekomandon që në planin mësimor të Programit të studimit Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”, të përcaktohet ngarkesa në kredite për realizimin e “Praktikës Profesionale”, në kategorinë përkatëse D (Lëndë plotësuese), në përputhshmëri me aktet ligjore; (Standarti II.1, Kriteri 3)
3. GVJ rekomandon emërimin e koordinatorit për programin e studimit, i cili do të përfaqësojë personin përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit e praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e përcaktuara; (Standarti II.2, Kriteri 3)
4. GVJ rekomandon, që programi të përfshijë të paktën dy tekste të përditësuar si literaturë bazë dhe të detyrueshme për lëndët e tij, me qëllim sigurimin e kompetencave të nevojshme shkencore për ciklin e dytë të studimeve; (Standarti II.4, Kriteri 5); Literatura duhet të citohet korrektësisht dhe të paraqitet si referencë bibliografike. Gjithashtu, institucioni të pasurojë fondin fizik dhe online të bibliotekës, për të garantuar përputhshmërinë e programit me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e ciklit të dytë të studimeve; (Standarti IV.3, Kriteri 2)
5. Të krijohet “Bordi i Tregut të Punës”, ose një strukturë e ngjashme, e cila do të kontribuojë në këshillimin e karrierës së studentëve dhe në hartimin e propozimeve për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës; (Standarti II.5, Kriteri 1)

6. Institucioni të hartojë një udhëzues të unifikuar për veprimtaritë akademike formuese dhe për procesin e vlerësimit, duke përfshirë të gjitha komponentët e nevojshëm. Aktualisht mungon një format i unifikuar vlerësimi mes lëndëve të ndryshme dhe "Provimi i Ndërmjetëm" nuk zhvillohet në mënyrë të rregullt (*aplikohet vetëm në katër lëndë*). Udhëzuesi duhet të sigurojë kontroll të vazhdueshëm të njohurive dhe t'u mundësojë studentëve identifikimin dhe përmirësimin e mangësive përpara përfundimit të semestrit; **(Standarti III.1, Kriteri 1); (Standarti III.2, Kriteri 3)**
7. Të implementohet një sistem elektronik për kontrollin e dijeve, me synim rritjen e transparencës dhe minimizimin e abuzimeve gjatë procesit të vlerësimit; **(Standarti III.3, Kriteri 2)**. Gjithashtu, institucioni të vërë në dispozicion një platformë të licencuar për kontrollin e plagjiaturës, të aksesueshme nga stafi akademik dhe studentët; **(Standarti III.3, Kriteri 5)**
8. Institucioni të përgatisë udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, në përputhje me programin e studimit; **(Standarti VI.1, Kriteri 1)**
9. GVJ rekomandon caktimin e Përgjegjës të grup-lëndëve, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, si një mekanizëm i domosdoshëm për garantimin e organizimit akademik, cilësisë së programeve dhe zbatimit të standardeve të MAS, gjithashtu këto pozicione do të luajë një rol pozitiv duke ndihmuar në koordinimin efektiv ndërmjet personelit efektiv dhe atij me kontratë; **(Standarti I.3, Kriteri 1)**

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Molecular Biology" offered by the Higher Education Institution "University of Tirana."

a. Strengths and affirmations:

1. UT and FNS represent well-consolidated institutions, which have been operating in the field of higher education in Albania for decades. The academic staff, with extensive experience and high professional and scientific qualifications, contributes to the development of academic activities oriented towards real needs and the practical application of knowledge in the formation of new generations of specialists in the humanities; **(Standard I.2, Criterion 1)**

2. UT and FNS support the professional development of academic staff through the organization of national and international conferences, as well as by providing financial support for scientific research and training activities; **(Standard II.6, Criterion 2.3.4)**
3. The institution has a sufficient effective and qualified staff, fully meeting the standards of the Ministry of Education and Sports, according to which effective academic staff (ACA) should constitute 70% of the total staff in relation to the contracted staff (PAC); **(Standard IV.1, Criterion 1)**
4. Collaborations with a wide range of educational and scientific and diagnostic institutions, in the country and abroad, create opportunities for institutional exchanges that contribute to the continuous development of the study program; **(Standard IV.1, Criterion 7)**
5. The institution ensures financial sustainability for the realization of its objectives and mission, relying on the income generated from tuition fees, registration fee, support from the state budget, as well from various grants and projects; **(Standard IV.5, Criterion 5)**
6. Every academic year, the institution designs and implements specific procedures for supporting students through scholarships and financial aid, with a special focus on excellent students and those belonging to the needy strata; **(Standard V.1, Criterion 8).**

b. Weaknesses:

1. It is found that the formative activities offered in this study program are grouped not in accordance with "*DCM No. 41. Date 24.01.2018*", as amended, regarding the second cycle of studies "Master of Science", but the organization of subjects divided for Formative Activities pertaining to that of the first cycle of study programs in "Bachelor" has been followed; **(Standard II.1, Criteria 1)**
2. It is found that the Master of Science study program in "Molecular Biology", in its curriculum, has not determined the credit load for the realization of professional practice, in accordance with "*DCM No. 41, dated 21.01.2028*", amended by 10% of the credits; **(Standard II.1, Criteria 3)**
3. There is a lack of the coordinator of the study program, who would be responsible for the progress, development and professional practice of the study program, in accordance with its objectives; **(Standard II.2, Criteria 3)**
4. It is found that in a significant number of subjects, the compulsory basic literature is more than 5 and 10 years old, many subjects have only one text as basic literature, and the syllabuses have not been updated with compulsory and recommended basic literature, including texts in English and Albanian published by prestigious publishing houses and dated within the last five years; **(Standard II.4, Criteria 5); (Standard IV.3, Criteria 2)**

Recommendations:

1. GVJ recommends the revision of the distribution of subjects-modules according to the respective categories in accordance with the predetermined percentage allowed in "DCM No. 41. Date 24.01.2018, as amended", as well as in the curriculum of the study program, the "Elective Courses" that are offered, should be positioned in Category C - Interdisciplinary/Integrative Subjects; **(Standard II.1, Criteria 1)**
2. GVJ recommends that in the curriculum of the Master of Science study program in "Molecular Biology", the credit load for the realization of the "Professional Practice", in the relevant category D (*Supplementary Subjects*), in accordance with the legal acts; **(Standard II.1, Criteria 3)**
3. GVJ recommends the appointment of the coordinator for the study program, who will represent the person responsible for the progress and development of the study program and professional practices, in accordance with the established objectives; **(Standard II.2, Criteria 3)**
4. GVJ recommends that the program include at least two updated textbooks as basic and compulsory literature for its subjects, in order to provide the necessary scientific competencies for the second cycle of studies; **(Standard II.4, Criteria 5)**; The literature should be correctly cited and presented as a bibliographic reference. Also, the institution should enrich the physical and online library fund, to guarantee the compliance of the program with the requirements of the labor market and the standards of the second cycle of studies; **(Standard IV.3, Criteria 2)**
5. To establish a "Labor Market Board", or a similar structure, which will contribute to the career counseling of students and to the drafting of proposals for further improvement of the curriculum; **(Standard II.5, Criteria 1)**
6. The institution should draft a unified guide for academic formative activities and for the evaluation process, including all necessary components. Currently, there is a lack of a unified assessment format between different subjects and the "Intermediate Exam" does not take place in an orderly manner (*it is applied only to four subjects*). The guide should provide continuous knowledge control and enable students to identify and improve deficiencies before the semester ends; **(Standard III.1, Criteria 1)**; **(Standard III.2, Criteria 3)**; **(Standard III.3, Criteria 1)**
7. Implement an electronic system for knowledge control, with the aim of increasing transparency and minimizing abuses during the evaluation process; **(Standard III.3, Criteria 2)**. Also, the institution to make available a licensed platform for plagiarism checking, accessible by academic staff and students; **(Standard III.3, Criteria 5)**

8. The institution should prepare guidelines for the development and use of innovative teaching methods, in accordance with the study program; **(Standard VI.1, Criteria 1)**

9. The GVJ recommends the appointment of the Head of Subject Group, in accordance with Law No. 80/2015 and VKM No. 41, dated 24.01.2018, as amended, as a necessary mechanism for guaranteeing academic organization, program quality and implementation of MES standards, also these positions will play a positive role by assisting in effective coordination between effective and contract personnel; **(Standard I.3, Criterion 1)**

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

